

1 E martë, 16 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, thërrisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të
8 nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori
9 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej se të
13 akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit. Do
14 vazhdojmë sot me marrjen e dëshmisë së Dëshmitarit të
15 Mbrojtjes së Thaçit 1DW-003.

16 Përpara se të fillojmë marrjen e dëshmisë së dëshmitarit,
17 kemi disa çështje paraprake që Trupi Gjykues dëshiron të
18 trajtojë në formën e urdhrave gojor.

19 Urdhri i parë gojor. Në parashtrimin F03437, ZPS-ja
20 njoftoi se parashtrimi F03316 dhe F03437, mund të
21 riklasifikohen si publike. Rrjedhimisht, në pajtim me
22 rregullën 82(5) të Rregullores, Trupi Gjykues urdhëron që
23 F03316 dhe F03437, përfshirë përkthimet e tyre të
24 riklasifikohen si publike.

25 Me këtë përfundon urdhri i parë gojor i Trupit Gjykues.

1 Së dyti, në parashtimin F03445, Mbrojtja e Thaçit,
2 Veselit dhe Krasniqit kërkuan që parashtimi F03296 të
3 riklasifikohet si publik dhe njoftuan se nuk kanë kundërshtime
4 lidhur me parashtimin F03445 që ky të riklasifikohet si
5 publik. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullën 82(5) të
6 rregullores Trupi Gjykses urdhëron që F03296 dhe F03445,
7 përfshirë përkthimet e tyre të riklasifikohen si publike.

8 Me këtë përfundon urdhri i dytë gojor i Trupit Gjykses.

9 Së treti, në parashtimin F03306, Mbrojtja kërkoi që
10 F03306 të riklasifikohet si publik. Rrjedhimisht, në pajtim me
11 rregullën 82(5) të Rregullores, Trupi Gjykses urdhëron që
12 F03306 përfshirë përkthimet e tyre të riklasifikohen si
13 publike.

14 Me këtë përfundon urdhri gojor i tretë i Trupit Gjykses.

15 Së fundi, dje Mbrojtja e Veselit kërkoi të paraqesë si
16 prova tre materiale, përkatësisht njoftimin për shtyp nga
17 zëdhënësi i Departamentit të Shtetit nga zyra e Departamentit
18 të datës 26 gusht 1998, DKV16781-1782, së dyti, njoftim për
19 shtyp nga Dëshmitari 1DW-003 i datës 23 shtator 1998, DKV1783
20 deri në 1783 dhe, së treti, njoftim për shtyp nga Dëshmitari
21 1DW-003 i datës 27 tetor 1998, dokumenti DKV1776 deri në 1780.

22 ZPS-ja kundërshtoi pranimin e tyre mbi bazën e mungesës
23 së relevancës dhe i referoi për këtë transkriptin në kohë
24 reale faqja 108, 110.

25 Pas marrjes parasysh të vlerësimit të parashtimeve të

1 palëve, Trupi Gjykses është bindur se këto tre materiale kanë
2 relevancë të pakët për as i takon përcaktimit së njohurive të
3 disa dëshmitarëve lidhur me kontekstin në Kosovë në gusht dhe
4 tetor 1998 dhe për rrjedhojë mund të jenë relevante në
5 përcaktimin e ekzistencës së një konflikti të armatosur në atë
6 kohë. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është gjithashtu i bindur
7 se këto materiale janë në pamje të parë autentike dhe kanë
8 vlerë provuese pasi janë shënime dhe të dhëna bashkëkohore të
9 dhëna nga dëshmitarët apo zyra e tij.

10 Në përfundim, Trupi Gjykses është bindur se vlera
11 provuese e tyre nuk zhbëhet nga efekti dëmtues pasi ato janë
12 përdorur dhe diskutuar në Gjykatë dhe palët dhe pjesëmarrësit
13 mund të marrin në pyetje dëshmitarin lidhur me këto pika.

14 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i pranon këto tre dokumente
15 në prova në pajtim me rregullën 138.

16 Znj. Sekretare, ju lutem, caktoi numër prove materiale
17 secilit prej këtyre tre dokumenteve.

18 Me këtë përfundon urdhri i katërt gojor.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë
20 DKV1781 deri në 1782, do të marrë numrin e provës materiale
21 2D49. I dyti, DKV1783 deri DKV1783 do të marrë numrin e provës
22 materiale 2D50. Dhe i treti, DKV1776 deri në DKV1780 do të
23 marrë numrin e provës materiale 2D51.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
25 vazhdojmë me marrjen e dëshmisë së Dëshmitarit të Mbrojtjes së

1 Thaçit 1DW-003.

2 Znj. Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 uleni.

6 Mirëmëngjes, Dëshmitar. Sot do vazhdojmë me marrjen e
7 dëshmisë suaj. Po merreni në pyetje nga Prokuroria. Ju
8 rikujtoj që të përpiqeni t'i përgjigjeni pyetjeve në mënyrë të
9 qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen
10 mund të pyesni avokatin që të përsërisë pyetjen apo t'ju thoni
11 që nuk e kuptonin pyetjen dhe ata do ta sqarojnë atë.
12 Gjithashtu, ju lutem, tregoni bazën për njohurinë e fakteve
13 dhe rrethanave mbi të cilat merreni në pyetje.

14 Ju kujtoj që jeni akoma nën detyrimin për të thënë të
15 vërtetën siç e keni deklaruar në betimin solemn.

16 Ju lutem flisni afër mikrofonit, përpiquni të prisni pesë
17 sekonda përpara se të përgjigjeni dhe flisni me ritëm të
18 ngadaltë me qëllim që përkthyesit të mund të përkthejnë.

19 Në qoftë se keni nevojë të bëni pushim, na tregoni dhe do
20 ta bëjmë të mundur.

21 Së fundi, për përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara, një
22 që është sot, faleminderit për praninë tuaj sot. Ju kujtoj se
23 në çdo kohë në qoftë se keni nevojë të bisedoni me dëshmitarin
24 apo t'i drejtoheni Trupit Gjykses, mund të ngrini dorën që
25 t'ju jepet leje dhe kjo gjë do të bëhet nga Trupi Gjykses.

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 5

1 Në rregull. Jemi gati të vazhdojmë marrjen në pyetje nga
2 ZPS-ja.

3 Z. Pace, e keni fjalën ju.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

5 DËSHMITARI: JAMES RUBIN [Vijon]

6 Pyetje të palës tjetër nga z. Pace: [Vazhdim]

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, do të filloj duke ju treguar, do t'ju tregoj
9 një dokument të cilin e kemi parë dje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
11 tregoni, z. Pace, se sa kohë do ju duhet përafërsisht për të
12 përfunduar?

13 Z. PACE: [Përkthim] Do të më duhet një orë, një orë e
14 gjysëm maksimumi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. PACE: [Përkthim] Dua të shfaqet në ekran dokumenti
17 P01067, ju lutem. Mbajmë këtë faqe. Këtu është shumë mirë.

18 PY. Dëshmitar, siç e thashë, kjo është një kabllograme që e
19 kemi parë edhe dje dhe, siç e thamë dje, mban datën 3 nëntor
20 1998. Dhe shohim që vjen nga Beogradi dhe i drejtohet
21 Sekretares së Shtetit në Washington.

22 Z. PACE: [Përkthim] Dhe në qoftë se shohim pak më poshtë
23 në faqe, paragrafi që fillon me numrin 2, ku ne lexojmë si në
24 vijim.

25 PY. Sa më poshtë:

1 "Është një vlerësim lehtësisht i edituar, i ndryshuar i
2 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i përgatitur në bazë të
3 kërkesës së *COM by* të *US KDOM lider*."

4 Dje, ju u pajtuat me z. Veseli se në tetor 1998, Shaun
5 Byrnes ishte shefi i US KDOM. Dhe në këtë kabllogram e shohim
6 që Byrnes i referohet -- Byrnes përmendet këtu si një vëzhgues
7 ushtarak me përvojë, i respektuar, i cili jepte informacione
8 të sakta dhe si informacioni i dhënë ishte verifikuar nga
9 informacioni në terren aq sa ishte e mundur për t'u bërë.

10 Kalojmë në faqen 075305 të kësaj, do t'ju përpiqem t'ju
11 tregoj një pjesë dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje. Do të
12 lexoj nga paragrafi i parafundit.

13 Këtu lexohet:

14 "Adem Demaçi. Thaçi përshkruan Demaçin si 'zëdhënësi i
15 UÇK-së në Prishtinë', por kujdesej që të mos i atribuoj
16 Demaçit asnjë autoritet politik. [Mahmuti] mbështet e thotë të
17 njëjtën gjë."

18 Pyetja ime është: Dëshmitar, a ishit në dijeni të këtij
19 informacioni në nëntor të 1998?

20 PË. Nuk e di. Përgjithësisht kam patur njohuri për diskutimet
21 lidhur me UÇK-në, por nuk kam patur njohuri përpara Rambujesë
22 për këto dallime të vogla që janë përshkruar këtu nga këta
23 individë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

25 PY. Gjatë bisedimeve për marrëveshje ka patur takime

1 ndonjëherë të gjata në mes të udhëheqësve të UÇK-së,
2 komandantëve të UÇK-së në mungesë tuaj, pra, pa praninë tuaj?
3 PË. Po.

4 PY. Dhe gjatë këtyre bisedimeve ju nuk keni marrë pjesë në
5 këto takime të mbyllura që mbaheshin mes komandantëve të UÇK-
6 së?

7 PË. Nuk jam i sigurtë që nuk kam qenë në atë zonë, por nuk
8 flisja shqip dhe ata mund të kenë biseduar gjëra që unë s'i
9 kam kuptuar dhe ndoshta, por nuk është që më kanë ndaluar që
10 unë të isha në këtë dhomë, pra, në këtë sallë ku po mbahej
11 mbledhja apo takimi. Kjo ka qenë një sallë e madhe në këtë
12 ndërtesë dhe gjërat kanë ndodhur në forma të ndryshme, pra,
13 është e mundur që mund të kem qenë aty në afërsi të dhomës
14 ndërkohë që janë diskutuar gjëra, pra, mund të kenë qenë.

15 PY. A ju kujtohet që kur jeni takuar me Mbrojtësin e z. Thaçi
16 në seancën e përgatitjes së dëshmitarit, më duket ka qenë
17 javën e kaluar, që keni thënë që nuk i keni parë asnjëherë
18 kurrë në seancë të mbyllur pra?

19 PË. Në qoftë se ka qenë seancë e mbyllur, nuk kam pasur
20 mundësi t'i shoh. Ajo që po them unë është që disa prej
21 seancave apo mbledhjeve që janë mbajtur nuk kanë qenë të
22 mbyllura. Pra, besoj që disa prej tyre janë bërë, nuk kam
23 patur mundësi t'i shoh, pra, nuk kam pasur vizuale.

24 PY. Kthehemi tek pyetjet që u bëra më herët dhe gjatë
25 mbledhjeve që mbanin komandantë të UÇK-së, për këtë bëhet

1 fjalë?

2 PË. Varet nga përkufizimi i fjalës "e mbyllur", mbledhje "e
3 mbyllur". Pra, përkufizimi i përgjigjes kjo jep edhe
4 përgjigjen e pyetjes, në qoftë se është kjo. Por fjala "e
5 mbyllur" është e vagullt, është fjalë e vagullt sepse nuk ka
6 qenë negociatë formale në një dhomë formale me seanca formale.
7 Disa prej seancave, disa bisedime, diskutime janë bërë dhe në
8 një qoshe të dhomës ku kanë qenë rreth dhjetë njerëz që
9 diskutonin, konsultoheshin dhe mund të kem qenë aty afër.
10 Mund.

11 Nuk jam në gjendje të them me saktësi t'i përgjigjem
12 pyetjes tuaj me saktësi që unë nuk kam marrë pjesë asnjëherë
13 në mbledhje të mbyllura sepse kuptimi i fjalës "mbledhje e
14 mbyllur" nuk vlen për një kontekst që është joformal.

15 Z. PACE: [Përkthim] Do të doja të shfaqnim në ekran tani
16 DHT12025 deri në DHT12031.

17 PY. Në faqen e parë shohim datën 8 shtator 2025, Shënimi
18 Përgatitor 2 dhe referenca është numri juaj, kodi juaj i
19 dëshmitarit.

20 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen e fundit të këtij
21 materiali.

22 DËSHMITARI: Kërkoj ndjesë, z. Prokuror. A e kuptoj tani,
23 është shkruar nga ajo.

24 Z. PACE: [Përkthim]

25 PY. Kemi "Vërtetimin", numër 21:

1 "Informacioni në këtë shënim i është lexuar Dëshmitarit
2 1DW-003, i cili e konfirmoi se e pasqyron tregimin e tij në
3 mënyrë të plotë dhe të saktë."

4 Siç e konstatuat edhe ju është nënshkruar nga avokati i
5 Mbrojtës i Thaçit.

6 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kaloj në faqen tjetër,
7 faqja 120.

8 PY. Dhe këtu do të lexoj nga fjalia e fundit, paragrafi 13.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Kështu.

10 PY. "Ai pa që komandantët e tjerë të UÇK-së si dhe Reith, të
11 cilët kaluan javë të tëra me UÇK-në t'i drejtoheshin me
12 respekt z. Çeku. Ai nuk i pa asnjëherë ata në mbledhje të
13 mbyllur por pa Thaçin që iu drejtohej me respekt komandantëve
14 të UÇK-së, jo e kundërta."

15 Pra, pyetja ime është: Në këtë pjesë thuhet "nuk i ka
16 parë asnjëherë ata në mbledhje të mbyllura", e saktë, apo jo?
17 Është kjo pjesë e saktë?

18 PË. Edhe këtu varet nga kuptimi i fjalës "mbyllur".

19 PY. Fjalët e përdorura në këtë shënim përgatitor, a janë, a
20 ishin këto fjalët që u përdorën?

21 PË. Disa herë në seancat, ndonjëherë në seancat përgatitore
22 për vite mund të kem qenë i pakujdesshëm dhe nuk kam vënë re,
23 apo kur kam vënë re apo kam parë kam thënë atë që dija lidhur
24 për ndërlidhjet mes të dyve apo shkëmbimet mes të dyve dhe
25 ndonjëherë ato, nuk kisha qasje në to, ndonjëherë nuk ishte

1 kështu.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni këtë dokument.

3 PY. Ndryshojmë temë tani pak. A jeni takuar apo keni patur
4 ndonjë kontakt me Jakup Krasniqin përpara shkurtit 1999?

5 PË. Nuk mendoj.

6 PY. Jakup Krasniqi ka qenë edhe ai pjesë e delegacionit në
7 Paris. A keni biseduar me atë atje?

8 PË. Nuk më kujtohet.

9 PY. A ju kujtohet që e keni parë apo keni patur kontakt me
10 Jakup Krasniqin përveç prillit 1999 në Bruksel dhe në Rambuje?

11 PË. Ato janë dy rastet, mendoj, që mund të jem takuar me të.
12 Por ka pasur shumë gjëra që po ndodhnin gjatë atyre muajve dhe
13 nuk mund të jem absolutisht i sigurtë.

14 PY. Po pas konfliktit?

15 PË. Kjo është pyetje e mirë. Nuk mund t'i përgjigjem asaj.

16 PY. Deklarata juaj nuk e përmend në mënyrë specifike Kadri
17 Veselin, e saktë?

18 PË. Kështu është, nuk mendoj.

19 PY. A e keni takuar apo patur ndonjë kontakt me Kadri Veselin
20 përpara shkurtit 1999?

21 PË. Për të qenë i sigurtë, nuk më kujtohet ky individ. Nuk
22 mund t'i përgjigjem pyetjes.

23 PY. Kadri Veseli ka qenë pjesë e delegacionit të UÇK-së në
24 Rambuje -- nuk ka qenë pjesë por ka qenë i pranishëm aty,
25 është e saktë?

- 1 PË. Nuk e di.
- 2 PY. Deklarata juaj nuk përmend në mënyrë specifike Rexhep
- 3 Selimin. A është kështu?
- 4 PË. Kështu është, nuk mendoj që e përmend.
- 5 PY. A e keni takuar apo keni patur ndonjë kontakt me Rexhep
- 6 Selimin?
- 7 PË. Është shumë e mundur që po. Kam takuar shumë, shumë
- 8 komandantë të UÇK-së gjatë viteve por nuk më kujtohen
- 9 gjithmonë emrat sepse kjo ka ndodhur para 25 vitesh.
- 10 PY. Dje dëshmuat se Shtetet e Bashkuara donin të siguroheshin
- 11 që, siç e thatë ju, qeveria ishte në anën e engjëjve që ju na
- 12 shpjeguat duke thënë që donin ishin në anën e viktimave që të
- 13 mos -- dhe kjo ishte gjatë 1996, 1997, 1998, 1999, pra, që të
- 14 ishin nga ana e viktimave dhe nga ana e atyre që kryenin
- 15 krime?
- 16 PË. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje saktë, duhet të
- 17 pasqyroj faktin se periudha - 1996, 1997, 1998 - që ju po
- 18 përshkruani, personi që ishte Ambasadori Gelbard ishte
- 19 përgjegjës për këtë. Ai u takua me udhëheqësit e UÇK-së në
- 20 kohën kur ne i përshkruanim si persona që bënë aktivitete
- 21 terroriste. Pra, ndoshta ne shkelëm dëshirën tonë që të ishim
- 22 në anën e engjëjve gjithmonë sepse për një periudhë të caktuar
- 23 kohore derisa e kuptuam më mirë situatën, ne fillimisht e
- 24 përshkruam UÇK-në si organizatë që zhvillonte aktivitete
- 25 terroriste dhe ne sigurisht me gjithë dëshirën që kishim të

1 ishin në anën e engjëjve, ne nuk donim që të lidheshim apo të
2 mbështesnim njerëz që zhvillonin apo bënë aktivitete
3 terroriste. Ky qëndrim pastaj ndryshoi me kalimin e kohës,
4 veçanërisht pasi UÇK-ja u pajtua me Marrëveshjen e Rambujesë
5 dhe pastaj e konsideruam atë siç ishin në anën e engjëjve
6 sepse nënshkruam marrëveshjen e paqes.

7 PY. Tani do të shohim disa prej deklaratave tuaja apo
8 deklaratën të cilës po i referoheni.

9 Z. PACE: [Përkthim] Dhe do të doja të shfaqej në ekran
10 dokumenti 128836-24. Dhe kjo është një video. Krahas kësaj do
11 të doja të shfaqim transkriptin i cili është 128836-24-TR-ET.
12 Në video do të dëgjojmë, do të shohim minutën 09:15 deri në
13 09:55.

14 PY. Ndërsa kjo parashfaqet në ekran, për kontekst bëhet fjalë
15 për intervistën e Charlie Rose e korrikut 1999.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. PACE: [Përkthim] Përgatisim videon nga minuta 09:15
18 deri në 09:55.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, a mund të
20 kontrollojmë datën e videos, ju lutem?

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. PACE: [Përkthim] E shoh që video është gati edhe
23 përkthimi. Kjo është në anglisht. Nuk kemi transkriptin në
24 shqip. Kështu që përkthyesit të përkthejnë goftë nga
25 transkripti apo nga fjala.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "James Rubin: ... kishte forca që forcat shqiptare ishin
3 të përfshira në vrasje, se ata UÇK-ja merrte para nga
4 veprimtari kriminale. Ka patur shumë pretendime, akuza për
5 rreth një vit. Ne i shikuam ato, nuk arritëm t'i vërtetonim.

6 "Charlie Rose: Kjo do të kishte parandaluar një
7 marrëdhënie me z. Thaçi tani?

8 "James Rubin: Mendoj që po. Ata ishin një forcë që duhet
9 të merreshin parasysh të konsideroheshin në terren dhe ne
10 donim të krijonim një Kosovë më afatgjatë, ne donim të kishim
11 shkëmbime dhe të punonim me z. Thaçi.
12 PY. Pyetja ime e parë, Dëshmitar, është: A ju kujtohet kjo që
13 keni thënë kështu?

14 PË. Së pari, shoh sesa i ri kam qenë. Dhe, në fakt, kështu
15 duket siç -- unë jam ai që po flas.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund t'i heqim këto dokumente nga
17 ekrani. Në fakt, kërkojmë që të pranohen si prova dy pjesët e
18 treguara, individi që po flet dhe përkthimi përkatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshtim?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja të më jepet mundësia që
22 të shoh pak kontekstin e asaj që thotë përpara dhe prapa, pas
23 kësaj pjesë që dëgjuam.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta shtyjme
25 marrjen e vendimit mbi pranimin e saj apo jo për më vonë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. PACE: [Përkthim] A mund t'i japim një numër provizor
3 atëherë?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesët që sapo u panë
6 në ekran nga minuta 09:15 deri në 09:55 dhe faqja 5 e
7 transkriptit do të marrin numrin provizor të provës P4486.

8 Z. PACE: [Përkthim] Sapo më thanë që video nuk u shfaq
9 për publikun. Sa më përket mua, gjithçka që tregova është
10 publike dhe mund të shfaqet për publikun.

11 PY. Dëshmitar, mendoj që e përmendët sot më herët, nga 1997,
12 autoritetet e SHBA-së shprehën shqetësime dhe dënuan krime që
13 pretendohet të ishin kryer nga pjesëtarë të UÇK-së?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe autoritetet e SHBA-së kanë bërë këtë gjë -- nuk do ta
16 kishin bërë këtë gjë pa patur raporte të besueshme,
17 mjaftueshmërisht të besueshme që të paktën ngrinin shqetësimin
18 e tillë?

19 PË. Po.

20 PY. Në 1998 dhe 1999, mediat ndërkombëtare dhe entitetet e
21 tjera kanë publikuar raporte me pretendime të besueshme për
22 krimet e kryera nga pjesëtarë të UÇK-së.

23 Z. PACE: [Përkthim] I kërkoj ndjesë përkthyesve.

24 PY. Pra, në 1998 dhe 1999 mediat ndërkombëtare dhe
25 organizatat e tjera kanë publikuar raporte të shumta me

1 pretendime të besueshme për krimet e kryera nga pjesëtarët e
2 UÇK-së, a është kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Në një njoftim për shtypin në gusht të 1997, ju shprehët
5 shqetësimin e thellë të Shteteve të Bashkuara lidhur me
6 veprimet terroriste në Kosovë dhe vrasje politike që kanë
7 ndodhur në 1997?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe ju shpjeguat publikisht atë që ju e konsideronit si
10 terrorizëm.

11 Z. PACE: [Përkthim] Dhe lidhur me këtë do të doja të
12 shfaqnim në ekran SPOE00397757 deri në 00397765. Mund ta
13 zmadhojmë pak.

14 PY. Këtu shohim, ky është njoftimi për shtyp ditor i mbajtur
15 nga ju më 15 qershor 1998, nga njoftimi për shtyp i
16 Departamentit të Shtetit.

17 Z. PACE: [Përkthim] Dhe tani do të kalojmë në faqen 7761.

18 PY. Do të lexoj pyetjen e fundit nga kjo faqe:

19 "Pyetje: Jamie, sa për referencë, sulmi i djeshëm nga
20 UÇK-ja kundër një kolone serbe, ku dy oficerë policie u vranë,
21 a e konsideroni këtë si sulm terrorist?

22 "Përgjigje: Nëse është kolonë, atëherë është ushtarake.
23 Mendoj që siç thonë përgjigja e kësaj pyetjeje është vetë në
24 pyetje.

25 "Pyetje: Në rregull, atëherë çdo veprim i UÇK-së nuk

1 është terrorist, jo të gjitha veprimet e UÇK-së janë veprime
2 terroriste?

3 "Z. Rubin: E saktë.

4 "Pyetje: Cilat lloje aktiviteteve i konsideroni ju si
5 aktivitete terroriste?

6 "Z. Rubin: Mendoj që përkufizimi i terrorizmit është i
7 përcaktuar qartë. Mendoj që ti dhe unë kemi patur këtë
8 shkëmbim para një muaji. Nëse vritet një joluftëtar i
9 pafajshëm për arsye për arritjen e objektivave politike -
10 mënyra sesi njerëzit po vrasin në mënyrë brutale civile të
11 pafajshëm në rrugët e Tel Aviv apo vrasin serbë të pafajshëm
12 apo që nuk janë pjesë e shërbimeve të forcave të brendshme të
13 Serbisë dhe i vrasin ata thjesht sepse janë serbë edhe jo për
14 atë që kanë bërë - në këtë rast është terrorizëm."

15 Ju kujtohet që e keni thënë këtë?

16 PY. Kjo ka ndodhur para 28 vitesh. Nuk mund të them
17 sinqerisht që më kujtohet që e kam thënë këtë, por pasqyron
18 atë që ne kemi kuptuar që është mënyra për të shpjeguar
19 publikisht kuptimin e terrorizmit politik.

20 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

21 PY. Ju e dini që në vitin 1998 pjesëtarë të UÇK-së ndonjëherë
22 vrisnin punëtorë civilë si dhe policë serbë, a është e saktë
23 është e saktë?

24 PË. Duket e saktë. Por ngjarje konkrete, incidente konkrete
25 nuk më kujtohen, këto kanë ndodhur para 28 vitesh. Në

1 përgjithësi, në terma të përgjithshëm është kështu siç thoni
2 ju.

3 PY. Në një dokumentar të BBC-së ju e pranoni se anëtarë të
4 UÇK-së kanë vrarë civilë serbë me gjakftohtësi e sipër, apo
5 jo?

6 PË. Mund të ketë ndodhur. Më kujtohet dhe arsyeja pse i
7 dënuam veprimtaritë e UÇK-së në fazën fillestare sepse po
8 vriteshin civilë dhe jo ushtarë, prandaj dhe ne i dënuam këto
9 veprimtari terroriste të UÇK-së por me kalimin e viteve e
10 njohëm më mirë organizatën.

11 Z. PACE: [Përkthim] Shohim në ekran dokumentin 128791-02.
12 Është një video, është në anglisht, përbri është edhe
13 përkthimi në gjuhën shqipe me numër 128791-02-TR. Do të shohim
14 konkretisht segmentin e videos nga minuta 07:48 deri në 08:25.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument është
16 konfidencial, a mund ta shfaqim për publikun?

17 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund ta ndjekë edhe publiku.
18 Fillimisht shkojmë në faqen e parë të transkriptit, ju lutem,
19 për të parë ballinën. Shikoni datën këtu, 12 mars të vitit
20 2000. Tani mund të shkojmë sërish në faqen e dytë. Ta
21 zmadhojmë pak më shumë transkriptin në krye. Dy paragrafët e
22 parë Faleminderit.

23 Nuk është në shqip e përkthyer, kështu që përkthyesi do
24 të përdorë ose audion ose transkriptin në anglisht. Fillojmë
25 në minutën 07:48.

1 [Luhet videoincizimi]

2 "... po rrisnin oficerë policie dhe po zhdukeshin me
3 shpejtësinë e erës edhe forcat komando. Po rritej numri i
4 civilëve serbë. Perëndimi këta do t'i konsideronte viktima të
5 terrorizmit apo thjesht një revoltë legjitime të një populli?

6 "Po vriteshin civilë serbë në gjakftohtësi, sigurisht që
7 këto janë akte terroriste dhe ne besojmë këto ishin të gabuara
8 dhe, fatkeqësisht, kjo ishte pikërisht ajo çfarë po bënte UÇK-
9 ja asokohe."

10 Z. PACE: [Përkthim] Ndalojmë këtu.

11 PY. Dëshmitar, këtu ishin fjalët tua, apo jo?

12 PË. Po.

13 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e kësaj pjese të
14 videos, këtij segmenti të videos bashkë me transkriptin
15 përkatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtime nuk kemi. Po unë dua
18 t'i përgjigjem pak videos që pamë pak më herët, do donim që
19 kur të pranohej videoja për kontekst të pranohej dhe faqja 3
20 deri në 5 që të kuptohet më mirë?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
22 kundërshtim, z. Pace, lidhur me këtë?

23 Z. PACE: [Përkthim] Do t'ju themi pak më vonë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po për këtë
25 video keni kundërshtime?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, për këtë segment nuk kemi
2 kundërshtime.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
4 atëherë.

5 Dokumenti që sapo pamë, bashkë me përkthimin përkatës, me
6 numër 128791-02 pranohet.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Segmenti që sapo pamë
8 është segmenti që duhet pranuar?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë segmenti i
11 videos që sapo pamë do të marrë numrin e provës P4487 dhe a
12 mund ta riklasifikojmë këtë pjesë si publike?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Sikurse thatë edhe vetë, në shkurt të 1998-s, Ambasadori
16 Gelbard fuqimisht e kundërshtoi dhe nuk kishte pro këtyre
17 vrasjeve që po kryente UÇK-ja, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Në mars të 1998, pak pasi dënoi Ambasadori Gelbard
20 vrasjet nga UÇK-ja, ju theksuat se Qeveria e SHBA-së u kishte
21 bërë thirrje udhëheqësve kosovarë t'i dënonin aktet terroriste
22 nga të ashtuquajturit UÇK.

23 PË. Po, kështu më duket, po.

24 PY. Shtetet e Bashkuara i dënuan këto akte të UÇK-së në
25 shkurt dhe mars të 1998 sepse dihej botërisht asokohe se UÇK-

1 ja ka gjykuar dhe ka ekzekutuar serbët etnik dhe shqiptarët që
2 nuk i pëlqente?

3 PË. Nuk mendoj se e kam thënë këtë mënyrë. Sigurisht disa nga
4 ngjarjet asokohe kanë qenë shumë më pak të qarta seç i
5 përshkruani ju.

6 PY. Në rregull atëherë.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim një dokument me numër
8 114010-114011. Zmadhojmë pjesën e sipërme të dokumentit. Është
9 deklarata e sekretares së Shtetit Madeleine Albright është
10 grupi ministror për Kosovën në Londër më 9 mars 1998 edhe
11 është dokument i lëshuar nga zyra e zëdhënësit të
12 Departamentit të Shtetit që është zyra juaj, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Po lexoj paragrafin e tretë. Shkojmë pak më poshtë në
15 faqe, të tretin nga fundi.

16 "Autoritete në Serbi do përpiqen t'i bëjnë të mjegullta
17 këto veprime duke pretenduar se këto janë veprime krejt
18 legjitime ndaj një kërcënimi terrorist. Ne nuk mund ta mohojmë
19 që po përballemi me një kërcënim të tillë. Nuk kemi ndonjë
20 simpati për këtë lëvizje që është e ashtuquajtur lëvizje për
21 çlirimin që gjykon dhe ekzekuton serbët etnik dhe shqiptarët
22 që nuk i pëlqejnë."

23 Ju kujtohet kjo?

24 PË. Kjo është shumë e përgjithshme. Është përpjekur të
25 theksojë një problem. Nuk i është referuar asnjë akti konkret.

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 21

1 Fjalime të tilla përgjithësisht përpigën thjesht të japin një
2 panoramë të situatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po
4 përgjigjeni, Dëshmitar. Pyetja ishte a ju kujtohet të jetë
5 thënë kjo nga Madeleine Albright.

6 DËSHMITARI: Pas kaq vitesh, nuk më kujtohet konkretisht
7 ta ketë thënë këtë.

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 PY. Keni ndonjë arsye ta kontestoni këtë dokument që ka dalë
10 pikërisht nga zyra juaj, sipas jush nuk është thënë, nuk është
11 pasqyruar ajo që ka thënë Madeleine Albright?

12 PË. Jo, nuk kam asnjë arsye për ta kontestuar.

13 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e dokumentit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
15 kundërshtime?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po dëshmitari s'tha asgjë për
17 dokumentin. E kuptoj që dokumenti ka dalë prej zyrës së tij,
18 po nuk na dha asnjë kontekst.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me
20 numër 114010-114011 pranohet. Le të marrë numrin përkatës.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
22 numrin P4488.

23 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti mund të jetë publik. Dhe
24 mund ta heqim nga ekranin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le ta

1 riklasifikojmë dokumentin.

2 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, në fakt ishte dokument
3 publik. Mund ta heqim dokumentin nga ekрани.

4 PY. Dëshmitar, në nëntor të 1998-s, autoritetet e SHBA-së e
5 dinin se anëtarët e UÇK-së kishin arrestuar Jakup Kastratin
6 dhe Cen Deskun, dy anëtarë të udhëheqjes së LDK-së në
7 Malishevë, dhe i arrestuan me pretendimin se bashkëpunonin me
8 policinë serbe.

9 PË. Nuk më kujtohet kjo pas 27, 28 vjetësh.

10 PY. Në rregull.

11 Z. PACE: [Përkthim] Shohim në ekran dokumentin me numër
12 P01067.

13 PY. Siç mund ta shohim këtu është i njëjti kabllogram që pamë
14 edhe dje edhe sot paradite më datën 3 nëntor 1998 që i është
15 drejtuar Sekretares së Shtetit në Washington, këtu flitet për
16 drejtuesin e ekipit të KDOM-it amerikan.

17 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen 075307 dhe po ju
18 lexoj nga fillimi këtu.

19 PY. "Për më tepër UÇK-ja 'policia sekrete' e policisë
20 arrestoi dy anëtarë të udhëheqjes së LDK-së në Malishevë më 30
21 tetor. Në 2 nëntor, Mahmuti konfirmoi "arrestimin" dhe
22 pretendoi se nuk është bërë për 'arsye politike' por sepse dy
23 zyrtarët e LDK-së, Cen Desku dhe Jakup Kastrati, kishin
24 'bashkëpunuar' me policinë serbe dhe i kishin inkurajuar
25 banorët e zonës të dorëzonin armët. Mahmuti pretendonte se

1 Desku dhe Kastrati ishin 'në burg' dhe se ishin 'trajtuar
2 mirë'. Ai tha se do të lejoheshin që të gjenin një avokat që
3 t'i mbronte në 'gjykimin' që do të vinte. Zhvillime të tilla
4 krijuan shqetësime për sjelljen e UÇK-së sa i takon zgjidhjes
5 paqësore në këtë krizë edhe vullnetit të tyre për të toleruar
6 partitë e tjerë dhe opinionet e tyre. Në thelb UÇK-ja duket
7 sikur ishte interesuar vetëm të kishte një imazh shumë të
8 fortë publik dhe ndërkombëtar dhe të kishte më shumë kontroll
9 në Kosovë. Të bashkëpunosh me UÇK-në e re nuk do të jetë e
10 lehtë për MVK-në e OSBE-s."

11 Dëshmitar, këtë informacion e keni marrë ju në 1998-n?
12 PË. Ma merr mendja që duhet ta kem lexuar dhe ma merr mendja
13 që ky opinion i autorit për UÇK-në duhet të jetë parë prej
14 meje, por unë jo domosdoshmërisht e kam parë si një dokument
15 vendimtar këtë apo opinion vendimtar.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
17 Dhe kam një përgjigje për parashtimin e z. Misetic për
18 dokumentin që pamë pak më herët. Nuk kemi asnjë kundërshtim që
19 të pranohen dhe faqet 3, 4 dhe 5 të intervistës së Charlie
20 Rose bashkë me pjesën përkatëse të segmentit që unë i tregova
21 dëshmitarit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Materiali që mori numrin provizor 94486 pranohet dhe do t'i
24 shtojmë faqet 3, 4 dhe 5.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, do doja të pranohej në

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 24

1 fakt edhe videoja përkatëse që fillon në faqen 3, mund ta shoh
2 gjatë pushimit konkretisht numrin dhe t'ua jap.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
4 kundërshtime?

5 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim që të
6 pranohet dhe ajo pjesë e videos.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal,
10 materiali me numër provizor P4486, do të marrë numrin
11 përfundimtar të provës gjyqësore, por para se të marrim dhe
12 pjesën tjetër të transkriptit që kërkon Mbrojtja të pranohet.

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, a jeni ju në dijeni që raportet e
15 Departamentit të Shtetit që flasin për Kosovën në kontekstin e
16 praktikave të drejtave të njeriut në 1998, thonë që UÇK-ja
17 është përgjegjëse për vrasje, zhdukje, rrëmbime, ndalime
18 përfshirë edhe civilët serbë dhe shqiptarë që dyshoheshin se
19 ishin besnikë ndaj qeverisë serbe?

20 PË. Ma merr mendja se po.

21 PY. Dhe raporti përmend edhe raste kur ka pasur tortura prej
22 anëtarëve të UÇK-së, apo jo?

23 PË. Nuk më kujtohet ndonjë pretendim konkret lidhur me këtë.

24 PY. Madje në këtë raport flitet që anëtarë të UÇK-së kanë
25 rrëmbyer dy gazetarë në tetor të 1998 dhe i kanë dënuar me

1 burgim, apo jo?

2 PË. Nuk më kujtohet pas kaq vitesh, pas 28 vitesh një raport
3 i tillë. Por nuk kam asnjë arsye për ta kundërshtuar.

4 PY. I njëjti raport flet për raste të besueshme të
5 ashtuquajturve "bashkëpunëtorë" që ishin vrarë dhe disa
6 shqiptarë të punësuar në institucione shtetërore serbe po
7 ashtu janë kërcënuar, apo jo?

8 PË. Ma merr mendja që po, besoj në atë që është thënë në atë
9 raport.

10 PY. Në të njëjtin raport flitet për ndalimin e 13
11 politikanëve shqiptarë në Qirez prej anëtarëve të UÇK-së dhe
12 UÇK-ja pretendohet se ka torturuar në mënyrë të vazhdueshme
13 gjashtë prej këtyre politikanëve. Jeni në dijeni të kësaj?

14 PË. Jo, nuk më kujtohet një pretendim i tillë.

15 PY. Pra, ju nuk e dini nëse z. Thaçi të ketë pranuar të ketë
16 qenë i pranueshëm në Qirez kur ka ndodhur kjo ngjarje?

17 PË. Nuk më kujtohet as ngjarja, as incidenti, as prania apo
18 mosprania e tij.

19 PY. Në një njoftim për shtyp në janar të 1999-s ju thatë se
20 autoritetet serbe kanë liruar të ndaluarit shqiptarë të
21 Kosovës dhe ju bëtë thirrje për të dyja palët që t'i ndalonin
22 personat që kishin ndaluar, apo jo?

23 PË. Kjo ishte puna ime.

24 PY. Dhe ju i kërkuat të dyja palëve të ndalonin rrëmbimet e
25 personave dhe t'i trajtonin të ndaluarit në mënyrë të duhur?

1 PË. Të njëjtën përgjigje kam sikurse më herët.

2 PY. Përpara njoftimit për shkurt, më 25 nëntor 1998, *The New*
3 *York Internacional* raportoi se ekspertët çmonin se rebelët në
4 Kosovë kishin rrëmbyer më shumë se 200 serbë dhe shumica
5 syresh pretendohet se ishin vrarë, apo jo?

6 PË. Nëse ka qenë në *The New York Times* mund ta kem lexuar,
7 por domosdoshmërisht e kam konsideruar diçka të vërtetë.

8 PY. Në rregull.

9 Z. PACE: [Përkthim] Shohim në ekran dokumentin V00007.

10 PY. Kjo është një faqe e *The New York Internacional*, data 25
11 nëntor 1998 dhe titulli është "Hapa të vegjël për të ndihmuar
12 me armëpushimin në Kosovë". Po lexoj nga paragrafi i parë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të zmadhohet paragrafi i
14 parë në kolonën e parë. Faleminderit.

15 PY. "Pasi morën diplomatin amerikan, Goran Zbiljic - më falni
16 - pasi ndërhyjnë diplomatët amerikanë, një oficer i policisë
17 serbe që kishin rrëmbyer rebelët, Goran Zbiljic, u lirua.

18 "Lirimi është i rëndësishëm sepse ekspertët çmojnë se
19 rebelët kanë rrëmbyer më shumë se 200 serbë dhe besohet se
20 shumica e tyre janë vrarë."

21 Pra, Dëshmitar, keni ndonjë arsye për ta kontestuar këtë
22 dhe të thoni që kjo të jetë thjesht një thashethem?

23 PË. Jo, nuk kam asnjë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Në dokumentin me numër P04259, ju
25 lutem. Do ju lutesha që të shihnim faqen 0402. Në PDF duhet të

1 jetë faqja 8.

2 PY. Dëshmitar, për kontekst, ky është pjesë e një libri nga
3 Marc Weller. Dhe shkojmë pak më poshtë në ekran, tek pika
4 katër shohim që përmendet një raport i Sekretares së
5 Përgjithshme 30 tetor 1998. Shkojmë në fagen tjetër, ju lutem
6 dhe do t'ju lexoj nga paragrafi 11 i këtij raporti. Shohim si
7 në vijim:

8 "Fati i shumë serbëve, shqiptarëve të Kosovës dhe romëve
9 si dhe oficerëve të policisë serbe që janë rrëmbyer nga
10 shqiptarë të Kosovës të armatosur, që besohet se i përkasin
11 UÇK-së, është i panjohur. Autoritete jugosllave thonë se 249
12 civilë dhe policë janë rrëmbyer prej UÇK-së. 92 syresh
13 pretendohet se janë liruar, 9 janë arratisur dhe 29 janë
14 gjetur të vdekur. Komuniteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
15 raport se aktualisht po ndjek 140 raste rrëmbimesh."

16 Dëshmitar, keni qenë në dijeni të këtij raporti të
17 Sekretares të Përgjithshme në tetor të 1998?

18 PË. Kam lexuar një raport të OKB-së për Kosovën po kam qenë
19 shumë skeptik për atë raport sepse organet e OKB-së nuk e kanë
20 përshkruar shumë mirë situatën shumë shpesh. Pra, kam qenë në
21 dijeni të raportimit prej OKB-së, po jo domosdoshmërisht ka
22 qenë i besueshëm raporti. Raportet e Kryqit të Kuq
23 Ndërkombëtar zakonisht në fakt i konsideroja si më të
24 besueshme.

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokument.

1 PY. Ju keni thënë se keni qenë në Kosovë në 19 qershor 1999
2 dhe nja dy-tre ditë më pas, apo jo? Në këtë periudhë kohore a
3 keni dëgjuar për trupat e KFOR-it gjerman që kanë gjetur në
4 një ndërtesë, që kishte marrë UÇK-ja, kanë gjetur 15 të
5 burgosur përfshirë një të moshuar që u gjet i vdekur i
6 prangosur në një karrige pasi ishte rrahur keqazi?

7 PË. Nuk më kujtohet ky incident pas kaq shumë vitesh. Më vjen
8 keq për këtë.

9 PY. Në rregull atëherë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Do të shohim një dokument. Dokumenti
11 ka numrin P01188.1. Të shkojmë pak më poshtë.

12 PY. Është artikull i *The New York Times*, "New York, është e
13 shtunë". Shohim titullin e artikullit bashkë me një fotografi:
14 "Rebelët në Kosovë marrin përsipër qytetet, raportohet se ka
15 raste dhune". A ju kujtohet kjo faqja e *The New York Times*?

16 PË. Pas 26 vitesh nuk më kujtohet ky artikull konkret i
17 gazetës.

18 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në ekran. Më
19 poshtë, ju lutem. Po. Do t'ju lexoj ku thotë: "15 të burgosur
20 janë gjetur të plagosur - NATO merr disa armë". Shkojmë më
21 poshtë në të njëjtën kolonë. Po filloj të lexoj. Pak më poshtë
22 më duket.

23 PY. Lexohet si në fillim:

24 "Natyra e ndryshueshme e akteve të NATO-s u ilustrua këtu
25 sot pasdite kur trupat gjermanë hynë në një ish-seli të

1 policisë serbe që e kishte marrë përsipër UÇK-ja, ndaluan
2 shkurtimisht 25 prej forcave guerile dhe sekuestruan një
3 grumbull me armë.

4 "Brenda stacionit të policisë, trupat gjermanë gjetën 15
5 persona që ishin burgosur, përfshirë një të moshuar që u gjet
6 i vdekur i prangosur në një karrige dhe i rrahur keqazi, sipas
7 zëdhënësit gjerman."

8 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në pjesën tjetër.
9 " ... sipas zëdhënësit gjerman ...", në faqen 2.

10 Kolona e parë, po vazhdoj:

11 "... tek të burgosurit përfshiheshin serbë, shqiptarë dhe
12 egjiptianë. Nuk ishte e qartë pse ishin arrestuar, po disa
13 prej personave thanë se te të burgosurit kishte informantë
14 edhe hajdutë.

15 "Një burrë kishte një rrip të kuq në shpinë, një i
16 moshuar kishte një fashë përgjatë kokës dhe të prera në
17 fytyra, një tjetër ishte goditur me thikë në këmbë."

18 Pra, ju, Dëshmitar, ju po thoni që nuk ju kujtohet kjo
19 histori konkrete nga *The New York Times* që ka qenë në ballinën
20 e *The New York Times* dhe ju keni dëshmuar se keni qenë
21 pikërisht në Kosovë në atë kohë dhe ju nuk keni dëgjuar asgjë
22 për këtë?

23 PË. Mbase kam dëgjuar lidhur me këtë incident, mund të kemi
24 bërë thirrje për tolerancë, kemi bërë thirrje që të mos bëhej,
25 të mos merrej hak për vrasjet masive që ju bënë shqiptarëve

1 dhe serbëve dhe kemi inkurajuar shokët e komunitetit shqiptar
2 të Kosovës të mos merrnin hak, pra, për atë që ju kishte
3 ndodhur për horrorin që kishin përjetuar dhe sigurisht që ne i
4 kemi dekurajuar aktivitete të tilla.

5 Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin dhe të vendosim në
6 ekran dokumentin P04185.

7 PY. Këtu është një dokument i cnn.com, shohim dhe datën 19
8 qershor 1999.

9 Z. PACE: [Përkthim] Dhe, në fakt, tani do të doja që të
10 shikonim faqen me numër 013439. Dhe do të lexoj nga pjesa ku
11 thuhet "KFOR-i liron personat që kishte rrëmbyer UÇK-ja".

12 PY. "Edhe me forcat jugosllave që po largoheshin për të marrë
13 kontrollin e plotë ishte ende vështirë. KFOR-i nuk duhej të
14 monitorojë vetëm tërheqjen jugosllave, por duhet të kujdeset
15 që të mos ketë shpagim nga shqiptarët etnik ndaj minoritetit
16 serb si dhe duhet të kenë kujdes sepse po kthehen me qindra,
17 mijëra drejt Jugosllavisë.

18 "Të premtën trupat e KFOR-it gjerman hynë, bastisën një
19 ish-stacion të policisë në Prizren që ishte marrë nga forcat e
20 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shpëtuan 15 të burgosur që
21 mesa duket ishin rrahur nga rrëmbyesit e tyre."

22 Pra, ky është një raport i CNN-it. Nuk ju kujtohet ky
23 raport, nuk ka qenë një raport që e keni lexuar?

24 PË. Mundet. Sigurisht që KFOR-i personat, inkurajonin
25 kosovarët që të mos merrnin hak ndaj popullatës serbe për

1 shkak të sulmeve masive dhe vuajtjeve që kishin pësuar.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

3 PY. Dëshmitar, pasi u larguat nga Kosova vijuat t'i ndiqnit
4 zhvillimet në Kosovë ju pas marrëveshjes së qershorit 1999?

5 PË. U ktheva në Kosovë për një marrëveshje në Luginën e
6 Preshevës që të mos lejohej dhuna atje, besoj se kjo
7 marrëveshje ka qenë e suksesshme sepse pati disa akte dhune në
8 Luginën e Preshevës.

9 PY. Kur ka qenë kjo, ju kujtohet?

10 PË. Disa muaj pas qershorit. Konkretisht nuk më kujtohet. Kam
11 qenë me Ambasadorin Chris Hill, mesa më kujtohet, në Kosovë, u
12 përpoqëm që të parandalonim aktet e reja të dhunës në Luginën
13 e Preshevës dhe më vonë na raportuan se përpjekjet tona qenë
14 të suksesshme.

15 PY. Kur u kthyet në Washington pas qershorit të 1999-s vijuat
16 t'i ndiqnit raportet e medias ju lidhur me Kosovën në atë
17 kohë? Pra, nga qershori e në vijim.

18 PË. Jam përpjekur për shkak të përfshirjes personale që pata
19 në marrëveshjen e demilitarizimit, jam përpjekur që të isha në
20 dijeni për gjërat që po ndodhnin. Më kujtohet që kam ndjekur
21 deri nga viti 2000. Përpiqesha të isha i informuar me aq sa të
22 kisha mundësi për ngjarjet në Kosovë.

23 PY. Po gjatë kohës që ndiqnit konfliktin, a ju kujtohet të
24 jetë raportuar krime prej anëtarëve të UÇK-së?

25 PË. Besoj se do të kisha mësuar. Po, gjithashtu, e kam të

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace (Vazhdim)

Faqe 32

1 qartë se ka pasur dhe shumë gjëra që u zbuluan në fakt edhe
2 pas luftës.

3 Z. PACE: [Përkthim] Tani është momenti i përshtatshëm për
4 pushimin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
6 momenti më i përshtatshëm për pushim. Dëshmitar, mos flisni me
7 askënd për dëshminë tuaj. Do të kthehemi në sallë në orën
8 10.10.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushin deri
11 në orën 10.10.

12 --- Pauza fillon në orën 09.59

13 --- Seanca rifillon në orën 10.10

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dua t'ju njoftoj
16 se sa i takon dëshmitarit të radhës ne i kemi kërkuar Zyrës
17 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve që dëshmitari të jetë këtu pas
18 pushimit të drekës. Në qoftë se besoni që duhet ta thërrasim
19 pak më herët, duhet të na e thoni këtë gjë në mënyrë të tillë
20 që ta njoftojmë paraprakisht 45 minuta zyrën përkatëse për ta
21 sjellë dëshmitarin.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se
25 erdhët. Z. Rubin, do të vazhdojmë më tej me pyetjet e z. Pace.

1 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të paraqesë
2 në ekran dokumentin DHT01910 deri në DHT11916, që tani është
3 pranuar si provë me numrin 1D291.

4 PY. Ky është një artikull i *The New York Times* që e keni
5 diskutuar në dëshminë tuaj po gjithashtu edhe gjatë marrjes në
6 pyetje, mban datën 25 qershor 1999. Dy paragrafët e parë të
7 këtij artikulli thonë si më poshtë:

8 "Komandantët e lartë të UÇK-së të cilët kanë nënshkruar
9 një marrëveshje çarmatimi me NATO-n kanë kryer vrasje,
10 arrestime dhe kanosje ndaj personave brenda rangjeve të tyre
11 thonë disa komandantë dhe ish-komandantë të ushtrisë rebele
12 për disa prej diplomateve perëndimorë.

13 "Fushata, në të cilën janë të përfshirë disa prej
14 komandantëve kryesorë të rebelëve janë qëlluar, kanë vdekur
15 dhe kjo është një fushatë e cila është drejtuar nga Hashim
16 Thaçi dhe dy prej zëvendësve të tij, Azem Syla dhe Xhavit
17 Haliti, thonë këta zyrtarë. Z. Thaçi ka mohuar përmes një
18 zëdhënësi që ai është përgjegjës për vrasje të tilla."

19 Z. PACE: [Përkthim] Tani le të vazhdojmë me një tjetër
20 pjesë të këtij artikulli. Të vazhdojmë pak më poshtë. Do
21 filloj nga paragrafi që fillon me "Akuzat ...".

22 "Akuzat për vrasje dhe për përndjekje janë bërë në
23 intervista me disa prej zyrtarëve aktual dhe ish-zyrtarëve të
24 UÇK-së, dy prej të cilëve thanë që kanë parë me sytë e veta
25 ekzekutimet e rivalëve të z. Thaçi, një diplomat i lartë, ish-

1 diplomat i lartë i qeverisë shqiptare, një zyrtar, një ish-
2 zyrtar polic i Qeverisë Shqiptare i cili ka punuar me grupin e
3 rebelëve ju ka raportuar diplomatëve perëndimorë.”

4 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

5 PË. Jo.

6 PY. Në rregull.

7 Z. PACE: [Përkthim] Le të vazhdojmë me një tjetër
8 dokument, dokument që mban numrin DHT05180 deri në DHT05189.
9 Nuk e di se sa e kanë numrin e provës ky dokument. Ndoshta
10 kolegët mund të më ndihmojnë me këtë. Faleminderit.

11 PY. Dokumentin e kemi në ekran, Dëshmitar. Në të djathtë në
12 ekranin tuaj shihni një deklaratë një njoftim për shtyp që
13 është dhënë të njëjtën ditë që është botuar artikulli që e
14 kemi në të majtë të ekranit, domethënë, data është 25 qershor
15 1999.

16 Z. PACE: [Përkthim] Le të shikojmë njoftimin për shtyp që
17 keni dhënë ju të njëjtën ditë. Të fillojmë dhe të shohim në
18 veçanti faqen DHT05186, do të lexoj pyetjen dhe përgjigjet.
19 Dhe ndërkohë që shfaqet dokumenti ky është një dokument i cili
20 është pranuar tanimë në prova dhe ka numrin e provës materiale
21 1D295.

22 PY. Sikurse e thashë, Dëshmitar, në dokumentin në të djathtë
23 në ekran unë do lexoj nga pyetja e parë që është bërë aty dhe
24 më pas do të vazhdoj me përgjigjen. Pyetja është kjo:

25 “A kanë thënë ata ndonjë gjë tjetër më tepër sesa ajo ça

1 keni cituar ju sot paradite në raport lidhur me z. Thaçi dhe
2 me urdhërimin e tij të pretenduar?

3 "Z. Rubin: Nuk kam shumë për të thënë lidhur me këtë
4 përveç asaj që kam thënë deri tani. Dua të them që ne nuk kemi
5 informacion për të mbështetur këto pretendime se ka pasur
6 aktivitete të tilla ose veprimtari të tilla të vrasjeve ose
7 urdhrave për ekzekutimin të cilat janë dhënë nga lidershipi.
8 Është e vështirë që të komentohet më tej për pretendime të
9 tilla janë të paprovuar dhe të cilat janë të mbështetura.

10 "Në mënyrë më të gjerë unë do thoja këtë. UÇK-ja është
11 përfshirë në një situatë ku njerëzit e Kosovës janë përballuar
12 me një opresion real nga forcat serbe. Nuk ka një strukturë
13 siç është në perëndim, nuk ka një forcë parlamentare dhe nuk
14 ka rend. Këto janë elemente që ne dëshirojmë që të krijojmë.
15 Ajo çfarë kemi bërë me UÇK-në dhe me udhëheqësit e saj është
16 që t'i inkurajojmë ata që të ndjekin objektivat përmes
17 transformimit dhe organizimit të tyre, përmes mjeteve
18 demokratike që ato tanimë i kanë të disponueshme përmes
19 pranisë të forcave të NATO-s nga aspekti i sigurimit dhe
20 prania e misionit të Kombeve të Bashkuara në aspektin civil.
21 Kjo është rruga që ne dëshirojmë që ata të marrin.

22 "Sa i takon burimeve anonime dhe pretendimeve të tyre nga
23 këndvështrimi im ato janë të paprovuara dhe janë thjesht të
24 pambështetura.

25 "Pyetje: Por ka shumë raporte të kësaj natyre, a ju

1 shqetësojnë këto?

2 "Z. Rubin: Unë përsëri në mënyrë të vazhdueshme më
3 kërkohet dhe më bëhet pyetja që në qoftë se UÇK-ja është e
4 përfshirë në trafikim droge dhe unë në mënyrë të vazhdueshme
5 them që nuk kam asnjë konfirmim të pavarur lidhur me këtë.
6 Tani ju po më pyesni në qoftë se lidhshipi i UÇK-së është
7 përgjegjës për ekzekutimet, dhe unë po ju them që nuk kemi
8 asnjë informacion për ta konfirmuar ose për ta mbështetur
9 këtë. Unë ju kam dhënë shpjegime të gjëra dhe të gjata,
10 megjithatë, ne nuk kemi asnjë mbështetje nga rajoni për sa i
11 takon provueshmërisë së këtyre pretendimeve anonime. Personi
12 i vetëm i cituar në të vërtetë është një oponent politik i
13 cili nuk i referohet specifikisht një pretendimi specifik dhe
14 nuk thotë asgjë tjetër të detajuar."

15 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: Në kohën që
16 është bërë kjo deklaratë, 25 qershor 1999, a keni marrë, a
17 kishit informacionit ju lidhur me identitetin e burimeve që
18 kishte përdorur si bazë artikulli i *The New York Times* që mban
19 po ashtu datën 25 qershor 1999?

20 PË. Autori i këtij artikulli në mënyrë të rregullt ka shkruar
21 fjali të cilat kanë qenë të rreme.

22 PY. Dëshmitar, nuk po ju përgjigjeni pyetjes time.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjojeni dhe
24 një herë pyetjen dhe ju lutem jepini përgjigje pyetjes.

25 Z. PACE: [Përkthim]

1 PY. Do ta përsëris edhe një herë pyetjen. Në kohën kur e keni
2 bërë këtë deklaratë, domethënë, më 25 qershor 1999, a e dinit
3 ju se kush ishte identiteti i burimeve ku është mbështetur
4 artikulli i *The New York Times* i cili po ashtu mban datën 25
5 qershor 1999? Duhet t'i përgjigjeni me "po" ose "jo".

6 PË. Nuk më kujtohet që kam kërkuar burime sepse kisha
7 dyshimet e mia për autorin.

8 PY. Sa i takon autorit të këtij artikulli Chris Hedges, juve
9 thatë dje që ky person është hequr nga puna nga *The New York*
10 *Times* për shkak të gabimeve të rregullta ose të përsëritura që
11 ka bërë ai. Në paragrafin 81 të deklaratës tuaj ju thoni që:

12 "Hedges, me ç' duket ishte një gazetar i pabesueshëm dhe
13 është hequr nga puna nga *The New York Times* për shkak të
14 gabimeve të përsëritura që ka bërë."

15 Dëshmitar, kjo nuk është deklaratë e saktë që ka të bëjë
16 me z. Hedges?

17 PË. Kështu e kam kuptuar unë, sepse unë jam konsultuar në
18 mënyrë të vazhdueshme me redaktorët e *The New York Times* dhe
19 kjo është mënyra se si e kam kuptuar unë vijimësinë e punës së
20 tij. Unë mendoj që kam pasur burime të mira sepse është hequr
21 nga puna z. Hedges.

22 PY. Chris Hedges ka fituar një çmim *Pulitzer* për mbështetjen
23 dhe për punën e tij, apo jo?

24 PË. Kjo nuk ka të bëjë me përgjigjen që dhashë unë.

25 PY. Në fakt kjo nuk është përgjigja që kërkon pyetja ime.

1 Pyetja ime është kjo që: A jeni ju në dijeni që ky person,
2 pra, ky gazetar ka marrë një *Pulitzer Prize*, Çmimin *Pulitzer*
3 për gazetarinë?

4 PË. Kjo nuk ka lidhje me pyetjen tuaj.

5 PY. Në rregull. Le të shohim një dokument tjetër.

6 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja që të paraqitet në ekran
7 dokumenti që përfundon me 0029761.

8 PY. Atëherë kjo është faqja e parë e Çmimeve *Pulitzer*. Dhe
9 këtu shikoni listën e Çmimeve *Pulitzer* dhe shikoni që sipas
10 këtij raporti jepet se kush janë personat që e kanë marrë këtë
11 çmim. Mund të lexoni dhe emrin e gazetarit në fjalë.

12 Z. PACE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja e dytë e
13 këtij dokumenti. Këtu është një listë e "Punëve Fituese" të
14 këtij çmimi. Dhe në qoftë se do të vazhdojmë në faqen e tretë
15 të këtij dokumenti do të lexoni si pjesë të së njëjtës listën
16 ne kemi datën 27 dhjetor 2001 "Sinjale të harruara: Terror
17 ..". Pra, e shikoni, domethënë, që një ndër autorët e këtij
18 artikulli është Chris Hedges, domethënë, mund ta lexoni është
19 artikulli i cili është shkruar nga Steven Erlanges dhe Chris
20 Hedges.

21 PY. Po, e shikoj. Po Chris Hedges është autori i dytë i këtij
22 artikulli.

23 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument një herë.

24 PY. Chris Hedges nuk është hequr nga puna nga *The New York*
25 *Times*. Por ka pasur personalitete të ndryshme të medias si,

1 për shembull, Sean Hannity, që kanë bërë thirrje që të hiqej
2 nga puna ky gazetar për shkak të raportimeve që ai ka bërë
3 lidhur me Irakun dhe, siç e dimë, Hedges është tërhequr vetë,
4 domethënë, ka ikur vetë nga puna.

5 PË. Zakonisht skenari është i tillë, që kur dikush ikën nga
6 puna, domethënë, ikën se i kërkohet të largohet, domethënë,
7 është një lloj heqje nga puna.

8 PY. Do të thotë kjo deklarata që keni thënë ju që personi
9 është hequr nga puna është e pasaktë?

10 PË. Në atë çfarë bëj unë në profesionin tim, në qoftë se
11 dikush bën një punë të keqe dhe në qoftë se ky person tërhiqet
12 nga puna, ikën vetë nga puna, kjo është një mënyrë tjetër më
13 elegante e heqjes nga puna të këtij personi, është e njëjta
14 gjë.

15 Z. PACE: [Përkthim] Më lejoni një çast ju lutem të
16 konsultohem me kolegët.

17 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

18 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Tani dëshiroj të paraqitet në ekran dokumenti

20 SPOE00397266-00397270. Këtu në krye shikoni *The New York*
21 *Times*, "Si ishte që të punoje për televizionin shtetëror rus",
22 shkruar nga Cecilia Kang, data është 12 mars 2022. Kalojmë në
23 faqen që përfundon me 68, do lexoj fjalinë e fundit që është
24 marrë nga ky artikull i *The New York Times*.

25 PY. Dhe thuhet që:

1 "Z. Solodovnikov" -- nuk do e lexoj këtë fjali, do
2 vazhdojmë tej që, "Z. Hedges e kishte lënë punë për *The New*
3 *York Times* në vitin 2005 pas asaj çfarë ai e përshkruan si
4 mosmarrëveshje të brendshme lidhur me luftën në Irak."

5 A e lexoni që këtu thuhet që z. Hedges e ka lënë vetë
6 punën, z. Dëshmitar?

7 PË. Po, e shoh këtë.

8 PY. Domethënë, ajo çfarë ka botuar zyrtarisht gazeta është e
9 gabuar?

10 PË. Jo, unë edhe një herë po ua shpjegoj që qëndrimi im është
11 që në qoftë se ti thua që dikush e ka lënë punën, kjo është
12 një mënyrë më elegante e dikujt të cilit i kërkohet që të mos
13 punojë më për një organizatë të caktuar.

14 PY. Ju keni thënë në deklaratën tuaj që gazetari ka bërë
15 gabime të përsëritura dhe për këtë arsye ky person është hequr
16 nga puna. E ke thënë këtë?

17 PË. Po.

18 PY. Megjithatë, dëshmia juaj nuk është kjo që ajo çfarë ai ka
19 thënë lidhur me luftën në Irak në 2004-n ka çuar në largimin e
20 tij prej pune?

21 PË. Atëherë përshtypja ime është që ky është një gazetar i
22 cili e ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme, ka dhënë gabime
23 në raportimet e tij, në artikujt e tij dhe *The New York Times*
24 është dashur që të paguajë në dëmshpërblime miliarda e
25 miliarda euro, kështu që unë për veten time do ta them dhe një

1 herë tjetër, që në qoftë se dikush ikën nga puna në një
2 situatë të tillë, kjo është një mënyrë më elegante e largimit
3 nga puna, por ndërkohë e vërteta është që personi është
4 kërkuar që të largohet nga puna për shkak të gabimeve të
5 përsëritura.

6 Unë personalisht njoh shumë prej kolegëve. Jam një
7 vëzhgues nga afër i gazetarisë, i gazetarëve, kështu që ky
8 është gjykimi im në përmbledhje si një person që i vëzhgon me
9 kujdes zhvillime të tilla që në qoftë se dikush nuk vlerësohet
10 më për punën që bën dhe në vend që të hiqet në mënyrë të
11 shprehur personi, domethënë, thjesht ikën nga puna dhe jep
12 dorëheqjen me fjalë të tjera, po për mua është e njëjta gjë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Le ta heqim këtë dokument nga ekrani.
14 PY. Dëshmitar, Mbrojtja e z. Thaçi më datë 25 gusht të këtij
15 viti ka thënë që ju nuk keni pranuar që të merreni në pyetje
16 nga ZPS-ja. A mund të na jepni arsyen pse e keni bërë këtë
17 gjë, Dëshmitar?

18 PË. Është pyetje e mirë. Mendoj që jam munduar pafund që të
19 jem i disponueshëm për këtë Gjykatë. Kam shpenzuar qindra orë
20 përgatitje dhe ndjesia ime ishte që të gjitha njohuritë që unë
21 i kisha ishin të pranishme në dokumentet që kam dhënë. Dhe
22 mendoj që pikëpamjet e Prokurorisë nuk është se do të
23 ndihmoheshin nga kontributi im i mëtejshëm, por mendoj që e
24 kam dhënë të gjithë informacionin, domethënë, në qoftë se ju
25 keni nevojë për pyetje unë kam qenë këtu dje dhe sot, kështu

1 unë jam këtu për të marrë të gjithë kohën tuaj për të bërë të
2 gjithë pyetjet që keni lidhur me ne.

3 PY. Dëshmitar, unë mendoj që pikëpamjet tuaja për Prokurorinë
4 ia vlejné që të përmenden këtu. A mund të na i thoni se cilat
5 janë këto pikëpamje, Dëshmitar?

6 PË. Fakti që të akuzuarit kanë qenë në burg, janë në
7 paraburgim këtu në Hagë për më shumë sesa pesë vite, dhe fakti
8 që ato janë dorëzuar vullnetarisht dhe fakti që janë mbajtur
9 të ndaluar për kam shumë gjatë më shqetëson. Mendoj që lidhet
10 me politikën dhe me shtetin e së drejtës. Dhe mua më shqetëson
11 fakti që dikush të jetë i paraburgosur për pesë vite përpara
12 sesa të fillojë të ndiqet penalisht një çështje penale,
13 ndërkohë që këta persona kanë dhënë, vullnetarisht janë
14 dorëzuar, vullnetarisht dhe kanë qenë shumë bashkëpunues me
15 Gjykatën. Kështu që në rastin e të akuzuarit në fjalë nuk e
16 kuptoj fare se pse është dashur që të qëndrojnë në burg për
17 pesë vite. Unë për veten time nuk e shikoj këtë si shtet të së
18 drejtës ose sundim të ligjit që shpresoja që të krijohej nga
19 sistemi ndërkombëtar ose të paktën, pa diskutim, Sekretarja
20 Albright nuk ka pasur këtë lloj drejtësie në mendje kur ka
21 iniciuar krijimin e ish-Tribunalit të Hagës kundër
22 Jugosllavisë ose atë të Ruandës.

23 Kështu që mua kjo vetëm më është dukur si një fajësim
24 kolektiv, për shkak të faktit se i akuzuari ka qenë udhëheqës
25 i UÇK-së. Duke qenë se i kam parë nga afër liderët e UÇK-së

1 nëpër male, nëpër bjeshkë dhe mendoj që asnjë person tjetër
2 jashtë UÇK-së s'e ka pasur këtë mundësi duke pasur një ide të
3 mirë të funksionimit të UÇK-së, unë për tre ditë me radhë kam
4 parë nga afër sesi janë sjellë ata, se kush ishte përgjegjës,
5 kush ishte komandanti, kush ishte mbështetës, duke pasur këtë
6 lloj njohurie dhe duke ditur siç kanë qenë zhvillimet, unë
7 vërtetë mendoj që kjo ka qenë e gabuar, kjo nuk është
8 drejtësi.

9 Unë nuk jam jurist me profesion, megjithatë kam të drejtë
10 të shfaq dhe të them me zë të lartë opinionin tim.

11 PY. Unë ju pyeta sepse e rrëzuat kërkesën e ZPS-së për t'ju
12 marrë në pyetje, ndërkohë që ju më dhatë një shtjellim të
13 hollësishëm të qëndrimit tuaj. Është e saktë, apo jo,
14 Dëshmitar, që kur ne u informuam që ju nuk ishit i gatshëm që
15 të bënit pyetje me ne më 25 gusht, juve më pas jeni takuar me
16 Mbrojtjen përpara seancës përgatitore më datë 3 dhe 8 shtator
17 2025? A është e saktë kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Në përgjigjen tuaj ju thatë që jeni përgatitur me qindra
20 orë për të qenë dëshmitar i Mbrojtjes. A mund të na thoni
21 çfarë keni bërë në këto qindra orë, Dëshmitar?

22 PË. Pesë ose gjashtë vite më përpara, kur kam filluar që të
23 dëgjoj për herë të parë për këtë gjykim. Fillova që të shikoja
24 formacionin, përbërjen e këtij tribunali sepse është krijuar,
25 kam fol me akademikë. Kam fol me juristë. Jam përpjekur

1 gjithashtu që të rishikoj, të shqyrtoj me aq sa di unë,
2 artikujt me shkrim ose dokumente të cilat janë paraqitur në
3 ekran, të cilat lehtësisht shfaqen këtu, po nuk kanë qenë
4 lehtësisht të shfaqura për mua. Dhe rilexova shumë nga
5 materialet ose artikujt. Jam takuar gjithashtu dhe me ekipin e
6 Mbrojtjes në Washington ndoshta një herë ose mbase dhe dy
7 herë. Jam takuar një ditë të plotë një herë ose dy ditë të
8 plota. Kam menduar, kam kaluar pesë vite duke folur, duke
9 menduar për të, duke u përgatitur me të. Mendoja nga viti në
10 vit që do hapet gjykimi sot e do hapet nesër. Ndërkohë që
11 vitet kalonin dhe asgjë s'ndodhi për shumë vite.

12 Pra, për shumë vite kam menduar për të, kam lexuar për
13 të, kam vrarë mendjen se pse u deshën pesë vite për të krijuar
14 një çështje të tillë, ndërkohë që aktakuza është ngritur pesë
15 vite më përpara. Nuk e kuptoja gjithë këtë. Dhe i kam pyetur
16 njerëzit e kësaj fushe, kësaj lëmie. I kam thënë në qoftë se
17 një gjë e tillë ishte normale apo jo. Kam folur me juristë e
18 me avokatë me emër ndërkombëtar që më kanë thënë që kjo është
19 mënyrë e pazakontë për të trajtuar një burrë shteti i cili
20 është dorëzuar vullnetarisht dhe në juridiksionin e një
21 gjykate që e ka krijuar vetë kur ka qenë kryeministër dhe për
22 të treguar liderëve evropian që kishte dëshirë vendi që të
23 bëhej pjesë vend i BE-së, ndërkohë që ky burrë shteti mbahet i
24 ndaluar për pesë vite përpara sesa çështja të ishte gati. Pra,
25 këto janë gjërat me të cilat e kam mbajtur mendjen të mbushur

1 dhe për të cilat kam menduar për orë e orë të tëra.

2 PY. Pesë apo gjashtë vite më përpara a ju ka kërkuar ndonjë
3 person që të shihni këtë tribunal që të merrnit vesh më tepër
4 për këtë tribunal?

5 PË. Jo. Kur e kam dëgjuar për herë të parë.

6 PY. Hashim Thaçi ose personat që kanë përfaqësuar Hashim
7 Thaçin, kur të kanë kontaktuar për herë të parë lidhur me këtë
8 çështje dhe për sa i takon ZPS-së?

9 PË. Përpara sesa t'i përgjigjem pyetjes, më duhet të them që
10 unë kam punuar në pjesën ose në degën ekzekutive të Shteteve
11 të Bashkuara. Kam qenë shumë i zënë në profesionin tim, në
12 punën time, kam qenë gjithashtu edhe këshilltar i Sekretarit
13 Blinken nga viti 2022 deri në 2025. Dhe, më duhet të them, që
14 për dëshirën time për të qenë i disponueshëm në Gjykatë, po
15 ashtu ka shpenzuar shumë orë për të siguruar që Departamenti i
16 Shtetit të më lejonte të jepja dëshmi. Ishte vërtetë një barrë
17 e shtuar për mua, domethënë, me gjithë angazhimet dhe gjithë
18 punët që kisha më duhej që të mendoja dhe për këtë.

19 Ndërkohë që sa i takon pyetjes tuaj që kush më ka
20 kontaktuar për herë të parë, mendoj që Pierre Prosper më ka
21 kontaktuar së pari, që është ish-prokuror i krimeve të luftës
22 në Amerikë.

23 Gjithashtu dëshiroj që të them që kam punuar dhe në OECD
24 në Paris dhe më duhet të them që ndërkohë kisha shumë
25 angazhime të tjera, kam menduar dhe për këtë Gjykatë.

1 Dhe pavarësisht kësaj, unë jam përpjekur që të bëj të
2 pamundurën time për të qenë i disponueshëm dhe për t'i dhënë
3 të gjithë respektin e merituar një gjykate. Dhe unë u pajtova
4 me faktin që të isha një dëshmitar.

5 Kam qenë në kontakt me z. Prosper për pesë vite dhe gjatë
6 këtyre pesë viteve jam përgatitur për dëshminë time që filloj
7 dje.

8 PY. Pyetja ime ishte kur ju kanë kontaktuar për të qenë
9 dëshmitar i z. Thaçi. Ka qenë përpara pesë viteve, në 2020-n?

10 PË. Nuk e di ç'a do të thuash kur thua që kur e kontaktove,
11 megjithatë mendoj që ka qenë pak a shumë katër vite më
12 përpara, mbase në 2020-n, domethënë, nuk më kujtohet mirë
13 megjithatë e di që kam kontaktuar në momentin kur kam punuar
14 me OECD në Paris dhe jam takuar me ekipin tim ligjor në Paris.
15 Katër vite më përpara të paktën.

16 PY. Atëherë nuk e bëra ndoshta unë formulimin siç duhet.
17 Formalisht, zyrtarisht apo jo zyrtarisht kur je kontaktuar për
18 herë të parë për të qenë dëshmitar i Mbrojtjes së z. Thaçi dhe
19 kur ju kanë kontaktuar sa i takon çështjes së ZPS-së kundër z.
20 Thaçi?

21 PË. Me aq sa më kujtohet mua unë jam kontaktuar kam qenë në
22 Paris. Mendoj që jam kontaktuar rreth katër vite më përpara.
23 Mendoj që jam njoftuar lidhur me këtë sa i takon gjykimit edhe
24 sa i takon takimit të bërë nga Shtëpia e Bardhë që u anulua.
25 Ajo çfarë më kujtohet tani, se nuk i kam gjërat shumë të qarta

1 për shkak të kohës së kaluar, por ka qenë diku nga tetori i
2 2020-s dhe nga vjeshta e 2021-shit. Pra, nga tetori i 2020-s
3 dhe deri në tetor të 2021-shit. E di që ka qenë vjeshtë, e di
4 që kam qenë në Paris dhe z. Prosper që më ka kontaktuar dhe më
5 ka pyetur në qoftë se jam i gatshëm që të vij si dëshmitar për
6 Mbrojtjen e Thaçit.

7 PY. Për të qartësuar, ju thatë që koha që "më kujtohet me
8 saktësi është Parisi, po kjo ka qenë pas kontaktit paraprak".
9 Kush ka qenë kontakti paraprak?

10 PË. Z. Pierre Prosper, ish-prokuror për krime lufte të cilin
11 e njihja që nga koha ime kur punoja në qeveri dhe isha zyrtari
12 përgjegjës ku kisha kaluar -- i cili kishte kaluar gjithë
13 jetën e tij duke ndjekur penalisht kriminelët e luftës së
14 vërtetë.

15 PY. Nuk ju pyeta për t'i bërë komplimente atij, ju pyeta kush
16 ishte. Nëse mund të kufizoheni në përgjigjet tuaja për këtë
17 pyetje që ju bëj.

18 Para takimit të Parisit që ju përshkruat, cili ishte
19 kontakti i fundit që keni patur me ndonjë person që vepronte
20 në emër të Thaçit apo në interes të tij, me sa ju kujtohet?

21 PË. Më duket që ju përgjigja kësaj. Nuk mund të jem më i
22 saktë.

23 PY. Po përpara kontaktit me z. Prosper?

24 PË. Siç e thashë, tani më duket që po merrem në pyetje në
25 mënyrë të panevojshme, ka qenë, pra, diku në mes dhënies

1 publike, nxjerrjes publike të aktakuzës dhe takimit tim në
2 Paris, e thashë tre herë, z. Prosper më ka kontaktuar. Me sa
3 më kujtohet ka qenë mes kohës së aktakuzës në tetor 2020 dhe
4 kohës kur jam takuar në Paris. Nuk më kujtohet data e saktë
5 kur më ka kontaktuar, por ka qenë diku në atë periudhë, siç e
6 thashë katër herë deri tani.

7 PY. Përpara që z. Prosper t'ju takojë në këtë periudhë, kur
8 ka qenë hera e fundit që dikush ju ka kontaktuar dhe që ky
9 person vepronte në emër dhe vinte për z. Thaçin, në qoftë se
10 ju kujtohet?

11 PË. E keni fjalën për gjykimin apo thjesht që më kanë
12 kontaktuar?

13 PY. Për çdolloj çështjeje.

14 PË. Hera e fundit që kam qenë në kontakt me z. Thaçi siç e
15 thashë dje në dëshminë time, në periudhën 2020 kur kam qenë
16 përfaqësues, që përfaqësoja atë në kërkim të një pageje të
17 përherëshme, marrëveshje, paqe të përherëshme me Serbinë. Në
18 këtë periudhë 2020 përpara aktakuzës kam punuar me të, kam
19 biseduar me të gjatë vitit 2020. Ka qenë hera e fundit që më
20 kujtohet të jem takuar dhe të kem biseduar me z. Thaçi apo
21 ndonjë prej përfaqësuesve të tij formal.

22 PY. Dhe kjo ka qenë gjatë kohës që ju ishit i angazhuar në
23 Ballkan, pra, duke punuar me Ballad dhe partnerët që punonin
24 me kontrata me Kosovën?

25 PË. Kontrata është nënshkruar përpara që të shkoja atje dhe

1 isha shumë i gëzuar që të merrja pjesë në të, që t'i jepja
2 fund konfliktit midis Serbisë dhe Kosovës.

3 PY. Në takimin tuaj me z. Thaçi apo takimet ndërkohë që ju
4 ishit të angazhuar me partnerët tuaj për këtë, në periudhën
5 2020, që ju e përmendët, a diskutuat me z. Thaçi ndonjë gjë,
6 diçka që ka të bëjë me këtë Gjykatë?

7 PË. Nuk më kujtohet çdo gjë që kemi biseduar. Pjesa kryesore
8 e diskutimeve tona kishte të bënte me paqen e përhershme me
9 Serbinë. Ne kemi diskutuar, kjo ka qenë pika e punës ose tema
10 e punës. Diçka tjetër mund të ketë qenë anësore.

11 PY. Në qoftë se ka patur diskutime lidhur me këtë Gjykatë me
12 z. Thaçi që mund të kenë ndodhur rastësisht, pra, lidhur me
13 atë që a mund të ketë ndodhur?

14 PË. Kështu është. Nuk më kujtohet që të ketë pasur biseda të
15 tilla por nuk i përjashtoj që dhe mund të kenë ndodhur.

16 PY. E keni lexua aktakuzën në këtë çështje?

17 PË. Jo.

18 PY. A keni lexuar dosjen paraprake të Zyrës së Prokurorit të
19 Specializuar në këtë çështje?

20 PË. Jo.

21 PY. A e keni lexuar dosjen paraprake të ndonjërit prej
22 Ekipeve të Mbrojtjes në këtë çështje?

23 PË. Jo.

24 PY. A e keni ndjekur deklaratat hyrëse në këtë çështje?

25 PË. Jo.

- 1 PY. A e dini kur janë mbajtur deklaratat hyrëse në këtë
2 çështje?
- 3 PË. Datën e saktë nuk e di, jo.
- 4 PY. A keni ndjekur procesin, zhvillimin e gjykimit në këtë
5 çështje?
- 6 PË. Po.
- 7 PY. Cilin?
- 8 PË. Mendoj që në përgjithësi kam ndjekur raportet publike që
9 janë bërë lidhur me këtë çështje. Por nuk i kam lexuar këto
10 njoftime të sakta, nuk jam jurist dhe nuk e kisha të nevojshme
11 të lexoja të gjitha parashtimet që janë bërë apo që janë bërë
12 publike.
- 13 PY. A e kuptoj saktë që ju nuk keni, për shembull, parë në *on*
14 *line* apo në video të ndryshme të dëshmive të dëshmitarëve të
15 tjerë?
- 16 PË. E saktë.
- 17 PY. Tani kthehem pak te ato që ju përmendët me z. Ballard dhe
18 *Partners, Ballard Partners*. Thatë në paragrafin 20 të
19 deklaratës tuaj se keni qenë kryesuesi i strategjisë dhe
20 politikës ndërkombëtare në Washington DC deri në vitin 2020. A
21 mund të qartësoni kur në vitin 2020 keni qenë në këtë pozitë?
- 22 PË. Është pyetje e mirë. Kjo, ka qenë COVID. Kam qëndruar me
23 *Ballard Partners* deri në fund të vitit 2020. Por kam bërë
24 përpjekje të njëmenda kur mendova që Presidenti Biden do të
25 zgjidhej që unë të jepja dorëheqjen nga posti që kisha si

1 lobist i regjistruar, pra, i certifikuar sepse doja të isha në
2 gjendje të punoja për Presidentit Biden dhe hoqa dorë nga
3 funksioni i mëparshëm dhe është periudha e detyrueshme ligjore
4 që duhet të tërhiqesh përpara që të mund të bësh një tillë, me
5 qëllim që të isha i disponueshëm në janar të vitit 2021.

6 Pastaj shoku që ndodhi dhe tmerri, periudha zgjati dy vjet dhe
7 pastaj shkova në Paris për një vit. Kjo ishte tragjedi, por
8 nuk ishte ajo që kisha shpresuar.

9 Pra, po përpiqem të them sepse i përgjigjes drejtpërdrejt
10 pyetjes lidhur me rolin tim me *Ballard Partners* gjatë vitit
11 2020. Në fakt nuk kam përfaqësuar më klientë ndërkombëtarë
12 formalisht rreth një vit përpara se të prisja që dhe shpresoja
13 që Presidenti Biden të fitonte. Mendoj që pjesa më e madhe e
14 punës që kam bërë ka qenë në pranverë dhe pastaj nuk kam
15 punuar më tej. Dhe mendoj që kontrata ka skaduar rreth asaj
16 kohës, pra, në verë të vitit 2020.

17 PY. Ju përmendët që ju filluat në këtë post në vitin 2018. A
18 ju kujtohet kur në 2018 filluat të punonit me *Ballard*
19 *Partners*?

20 PË. Besoj ka qenë në janar. Jam larguar nga Londra në janar,
21 ndoshta kam filluar në shkurt, mars, prill 2018 duket kështu.

22 PY. Ju dëshmuat që *Ballard Partners* kishin një kontratë
23 tashmë me qeverinë e Kosovës. Kontrata konkretisht ishte me
24 qeverinë e Kosovës, apo jo?

25 PË. Po.

- 1 PY. Dhe Hashim Thaçi ishte presidenti në atë kohë që ju
2 firmosët kontratën?
- 3 PË. Po.
- 4 PY. Dhe ai vazhdoi të ishte president deri në kohën -- gjatë
5 kohës që ju keni qenë me Ballard?
- 6 PË. Po.
- 7 PY. A keni filluar të punoni me kontratën e Kosovës menjëherë
8 kur u bëtë pjesë e Ballard?
- 9 PË. Punë është në një firmë si kjo, është një zotëri tjetër
10 që ishte kryesisht përgjegjës për kontratën, i cili kishte
11 fituar tenderin për biznesin, kishin ndërvepruar me ekipin e
12 Kosovës. Dhe pastaj fillova unë punën time të re. Nuk më
13 njihnin shumë mirë. Mendoj që janë dashur disa muaj derisa të
14 përcaktoheshin rolet dhe përgjegjësitë tona respektive,
15 përkatëse të secilit dhe pas kësaj pike u vlerësua e arsyeshme
16 që unë të filloja të punoja me z. Thaçi sepse e njihja atë kaq
17 mirë dhe drejtuesi i firmës, themeluesi i firmës mendoj që
18 kishte kuptim që të merrja këtë rol duke patur parasysh
19 marrëdhënien time me z. Thaçi. Por kjo nuk ndodhi menjëherë.
20 Mund të ketë ndodhur mendoj në vjeshtë të 2018-s, mendoj kur
21 jam regjistruar së pari, mund të ketë qenë 2019 dhe pastaj kam
22 punuar përsëri, nuk më kujtohet saktësisht, nuk i kam këto
23 shënime me mua, këto të dhëna, por pak a shumë një vit. Dhe
24 pastaj kontrata skadoi. Në fakt mendoj ka qenë viti 2020.
- 25 PY. Dhe, në qoftë se mundem, apo transkripti është i gabuar,

1 dua të qartësoj është që ajo që desha të them me zyrën, pra, e
2 kisha fjalën.

3 PË. Kjo është. Kështu e kuptoj edhe unë.

4 PY. Dhe kontrata mes *Ballard Partners* dhe zyrës së
5 Presidentit të Kosovës ishte për 52.000 euro në muaj, saktë?

6 PË. Saktë.

7 PY. Dhe si pjesë e punës në Kosovë me *Ballard Partners* ju
8 jeni takuar të punësuar të ndryshëm të qeverisë amerikane,
9 pra, keni kontaktuar punonjës të ndryshëm të qeverisë
10 amerikane?

11 PË. Po.

12 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të shfaqim në ekran
13 SPOE00395244. Në rregull kështu. Ta zmadhojmë pak.

14 PY. Këtu shohim, këtu kemi emrin tuaj dërguar shumë personave
15 me emra të shumë personave adresat email, senatit, qeverisë.
16 Pra, me emrat që punojnë në qeveri dhe tema do të shohim është
17 "Zhvillimet e fundit në Republikën e Kosovës".

18 Dëshmitar, ju kujtohet që keni dërguar emaile të kësaj
19 natyre personave të tillë rreth kësaj kohe?

20 PË. Duhet të jem i qartë për këtë. Ky është email masiv, pra,
21 kolektiv, që është dërguar shumë njerëzve. Kjo mund të ketë
22 qenë në fakt thjesht për të shtypur butonin, mund të kem
23 shtypur butonin dikush që ka punuar në zyrë për klientët. Unë
24 s'besoj të kem shtyp, nuk do ta kisha shtypur këtë buton por
25 mund të vijë prej meje sepse kjo është mënyra sesi

1 funksionojnë gjërat, zhvillohen këto punë. Keni dikë që dërgon
2 një person të caktuar që dërgon emaile në masë, pra,
3 kolektive. Ky nuk është email specifik, konkrete. Nuk ishte
4 takim apo mbledhje. Nuk ishte diçka informacion i veçantë. Kjo
5 ishte, siç mund të shihet, zhvillimet e fundit, pra, është një
6 email kolektiv që ne dërgonim, besoj që kompania dërgonte të
7 gjithë klientëve emaile të këtij lloji. Por jam i sigurtë që
8 unë nuk e kam shtypur butonin "dërgo" këtë email pra.

9 PY. Ju përmendët që keni dërguar klientëve -- që i kanë
10 dërguar klientëve emaile, por unë përmenda që këtu kemi
11 adresën email haus.gov dhe senat.gov, zyrat. A ju kujtohet
12 kjo?

13 PË. Kjo ka qenë përgjigje për klientin, pra, i dërgohej
14 kongresit lidhur me klientët për t'u siguruar që ata, që
15 personi po i përfaqësonte ata. Ne përpigeshim që të informonim
16 qeverinë, që ne po kërkonim -- kjo ishte ajo që i kërkonim
17 qeverisë, Qeverisë në Shtetet e Bashkuara, keni të drejtën t'i
18 shkruani qeverisë personi. Në momentin që jeni regjistruar dhe
19 e bëni transparente që është dhe qëllimi i ligjit për
20 regjistrimin e agjentëve të huaj. Përpigemi që të jemi
21 transparent. Pra, nuk ka ndodhur asgjë prapa perdeve, prapa
22 skenave ku politikat apo pikëpamjet personale të njerëzve mund
23 të ndërhyjnë. Kjo është çështje për të qenë transparent.

24 Pra, jemi regjistruar si lobi dhe pastaj kemi patur
25 kërkesa ndaj qeverisë në pajtim, në përputhje me ligjin. Dhe i

1 kemi shkruar qeverisë duke i dërguar emaile dhe këto
2 anëtarëve. Pra, ju siguroj që nuk ka asgjë shumë interesante
3 lidhur me këtë.

4 PY. Dhe për t'u siguruar që ju kuptoj qartë mund të keni
5 shtypur kontaktin në këtë email, apo?

6 PË. Absolutisht që po. Dhe ju mendohet që e keni aprovuar
7 këtë gjë?

8 PË. Po. Kjo lloj dërgesa duhet të ketë qenë -- do ta kisha
9 ditur po të ishte bërë nga zyra ime.

10 PY. Dhe në qoftë se shkojmë pak më poshtë -- në fakt e kemi
11 në ekran. Mund të shohim materialin që është shpërndarë aty. A
12 ka qenë kjo gjuha standarde e përdorur për këto kontakte?

13 PË. Po, të gjithë e dinë që ishte kontratë e regjistruar me
14 një transparencë maksimale në pajtim me ligjin për
15 regjistrimin e agjentëve të huaj.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund të shkojmë pak më poshtë. Në
17 rregull.

18 PY. Këtu shohim që përmbajtja e këtyre dy faqeve mbulon
19 raportimin në mes gjërave të tjera mbi çështje politike,
20 ekonomike që janë relevante në Kosovë?

21 PË. Po.

22 Z. PACE: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen e parë,
23 kthehemi në faqen e parë. Pak më poshtë.

24 PY. Këtu shohim që raportin mbulonte deklarata apo veprime të
25 ndërmarra nga Presidenti Thaçi dhe Kryeministri në largim

1 Haradinaj, saktë?

2 PË. Saktë.

3 Z. PACE: [Përkthim] Z. Gjykatës, kërkoj pranimin e këtij
4 dokumenti.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Përpara se të bëjmë këtë besoj që
6 Prokuroria ka detyrimin që të shprehë qartësisht qëndrimin e
7 saj për këtë dëshmitar. Kam një listë të paktën 30 herë ku
8 Trupi Gjykses e ka udhëzuar Mbrojtjen që të paraqesë qëndrimin
9 e tyre atë që mendojnë ata. Dhe do të citoj transkriptin faqe
10 24418 lidhur me këtë pikë. Pra, cilado qoftë çështja që është
11 këtu duhej që dëshmitari të informohet në mënyrë të
12 drejtpërdrejtë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Ne kundërshtojmë këtë kërkesë. Ajo që
14 po bëj unë këtu është shumë e qartë. Po flas për këtë
15 organizatë lobimi, pra, që ishte në emër të Kosovës, për të
16 cilën ai dha dëshmi që kjo organizatë lobonte në emër dhe këtë
17 e përmendi gjatë marrjes në pyetje nga avokatët e Mbrojtjes.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që
19 është e qartë. Pyetjet janë me vend dhe nuk po krijojnë diçka
20 misterioze lidhur me qëndrimin dhe atë që mendon Prokuroria
21 lidhur me këtë dëshmitar. Ai e kupton arsyen pse po i bëhen
22 këto pyetje.

23 Kundërshtimi juaj pranohet.

24 Z. PACE: [Përkthim] Rrëzohet, uroj, z. Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 desha të them. Fola tepër gjatë ndoshta.

2 Z. PACE: [Përkthim] Edhe sa i takon pranimi, i nderuar
3 Gjykatës?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po
5 paraqisni për pranim këtë dokument?

6 Z. PACE: [Përkthim] Ishte 395242 deri në 395244, emaili
7 që po shohim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument merr numrin
10 e provës materiale P4489 dhe klasifikohet si konfidenciale.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë publik. Ta heqim
12 dokumentin.

13 PY. Dëshmitar, a keni punuar a diskutuar me z. Thaçi apo dikë
14 tjetër letrën e Sekretarit të Shtetit Mike Pompeo lidhur me
15 KSC dhe ZPS-në?

16 PË. Nuk më kujtohet të kem punuar me të. Për të qenë i saktë,
17 pjesa më e madhe e punës, puna që më kujtohet, puna që kam
18 kaluar kohë dhe kam bërë përpjekje ka qenë dialogu midis
19 Presidentit Vucic dhe Presidentit Thaçi me qëllim që të
20 arrihet një marrëveshje pageje mes këtyre të dyve. Emali i
21 mëparshëm që sapo patëm në ekran kishte referenca të dialogut
22 midis Serbisë dhe Kosovës që presidenti Thaçi dhe Presidenti
23 Vucic po ndërmerrenin. Unë kam kaluar kohë në këtë, nuk më
24 kujtohet të kem punuar për atë që ju sapo pyetët lidhur me
25 Tribunalin Special për Kosovën, nuk më kujtohet kjo. Në qoftë

1 se ka patur një letër të tillë, nuk është përgatitur nga unë,
2 menduar nga unë, rishikuar nga unë, me aq sa më kujtohet.

3 PY. Do të ndërroj temë tani.

4 Z. PACE: [Përkthim] Dhe do të kërkoj që të shfaqim në
5 ekran SPOE00398214 deri në 00398223. Dhe përkthimi në anglisht
6 që është SPOE00398214 deri në 00398215-ET. Po, në rregull. Në
7 qoftë se mund ta zmadhojmë pak më shumë faqen në të majtë të
8 ekranit. Në rregull, kështu.

9 PY. Dëshmitar, këtu shohim që është një postim në *Facebook*
10 nga një profil që i atribuohet një personi me emrin Artan
11 Behrami më 30 janar 2025.

12 Z. PACE: [Përkthim] Dhe në qoftë se kalojmë në dokument
13 në anën e majtë në faqen 216, që përfundon me 216. Dhe të
14 zmadhojmë fotografinë.

15 PY. Në anën e djathtë jeni ju në këtë fotografi, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. A është ky Artan Behrami, ky në anën e majtë tuajën?

18 PË. Mesa i takon z. Behrami, nuk më kujtohet. Dhe shqiptarët
19 e Kosovë më kërkojnë shpesh që të bëj fotografi me ta dhe unë
20 përpiqem të jem sa më miqësor që të jetë e mundur. Por i
21 kërkoj ndjesë atij, po nuk më kujtohet ai.

22 PY. Mesa dini ju, a keni patur ndonjë kontakt tjetër përveç
23 fotografisë që po shohim këtu me një person që quhet Artan
24 Behrami?

25 PË. Në qoftë se nuk është zyrtar i qeverisë së Kosovës, nuk

1 më kujtohet ta kem takuar atë. Thjesht nuk më kujtohet.

2 PY. Postimi mban datën 30 janar 2025. Ju kujtohet që keni
3 takuar që keni takuar ndonjë zyrtar të qeverisë së Kosovës në
4 këtë vit?

5 PË. Në këtë vit? Jo, nuk më kujtohet. Meqë ra fjala, postimi
6 më pëlqen. Ku falënderohet Rubin dhe Presidenti i Shtetet e
7 Bashkuara për lirinë e gjetur.

8 PY. Në rregull, faleminderit, nuk keni nevojë t'i përgjigjeni
9 pyetjes.

10 Z. PACE: [Përkthim] Mund të heqim dokumentin nga ekrani.

11 Dhe mendoj që ky është momenti i duhur që të bëjmë
12 pushimin përpara se të trajtoj temat e fundit që kam për të
13 trajtuar për të cilat më duhen 15 deri në 20 minuta.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Do t'ju japim një gjysmë ore pushim, z. Dëshmitar.

16 DËSHMITARI: Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
18 ndërpritet deri në 11.30.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
21 ndërpritet deri në 11.30.

22 --- Pauza fillon në orën 10.57

23 --- Seanca rifillon në orën 11.30

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 sillni dëshmitarin në sallë.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. Pace, mund të vijoni me pyetjet tuaja.

4 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Dëshmitar, sot në dëshminë tuaj folët lidhur me
6 pikëpamjet që keni për Prokurorinë në këtë çështje gjyqësore,
7 këto i keni ndarë dhe me televizionin dhe këto janë të
8 transmetuara, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Në korrik të këtij viti keni dalë në televizion dhe e
11 përshkruar Prokurorinë si turp, apo jo?

12 PË. Mund ta kem përdorur këtë fjalë. Mbase s'ka qenë e matur.
13 Por ndonjëherë kur je në televizion përdor ndonjëherë dhe
14 fjalë që mbase nuk duhen përdorur. Sidoqoftë unë dhe mund ta
15 tërheq këtë fjalë.

16 PY. Ju thatë që nuk e keni lexuar aktakuzën në këtë çështje
17 gjyqësore, as dosjen gjyqësore dhe as nuk keni ndjekur
18 dëshmitë e dëshmitarëve.

19 Por në korrik 2025 ju thatë në televizion se z. Thaçi po
20 ndiqet penalisht për arsye krejt absurde. A është kjo ajo që
21 keni thënë?

22 PË. Po. Besoj se këtë kam thënë.

23 PY. Në rregull atëherë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do të shfaqim në ekran një dokument i
25 cili do të na shërbejë me pyetjet vijuese dhe dokumenti ka

1 numrin 00395154. Dhe përbri dokumentit do të vendosim dhe
2 transkriptin që përfundon me 27 dhe kjo është një video.
3 Videoja mund të jetë publike dhe mund të transmetohet për
4 publikun.

5 PY. Ndërkohë që presim videon në ekran, Dëshmitar, në të
6 djathtë të ekranit shihni një pamje nga *YouTube* në *website* ose
7 faqja e *YouTube*.

8 Z. PACE: [Përkthim] E zmadhojmë pak diçiturën, ju lutem.
9 Po këtu dhe më poshtë.

10 PY. Është një pamje nga një video *YouTube* dhe këtu thuhet N1
11 BiH, është dhe data këtu, 13 korrik 2025. A ju kujtohet të
12 keni qenë në këtë shfaqen që shohim këtu në këtë ekran?

13 PË. Po, më kujtohet që kam dhënë një intervistë paradite, ka
14 qenë shumë herët në mëngjes.

15 PY. Po data është e saktë 13 korrik?

16 PË. Më duket se po.

17 Z. PACE: [Përkthim] Dokumentin në të djathtë mund ta
18 hiqni nga ekranit dhe vendosni transkriptin e videos që do të
19 shohim. Transkripti është 128836-27-TR-ET. Shkojmë në faqen 2
20 të transkriptit.

21 Ndërsa videon, do të doja ta shihnim nga minuta 07:36
22 deri në 09:36. Po është gati. Videoja është në anglisht. Ka
23 titra që nuk janë anglisht. Përkthyesit mund të ndjekin ose
24 audion ose transkriptin.

25 Sikurse ju thashë, do shikojmë nga minuta 07:36 deri në

1 09:36.

2 [Luhet videoincizimi]

3 "... ligji është shumë kompleks. Fatkeqësisht, mund të
4 shpërdoret nga anët politike, nga grupet e të drejtave të
5 njeriut në vetvete, nga gazetarët. Është një temë që mund të
6 interpretohet gjerazi dhe a janë përpjekur qeveritë të
7 shmangin numrin e viktimave apo si ka funksionuar hierarkia e
8 komandë dhe kontrollit. Këto janë pyetje shumë të vështira.
9 Dhe, sinqerisht, besoj se në Ballkan i gjithë sistemi i
10 drejtësisë ka dalë jashtë kontrollit. Dhe këtë e përdor si
11 shembull të Prokurorisë konkretisht kundër ish-Presidentit të
12 Kosovës, Hashim Thaçi, që është një turp. Qeveria e Kosovës e
13 krijoi tribunalin vetë, bëri të pamundurën dhe më pas ai
14 ndiqet penalisht mbi baza krejt absurde se ai paskërka
15 kontrolluar gjithçka, që nuk është fare e vërtetë. Dhe,
16 sinqerisht, e kanë mbajtur në burg për shumë vite sepse nuk
17 dinë se si të vazhdojmë me këtë gjykim. Unë uroj të jap dëshmi
18 në emër të Hashim Thaçit, që besoj se do ndodhë sidoqoftë, dhe
19 të jap provat e mia për këtë sistem të drejtësisë. Qoftë është
20 kjo një përpjekje nga drejtuesit politikë përcaktuar që dhe
21 serbët dhe kosovarët kanë kryer krime lufte, jo. Ushtria serbe
22 ka kryer 95 për qind të vrasjeve masive, pra, ka kryer vrasje
23 masive dhe është 95 për qind e problemit të Kosovës dhe të
24 përpiqesh tani të barazosh atë që bënë shqiptarët e Kosovës me
25 atë që ka bërë Milosevic dhe ushtria serbe është krejt

1 absurde, është për të ardhur keq. Dhe fakti se nuk e lirojnë
2 as me kusht ish-Presidentin dhe presin të gjejnë prova dhe të
3 gjejnë një zgjidhje sesi të vijojnë me këtë gjykim. Mendoj që
4 ky është një problem.”

5 Z. PACE: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, pra, janë fjalët tuaj këto?

7 PË. Ka qenë shumë herët në mëngjes, po, po fjalët e mia.

8 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund ta heqim dokumentin nga
9 ekrani.

10 PY. Në një *podcast* të 17 korrikut ku keni qenë një nga
11 bashkautorët thatë se do të jepni dëshmi në gjykimin e Hashim
12 Thaçi dhe “do të keni qenë një nga dëshmitarët kryesor të
13 Mbrojtjes”. Pra, ju e konsideroni vërtetë veten si dëshmitar
14 kryesor apo dikush tjetër e ka thënë këtë për ju?

15 PË. Ky është përshkrimi im për veten.

16 PY. Po më 17 korrik në këtë *podcast* ju thatë se:

17 “Sistemi po fajëson persona që nuk kanë pse të jenë në
18 burg dhe këtë po e bën për arsye politike.”

19 Dhe këtë e keni thënë lidhur me gjykimin ndaj z. Thaçi,
20 apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Në një *podcast* të 30 korrikut ju keni thënë se:

23 “Kjo Gjykatë është një shembull i një institucioni
24 ndërkombëtar që është për të ardhur turp.”

25 PË. Po.

1 PY. Ju thatë s'e keni lexuar as dosjen gjyqësore, as dëshmitë
2 e dëshmitarëve s'i keni ndjekur dhe as aktakuzën. Po në 30
3 korrik ju thoni se:

4 "Krijuan një çështje nga hiçi për drejtuesit shqiptarë të
5 Kosovës."

6 PË. Nuk më kujtohen fjalë për fjalë këto, por ky është
7 mendimi im si vëzhgues jo jurist.

8 PY. Në rregull.

9 Z. PACE: [Përkthim] Shohim në ekran materialin 128871-04,
10 ju lutem, dhe përbri këtij materiali të vendoset materiali
11 128871-04-TR-ET. Nuk është video. Në fakt është *podcast*, është
12 audio. Është një *podcast* i 30 korrikut 2025.

13 Audion do të doja ta dëgjonim nga minuta 13:47 deri në
14 14:40.

15 [Luhet audioincizimi]

16 Z. PACE: [Përkthim] Në transkript duhet të shohim faqet 1
17 dhe 2, pra, fillojmë nga fundi i faqes 1 dhe më pas kalojmë
18 tek faqja tjetër. Dhe zmadhojmë tre rreshtat e fundit. Në fakt
19 edhe kështu është në rregull.

20 DËSHMITARI: Po të doni unë e pranoj që e kam thënë.

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk e kam bërë pyetjen, ju lutem,
22 dëgjojeni fillimisht.

23 PY. Do dëgjojmë ku thuhet "Por tani Kosova". Gati ju lutem të
24 dëgjojmë nga minuta e 13:47.

25 [Luhet audioincizimi]

1 "... po tani tribunali i Kosovës është shembulli i
2 institucionit i drejtësisë ndërkombëtare që ka dalë jashtë
3 kontrolli. Krijuan një çështje të pabazë për drejtuesin e
4 shqiptarëve të Kosovës e kanë akuzuar në momentin që po
5 krijonte marrëveshje pageje me Serbinë, e futën në burg. Ka
6 qenë në burg për katër vjet e kusur dhe nuk janë në gjendje as
7 t'i mbledhin të gjitha provat bashkë kanë tre vjet e gjysëm
8 sepse po e shpikin ligjin sipas zhvillimeve, siç t'ju volis.
9 Kështu ligji, e drejta ndërkombëtare dëmton instrumentet
10 juridike ndërkombëtare reale që janë legjitime, nga grupe
11 legjitime, politikanë dhe juristë që përpiqen të bëhen të
12 famshëm apo të krijojnë një reputacion të mirë për veten duke
13 krijuar argumente të reja që nuk janë domosdoshmërisht
14 legjitime. Pra, është problem real. Nuk kemi një qeveri" --

15 Z. PACE: [Përkthim]

16 PY. Atëherë ju kujtohet ta keni thënë këtë në korrik të këtij
17 viti?

18 PË. Po.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
20 pranimin e videos dhe të transkriptit përkatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Dokumenti me numër 128871-04 dhe transkripti i 128871-04-
25 TR-ET nga minuta 13:47 deri në minutën 14:40 pranohet.

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 66

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Çfarë klasifikimi duhet
2 të ketë dokumenti?

3 Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

5 Riklasifikoheni dokumentin si publik.

6 Z. PACE: [Përkthim] Gjykatësi tha 14:14 është gabim.

7 14:40 duhet të thoshit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,

9 faji im. S'e dëgjova. Atëherë dhe një herë do pranohet
10 segmenti kohor nga minuta 13.47 deri në minutën 14:40.

11 Z. PACE: [Përkthim] Me kaq përfundojnë pyetjet për
12 momentin për këtë dëshmitar. Sidoqoftë, ZPS-ja mund të ketë
13 pyetje të mëtutjeshme për këtë dëshmitar pasi të marrim
14 deklaratat apo përmbledhjet e dëshmitarëve të Mbrojtjes që nuk
15 kemi marrë ende edhe do të donim t'i bënim më tej pyetje këtij
16 dëshmitar po kjo është në varësi të deklaratave dhe
17 përmbledhjeve të tjera të dëshmitarëve, sepse duam të shohim
18 sesi përputhen këto me njëra-tjetrën apo mbivendosen me njëra-
19 tjetrën.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim
21 vendim më pas lidhur me këtë. Në rregull, Prokuroria
22 përfundoi.

23 Z. Misetic, mund t'i bëni pyetje të tjera nëse keni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

25 Pyetje vijuese nga z. Misetic:

1 Z. MİSETIC: [Përkthim]

2 PY. Mirëmëngjes, z. Rubin.

3 PË. Mirëdita.

4 PY. Kam disa pyetje shitesë për ju që burojnë nga pyetjet e
5 Prokurorisë, pra, të gjitha pyetjet e mia lidhen me pyetjet që
6 ju ka bërë Prokuroria.

7 Në transkriptin e djeshëm në faqen 26596, ju bënë disa
8 pyetje nga Prokuroria lidhur me konstatimet e z. Shaun Byrnes,
9 ju bënë edhe sot paradite pyetje lidhur me konstatimet apo
10 komentet e z. Shaun Byrnes.

11 Nuk është nevoja të nxjerr transkriptin, por do ju bëj
12 pyetje për diçka tjetër që ka thënë z. Byrnes. Kjo është në
13 transkriptin e këtij gjykimi në fakt, për procesverbal, sipas
14 tij, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka qenë si një ministri e
15 punëve të jashtme të UÇK-së. Dhe pyetja ime është kjo: A
16 përputhet kjo dhe me mënyrën si e keni kuptuar ju rolin e z.
17 Thaçi në UÇK?

18 PË. Po. Unë e kam parë punën e tyre dhe jam përpjekur të
19 krijoja një ide për organizatën e tyre që përputhet me mënyrën
20 sesi duhet të jetë një qeveri, ndonëse ata s'kishin një
21 qeveri. Pra, unë atë e kam parë si një ekuivalent të një
22 ministri të punëve të jashtme që pasqyronte pikëpamjet e
23 qeverisë së vet, ushtrisë së vet, e përfaqësonte këtë të
24 ashtuquajtur qeveri por nuk kishte udhëheqës, pra, ishte një
25 ministër, një përfaqësues politik, një person që nënshkruante,

1 po, pra, e thënë ndryshe si një ministër i punëve të jashtme,
2 pajtohem me Shaun Byrnes.

3 PY. Në rregull.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të shohim provën materiale 1D80
5 sepse dje ju desh që të thonit diçka por Prokurori nuk ju
6 lejoi ta shtjellonit më tej përgjigjen tuaj. Kështu që unë dua
7 t'jua jap këtë mundësi të na thonit përgjigjen që deshët të
8 jepnit dje.

9 Edhe një herë materiali është me numër 1D280. Është
10 artikulli i *Financial Times* sërish. Shkojmë në faqen tjetër,
11 ju lutem. Zmadhojmë kolonën e pestë në mes tek pjesa ku
12 thuhet: "Albright më tha të punoja me Thaçin".

13 Mbase është më poshtë në tekst. Ndalojmë këtu një herë.
14 PY. "Albright më tha të punoja me Thaçin".

15 Dhe kjo është pyetja që ju bëri Prokurori, unë po citoj:

16 "Në atë paragraf që po ju lexoj filloi 'Albright më tha
17 ...' dhe unë po ju lexoj fundin e këtij paragrafi. Ku thuhet:

18 "Albright më tha të punoja me Thaçin. Pjesa tjetër e
19 delegacionit shqiptar kishte sinjalizuar se kishte shumë të
20 ngjarë që do të pranonin. Nëse pajtohej dhe ai mund të vijonim
21 më tej. Nëse jo, atëherë po ktheheshim dhe një herë në zero,
22 në hapin zero."

23 A e keni shkruar ju këtë në vitin 2000?"

24 Dhe ju i përgjigjët:

25 "Po, po e kam shkruar -"

1 Dhe në këtë moment Prokurori s'ju lejoi ta shtjellonit më
2 tej. Çfarë deshët të thonit ju?

3 PË. Po përpigësja të thoja që këto janë përshtypje personale
4 për një grup personash. Ne mendonim që kishte të ngjarë që
5 LDK-ja, Veton Surroi, ishin dakord me këtë gjë, po ne nuk e
6 dinim, kjo ishte një risi për ne. Dhe ajo më thotë mua që
7 Thaçi është personi me të cilin duhet të punoja, nuk do të
8 thotë që ishte i vetmi person i rëndësishëm, por ishte personi
9 kryesor me të cilin duhet të punoja se mendonim që të tjerët
10 nuk ishin kundër. Por këto s'mund t'i parashikosh asnjëherë.
11 Kështu që këto ishin thjesht përshtypje. Procesi nuk ishte
12 shumë zyrtar, formal në vetvete. Unë po përpigësja të thoja që
13 ishte person i rëndësishëm, ishte personi i domosdoshëm po
14 s'ishte i vetmi. Na duheshin të gjithë. Dhe ata e kishin
15 zgjedhur atë si personin e caktuar, pra, shqiptarët e Kosovës
16 e kishin zgjedhur atë. Personat duhet ta kuptojnë këtë.
17 Prandaj ne punonim me a është e saktë, prandaj e konsideronim
18 udhëheqësin atje sepse ata e kishin zgjedhur atë, në daç e
19 quajmë udhëheqës, në daç pikën kryesore të kontaktit.

20 Po them, ishte person i rëndësishëm, ishte person i
21 domosdoshëm, por ama njëkohësisht kishte shumë zhvillime. Dhe
22 ishte një situatë shumë e paqartë, kështu që unë isha fokusuar
23 në punën që mund të kryeja unë. Doja ta bëja të qartë që nuk
24 ishte aq e thjeshtë situata atje ishte shumë herë më e
25 koklavitur.

1 PY. Në rregull. Në faqen 26619-26622 të transkriptit dje, iu
2 bëri disa pyetje Prokurori lidhur me z. Hashim Thaçi, a ishte
3 Hashim Thaçi në hierarki mbi Adem Demaçin në UÇK. Dhe sot
4 paradite ju treguan një dokument ku thuhej se z. Thaçi
5 "përpiqej të mos i atribuojë asnjë lloj autoriteti politik z.
6 Demaçi". Ju kujtohet kjo?

7 PË. Po.

8 PY. Në një moment ju sot thatë në faqen 26621, rreshtat 8
9 deri në 11, ju thatë. Do ta lexoj, ju thatë:

10 "Prandaj Madeleine Albright e thirri Adem Demaçin pas
11 Rambujesë sepse ne mendonim se Adem Demaçi kishte influencë
12 ndaj Hashim Thaçit, jo anasjelltas."

13 Ju kujtohet kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Në rregull.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të shohim një dokument
17 tjetër në ekran dhe dokumenti ka lidhje me thirrjen telefonike
18 mes Madeleine Albright dhe z. Thaçi.

19 PY. Z. Rubin, kjo është një intervistë që ka dhënë Sekretarja
20 Albright në 2006 në kuadër të përpjekjeve për të mbledhur
21 historitë me gojë të personave që kanë marrë pjesë në
22 presidencën e Bill Clinton. E shihni këtë?

23 PË. Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

25 PY. Ajo ka treguar diçka këtu lidhur me Rambujenë dhe

1 diskutimet e saj me Adem Demaçin, bisedat e saj me Adem
2 Demaçin.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në paragrafin në fund të
4 faqes ku thuhet "Ka qenë një djalë i ri nga Kosova ... ". Po
5 ua lexoj. Në 2006 kjo është ajo që ka thënë Sekretarja
6 Albright:

7 "Ishte një djalë i ri kosovar, Hashim Thaçi, që ishte
8 luftëtar i UÇK-së. Ne i thamë 'Ti do të jesh Gerry Adams i
9 këtij operacioni. Ti do tregosh që ka dhe një pjesë që kërkon
10 paqe në UÇK-në dhe ju do të jeni heroi'. Ai tha 'Do të bëj
11 çfarë të dëshironi. E kuptoj këtë. Kur të takohem me anëtarë
12 të tjerë të grupit të kontaktit unë do t'ju them që ne duam që
13 vrasjet të marrin fund dhe se ne duam autonomi por nuk duam
14 pavarësi'.

15 "E diskutuam të gjithë këtë. Po njëkohësisht se një
16 person që quhej Demaçi, i cili vërtetë kontrollonte gjërat në
17 Kosovë. Kur bisedova me të në telefon dhe i thashë të
18 mbështeste Thaçin, ai tha, 'nuk më intereson sa njerëz
19 vdesin'. Ka qenë biseda më e egër që kam dëgjuar ndonjëherë."

20 Z. Rubin, Sekretarja Albright në bisedën e saj me Adem
21 Demaçin, pra, kjo që tregon Sekretarja Albright a përputhet me
22 këtë çka na thatë dhe ju lidhur me këtë thirrje telefonike?
23 PË. Kam qenë i pranishëm kur Sekretarja Albright thirri në
24 telefon z. Demaçi. Kam qenë aty. Më kujtohet shumë mirë që na
25 u duk sikur kishte një person që kishte autoritet. Jo

1 autoritet fizik apo vertikal po ideologjik. Dhe se Hashim
2 Thaçi mendonte se kishte nevojë për një person si Adem Demaçi
3 që ta ndihmonte që ta shtynim pak çështjen e pavarësisë.
4 Prandaj ka thënë autonomi jo pavarësi. Ai nuk ka thënë ne
5 s'duam pavarësi, por jo tani, jo në këto momente. Dhe ai donte
6 të tregonte që çështjen e pavarësisë mund ta diskutojmë pak më
7 vonë. Demaçi thoshte o pavarësi o le të vdesim. Dhe sipas meje
8 ky ishte një shenjë që z. Thaçi kishte nevojë që z. Demaçi të
9 thoshte që mund ta shtyjme pak më vonë ta diskutojmë çështjes
10 e pavarësisë, prandaj Thaçi -- më falni, Demaçi ishte eprori i
11 tij nga pikëpamja e vendimmarrjes në këtë grup, jo se ishte
12 përgjegjës. Ai kishte nevojë për mbështetje ideologjike nga
13 themeluesi apo personi kryesor ideologjik në vend që të
14 thoshte le të punojmë me NATO-n të kemi një marrëveshjen për
15 paqen, Demaçi i tha znj. Albright: O pavarësi ose le të vdesin
16 të gjithë. Kjo na u duk e egër, prandaj ka përdorur dhe fjalët
17 i etur për gjak.

18 PY. A e dini ju asokohe keni pasur dijeni lidhur me ndonjë
19 informacion nëse z. Demaçi gjatë asaj thirrjeje telefonike,
20 Demaçi a ka qenë pjesëmarrës nga persona që kërkonte të
21 ndryshonte udhëheqjen e UÇK-së në terren?

22 PË. Po. Mesa kemi ne dijeni, kjo ishte një organizatë e re,
23 një subjekt i ri në arenë, e kuptonim që kishte mosmarrëveshje
24 për pushtetin njëkohësisht dhe ndonëse z. Thaçi ishte
25 përfaqësuesi, ai thjesht pasqyronte realitetin në terren dhe

1 këtua reflekton dhe pikëpamjet e z. Demaçi dhe për të
2 nënshkruar marrëveshjen më pas në Paris, ai më tha se duhej që
3 të merrte miratim. Nuk ma tha asnjëherë konkretisht prej kujt
4 e mori këtë miratim, po ishte absolutisht e qartë që ai nuk
5 mund të merrte vendime në emër të UÇK-së, por ai thjesht mund
6 të kontaktonte me udhëheqësit. Dhe besoj që një prej këtyre
7 udhëheqësve ishte Demaçi, i cili po përpiqej të ndryshonte
8 kushtet e Rambujesë dhe të mos na lejonte ne të kishim një
9 marrëveshje të paqes ose të paktën nuk donte që shqiptarët e
10 Kosovës ta nënshkruanin këtë marrëveshje.

11 Më falni që po e zgjas kaq shumë dhe është e ndërlikuar -
12 ne e kuptonim që kishte një luftë pushtetesh dhe ne po
13 përpiqeshim që të merrnim një po ndaj kësaj marrëveshjeje, për
14 këtë marrëveshje.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj pranimin e dokumentin
17 DHT12047-DHT12049.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
19 kundërshtime?

20 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
22 DHT12477-DHT12049 pranohet. Ju lutem, jepini numrin përkatës.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
24 numrin 1D369.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të vazhdoj? Mund të
2 vazhdoj?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

4 Z. MISETIC: [Përkthim]

5 PY. Z. Rubin, dje në fund të dëshmisë suaj ju bënë disa
6 pyetje nga Prokurori nëse pajisja e UÇK-së, furnizimi i UÇK-së
7 me armë do të minonte mbështetjen nga vende të tjera të NATO-s
8 nëse do të vendosnin të çonin forca në terren. A ju kujtohet
9 kjo linjë pyetjesh?

10 PË. Po.

11 PY. Në rregull.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës të
13 nxjerrë në ekran materialin 1D102.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk e gjej dot këtë
15 dokument në asnjë prej dokumenteve të paraqitura.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se është në listën tonë të
17 materialeve. Ju kujtohet ndjesë. Jua dhashë gabim unë
18 referencën. Dhe një herë dokumenti është 1D102, nuk e di se
19 cilin dokument nxorët në fakt sepse në transkript thuhet
20 1D102.

21 Znj. Sekretare, e shikojmë tek lista e dokumenteve tona,
22 por megjithatë në qoftë se mund t'ju ndihmojmë me numër ERN
23 dokumenti është i identifikuar si DHT01465 deri në DHT01467.
24 Ky është dokumenti.

25 PY. Z. Rubin, këtë dokument e keni diskutuar dhe në

1 deklaratën e dëshmitarit në paragrafin 65 dhe 66. Pyetja që
2 kam për ju është kjo: Në këtë dokument thuhet --

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për këtë arsye do i kërkoja
4 Sekretares të kalojë tek paragrafi i tretë i dokumentit.

5 PY. Pra, thuhet që:

6 "Për më tepër përderisa nuk ekziston një strukturë
7 politike në Kosovë ose një kontroll efektiv komande dhe
8 kontrolli në UÇK, do të duhen muaj, nëse jo vite, që të
9 organizohet përdorimi ose dhe të mirëmbahet ndihma ushtarake
10 që do të ofrojnë Shtetet e Bashkuara nëse ofrohet kjo ndihmë."

11 A ishte kjo një përpjekje për ta çorientuar Senatorin
12 McConnell me arsyen për mosarmatimin e UÇK-së në mënyrë të
13 tillë që të mund të shpërbehej uniteti i NATO-s?

14 Z. PACE: [Përkthim] Është orientuese si pyetje. Duhet të
15 kundërshtohet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni.

17 DËSHMITARI: Absolutisht jo. Nuk mund ta çorientonim, nuk
18 ishte qëllimi ynë që të mos jepnin situatën siç ishte në
19 terren për Kongresin.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Por si t'i japim kuptim faktit që Sekretarja Albright ka
22 përmendur që një ndër arsyet për mos armatosjen e UÇK-së ishte
23 që të mbahet uniteti i NATO-s dhe pozicioni zyrtar i
24 administratës së Clinton ishte që kjo ishte një nga arsyet
25 shtesë që nuk kishte kontroll dhe komandë efektive të UÇK-së?

1 PË. Përgjigja është konteksti. Ne nuk donim që t'ju tregonim
2 atyre që nuk ekzistonte një organizim i mirë dhe nuk donim që
3 t'ju thonim që "arsyeja që pse nuk duam që t'ju armatosur
4 është që duhen vite të tëra që ju të merrnin trajtën e duhur
5 të një strukture ushtarake dhe që të merrni armë efektive",
6 sepse një qasje e tillë dhe po t'jua thoja një gjë të tillë
7 personave të cilët po luftonin me jetën e tyre në fushat e
8 betejës përditë, ishte ofensive, ishte përulëse.

9 Dhe ndonjëherë ti për zgjedh një arsye që është më e
10 thjeshtë që të përçohet dhe është më e lehtë për t'u kapërdirë
11 apo për t'u pranuar nga bashkëbiseduesi sesa ti thonim troç e
12 shkoqur që "ne nuk ju japim dot armë ju ndërkohë që njerëzit
13 po theren dhe po vdesin sepse ju jeni të paorganizuar", nuk ua
14 thonim dot një gjë të tillë. Por në qoftë se do ju thonim që
15 "ne nuk ua japim dot armët juve tani për shkak të unitetit të
16 NATO-s dhe kjo mund të kishte ndikim mbi unitetin e NATO-s",
17 kjo është në mënyrë diplomate, diplomatike e të thënit e të
18 dhënit të përgjigjes.

19 PY. Tani, duke e marrë përgjigjen që ju dhatë në lidhje me
20 letrën, a mendonte që kjo do të shtrembëronte pak të vërtetën
21 për Departamentin e Shtetit?

22 PË. Jo, jo. Sepse sipas përvojës time, ne jemi përpjekur me
23 gjithçka që mundeshim që të ishim sa më preciz, sa më të saktë
24 të ishte e mundur. Ndërkohë që një rastin në fjalë ne thjesht
25 po bënim një gjykim sa i takon argumentit për armatosjen apo

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 77

1 jo të UÇK-së dhe ne ju kemi thënë që kjo nuk është ide e mirë
2 sipas nesh sepse nuk ekziston një strukturë e mirëfilltë
3 politike ose nuk ka kontroll efektiv, kështu që do duhej shumë
4 kohë që të strukturohej kjo si organizatë ndërkohë që betejat
5 vazhdonin në terren.

6 Domethënë, ne bëmë gjykimin tonë më të mirë, kemi bërë
7 një vlerësim sipas asaj që dinim ne në më të mirën e mundshme,
8 duke marrë parasysh strukturën organizative të UÇK-së dhe duke
9 marrë parasysh aspektin e kontrollit dhe të komandës, që ne
10 besonim që UÇK-ja nuk e kishte. Dhe një prej arsyeve kryesore
11 të kësaj gjëje ishte që nuk kishte një kontroll dhe komandë
12 efektive të UÇK-së.

13 PY. Faleminderit. Tani do t'ju tërheq vëmendjen lidhur me
14 disa pyetje që ju janë bërë sot paradite dhe që kanë të bëjnë
15 me disa artikuj të botuara në *The New York Times* dhe *cnn.com*
16 më datë 19 qershor 1999. A i mbani mend këto pyetje,
17 Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Njëri prej grupeve të pyetjeve të bëra kanë të bëjnë me
20 një incident kur trupat e KFOR-it gjerman kanë gjetur një grup
21 personash të ndaluar dhe të keqtrajtuar. A ju kujtohet kjo
22 pyetje?

23 PË. Po.

24 PY. A ju kujtohet data kur është kthyer z. Thaçi në Kosovë,
25 Dëshmitar?

1 PË. Më kujtohet nënshkrimi i marrëveshjes, e kam fjalën për
2 marrëveshjen e demilitarizimit dhe më kujtohet që ai fluturoi
3 drejt Prishtinës me mua atë ditë. Megjithatë, se ku ka qenë ai
4 gjatë negociatave, në qoftë se ka qenë në bjeshkë apo në qoftë
5 se ka qenë në lëvizje, këtë gjë unë nuk e di. Ajo çfarë di unë
6 është që ai mu bashkua mua ka qenë bashkë me mua në Prishtinë
7 në shtabin e KFOR-it në Prishtinë dhe në konferencën për
8 shtyp, mua mu krijua përshtypja që ai ishte kthyer në
9 Prishtinë. Por ndërkohë se cila ka qenë dita ose data kur
10 është kthyer ai në Prishtinë këtë nuk ua them dot.

11 PY. Por dita kur jeni kthyer ju ka qenë 19 qershor, apo jo?

12 PË. Ka qenë e nënshkrimit.

13 PY. Jo, dita e nënshkrimit ka qenë më datë 21.

14 PË. Atëherë kjo ka qenë dita kur unë jam kthyer në Prishtinë.

15 PY. Si janë raportuar incidentet në *The New York Times* dhe
16 cnn.com në raport me atë çfarë keni vëzhguar juve, pra,
17 sjelljen e z. Thaçi në raport me komandantët ushtarakë të UÇK-
18 së?

19 PË. Unë vërejta diçka unike që unë besoj që asnjë person i
20 jashtëm nuk e ka vënë re përveç meje dhe ajo çfarë kam
21 vërejtur unë është ndërveprimi i z. Thaçi me komandantët e
22 sektorëve në bjeshkë në ato tre ditë. Unë nuk besoj se askush
23 tjetër i jashtëm përveç meje dhe njerëzve që kanë qenë pjesë e
24 grupit tim nuk kanë vërë, nuk e kanë parë, nuk e kanë shquar
25 atë lloj ndërveprimi të z. Thaçi me komandantët e sektorëve

1 dhe me udhëheqësit e vërtetë ushtarakë. Sepse nëse dikush
2 tjetër do të kishte vërejtur të njëjtën gjë dhe do kishte
3 raportuar këtë lloj shkëmbimi, marrëdhënie besoj që unë do e
4 kisha kuptuar më mirë strukturën e UÇK-së.

5 Arsyeja që pse jam kaq i bindur unë që ai nuk ishte
6 drejtuesi ushtarak i UÇK-së është që unë vetë e kam vënë re
7 këtë gjë për tre ditë të plota. Nuk është se më është krijuar
8 përshtypja për një çast, nuk është se më është krijuar
9 përshtypja nga leximi i një artikulli ose nga një kabllogramë
10 por e kam parë në mënyrë të vazhdueshme gjatë tre ditëve të
11 plota. E kam parë, kam qenë dëshmitar i dinamikës së pushtetit
12 ndërmjet tij dhe komandantëve të tjerë. E kam fjalën këtu për
13 raportin e tij ndërmjet komandantëve të sektorëve.

14 Dhe duke qenë që e kam parë me sytë e mia, kjo më tregoi
15 mua se çfarë pozicioni ose çfarë hierarkie kishte në sistem,
16 domethënë, këto i kam konstatime nga vetja ime, i kam parë me
17 sytë e mi, i kam dëgjuar me veshët e mia. Kështu që çdo gjë
18 tjetër që unë kam lexuar, çdo lloj inteligjence ose fjalë,
19 marrje, dhënie, më the të thash, këto i vendosa të gjitha në
20 perspektivë. Unë i kam parë këto që po ju them e kam parë vetë
21 e kam parë si ka funksionuar kjo strukturë, e kam parë vetë
22 raportin e tij me komandantët e sektorëve.

23 Për këtë arsye jam shumë i bindur se akuzat e ngritura
24 ose pretendimet e ngritura në këta artikuj që ju përmendët
25 janë tërësisht të rreme.

1 PY. Përveç pyetjeve që t'u bënë lidhur me incidentet të
2 raportuara më 19 qershor, Prokurori sot ju bëri pyetje
3 gjithashtu lidhur me komentet që keni dhënë më datë 25 qershor
4 1999 në konferencën për shtyp që ju nuk kishit informacion për
5 të sugjeruar që udhëheqësia e UÇK-së ishte përgjegjëse për
6 ekzekutimet. Ju kujtohen këto pyetje, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua që të paraqitet në ekran
9 dokumenti 1D175.

10 PY. Z. Rubin, është një raport i Departamentit të Shtetit i
11 botuar në dhjetor të vitit 1999. Atëherë titulli i raportit
12 është "Spastrimi etnik në Kosovë: Një rrëfim."

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e dytë të
14 këtij dokumenti në të majtë në kolonën e dytë.

15 PY. Do t'ju lexoj paragrafin përkatës të shkruar nga
16 Departamenti i Shtetit.

17 Pra, këtu nuk flitet për verën e 1999:

18 "Popullata rome ka qenë gjithashtu vëmendja e shpagimeve
19 dhe hakmarrjeve duke u akuzuar si bashkëpunëtorë të
20 shpërnguljes së shqiptarëve të Kosovë. Armiqësia historike
21 kundër komunitetit romë ka luajtur gjithashtu rol. Në një
22 deklaratë të 20 korrikut ku dënohen sulmet mbi serbët dhe
23 romët është lëshuar prej një ish-udhëheqësi të UÇK-së dhe ish-
24 udhëheqësi i UÇK-së, Hashim Thaçi, ka denoncuar publikisht
25 sulmin e 23 korrikut në Gradsko.

1 "Nuk ka asnjë dëshmi që ish-udhëheqja i UÇK-së po
2 orkestron dhunën. Nga ana tjetër shqiptarët e Kosovës as nuk
3 kanë identifikuar autorët apo kryesit e këtyre krimeve dhe as
4 nuk kanë dënuar këto abuzime të udhëheqësve të popullsisë
5 shqiptare të Kosovës."

6 Atëherë këtu kemi një fjali, thuhet që "nuk ka të dhëna
7 ose nuk ka prova që lidërshipi i UÇK-së po orkestron dhunën",
8 ky është opinionimi juaj personal apo opinionimi i Departamentit
9 të Shtetit?

10 PË. Ky është një dokument shumë zyrtar, është i përgatitur, i
11 hartuar nga Departamenti i Shtetit. Unë personalisht mund të
12 jemi i përfshirë vetëm sa i takon leximit mbase dhe kam
13 redaktuar, megjithëse dyshoj fort. Por ky përfaqëson
14 pikëpamjen zyrtare të Departamentit të Shtetit dhe është një
15 raport që do jetë shkruar nga byroja e të drejtave të njeriut
16 të krimeve të luftës, byroja rajonale, byroja e popullatës.
17 Domethënë, është një produkt i përbashkët i ekspertëve të
18 Departamentit të Shtetit sektorëve të ndryshëm dhe përbën një
19 vlerësim të tyre për situatën në Kosovë. Pra, për sa i takon
20 titullit, titulli është "Spastrimi etnik në Kosovë" dhe këtu
21 flitet për spastrimin serb të Kosovës të kosovarëve në Kosovë.

22 Dhe ky është një deklaratë e Departamentit të Shtetit dhe
23 është një qëndrim fundor i Departamentit të Shtetit.

24 PY. Ky vlerësim i Departamentit të Shtetit a është në
25 përputhje me atë çka keni konstatuar ju vetë gjatë periudhës

1 së qershorit 1999?

2 PË. Po, pa diskutim. Unë jam përpjekur që të shikojë të
3 hetojë, të gjej informacione lidhur me këto pretendime, me
4 këto akuza dhe nuk kam identifikuar asnjë që të më japë qoftë
5 edhe një provë të vetme lidhur me të dhe prandaj dhe kam thënë
6 dhe them dhe sot që nuk ka pasur prova për këtë.

7 PY. Z. Rubin, ju bënë shumë pyetje sa i takon punës tuaj me
8 Ballard si dhe kritikave që keni krijuar për Prokurorinë sot.
9 Jam i sigurtë që ju kujtohen këto pyetje z. Rubin, apo jo?

10 PË. Po, po. Shumë mirë më kujtohen.

11 PY. A më thoni dot, ju lutem, se si deklaratat e punës që
12 keni bërë ju në 2019, 2020 kanë pasur ndikim mbi atë çfarë
13 keni shkruar ju në artikullin në *Financial Times* në 2000?

14 PË. Sigurisht që nuk kanë asnjë ndikim ajo çka kam thënë unë
15 më pas, sigurisht unë artikullin e kam shkruar në 2000,
16 ndërkohë që komentet i kam bërë shumë më pas.

17 Pra, unë kam pasur njohuri lidhur me zhvillimet në Kosovë
18 në atëkohë. Kam shkruar në atë kohë përshtypjet, opinionet e
19 mia dhe kam dhënë opinionin tim, kam dhënë thjesht vlerësimin
20 për situatën.

21 PY. Puna juaj për Ballard apo komentet që keni dhënë lidhur
22 me këtë çështje gjyqësore si kanë pasur ndikim këta mbi
23 vlerësimin tuaj lidhur me autoritetin e z. Thaçi në Rambuje?

24 PË. Asnjë lidhje nuk kanë.

25 PY. Si keni punuar ju Ballard edhe si komentet që ju keni

1 bërë pas vitit 2020 kanë lidhje me komentet që ju keni bërë me
2 vlerësimin që keni bërë për autoritetin e z. Thaçi kur keni
3 qenë në Kosovë në qershor të 1999?

4 PË. Nuk kanë pikë lidhjeje njëra me tjetrën.

5 PY. Do të kërkoj që të paraqitet në ekran një tjetër
6 dokument.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti mban numrin e
8 identifikimit DHT12046 deri në DHT12046, plus transkriptin
9 përkatës. Transkripti ka numrin DHT12046-TR.

10 PY. Z. Rubin, a ku kujtohet të keni qenë moderatori ose
11 lehtësuesi i një debati në një tryezë të rrumbullakët në një
12 shkollë juridike në fillim të kësaj dekade, ju kujtohet një
13 gjë e tillë?

14 PË. Po. Më kujtohet pak a shumë sigurisht që jo fjalë për
15 fjalë.

16 PY. Ndërkohë a ju kujtohet që titulli, për shembull, i
17 transkriptit është "Rreziqet e ndërhyrjes dhe ndërtimi i
18 shtetit në Kosovë". Ju kujtohet kjo?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk do ta shfaqim të plotë për të
21 kursyer ca kohë sepse ka dhe komente që nuk lidhen me pyetjet
22 e mia ndërmjet dy klipeve që dëshiroj që të paraqiten por si
23 fillim dua t'i kërkoj Sekretares që të japë, të transmetojë
24 këtë video duke filluar nga minuta e 12:00.

25 Z. PACE: [Përkthim] A mund të na thoni pak më tepër

1 hollësi se cila është data dhe me çfarë ka të bëjë kjo video,
2 pak më tepër.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do jua bëj të qartë gjatë pyetjeve
4 që do i bëj dëshmitarit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na thatë
6 kohën e fillimit të videos po nuk na e thatë se kur duhet të
7 përfundojë transmetimi i videos.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Deri në 52:40 dhe pastaj do i
9 kërkoj Sekretares që të transmetojmë në minutën e 53-të. Ose
10 mbase nuk ia vlen që të bëjmë pauzën po mund ta transmetojmë
11 të gjithën.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Klipi duket sikur është
13 i gjatë gjashtë minuta, nuk është 53 minuta.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Është edhe më i thjeshtë atëherë.
15 Le ta transmetojmë të gjithë klipin, të gjithë pjesën.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta dëgjojmë të gjithë pjesën. Për
18 procesverbal -- ju kërkoj ndjesë e kisha gabim. Data është 16
19 shkurt 2011. Datën e dhashë gabim. E korrigjoj.

20 [Luhet videoincizimi]

21 "... është në interes të gjithkujt që të sqarohet kjo
22 çështje. Është e rëndësishme që të sqarohet për të gjithë,
23 është e rëndësishme që të kemi një lloj përfundimi.

24 "Ky është një raport i Dick Marty, ish-parlamentar i
25 Këshillit të Evropës që pretendon që z. Thaçi dhe anëtarë të

1 UÇK-së kanë qenë të përfshirë në trafikim të organeve në
2 organizatë kriminale. Sa për t'jua sqaruar.
3 "Kjo është një temë goxha e diskutuar e ditës.
4 "Unë e kam parë këtë sepse kisha një lloj ndjesie që do
5 ishte një çështje që do ngrihej këtu debat. Unë e di që
6 marrëdhënia ime me z. Thaçi është diçka e cila është kritikuar
7 në atë kohë prej disa "realistëve" të Departamentit të Shtetit
8 dhe komunitetit ndërkombëtar sepse ndryshe nga z. Rugova, ai
9 ishte një pjesëtar i ri i ekipit negociues së Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës dhe ishte i lidhur, kishte lidhje me
11 persona nga fshatrat dhe persona të tjerë nga qytete, qyteza
12 dhe kishte dhe faktorë të tjerë që kanë luajtur rolin e tyre.
13 Me kalimin e kohës kam parë me interes që secili prej
14 përfaqësuesve amerikanë dhe në një pikë jam kontaktuar prej
15 tyre, gjithsesi tani nuk jam në qeveri, kështu që unë thjesht
16 po bëj pyetjen që më duhet të them që evolucioni ose zhvillimi
17 politik ka qenë jashtëzakonisht pozitiv dhe është ekzaktësisht
18 ajo çfarë shpresonte Qeveria e Shteteve të Bashkuara për sa i
19 takon zhvillimit politik, evoluimit politik të një partie dhe
20 një të riu që u bë një lider politik. Megjithatë, të gjitha
21 bisedat në prapavijë sa i takon krimit e drogës dhe gjërave të
22 këqija, fenomeneve negative, për të cilat njerëzit flasin
23 sikur kanë kompetencë të plotë, sikur dinë gjithçka lidhur me
24 to. Dhe kjo është një nga ato gjërat e çuditshme në Ballkan,
25 ku të gjithë thonë që janë absolutisht të sigurtë, por pastaj

1 kur i thua personit X se çfarë prove ke ti lidhur me këtë
2 askush s'të thotë dot asgjë. Ka një artikull në *London Review*
3 *of Book*, ku thuhet që tribunali ndërkombëtar penal kanë parë
4 këto akuza dhe në disa prej tyre thuhet që nuk ka prova lidhur
5 me të dhe janë ndaluar hetimet. Dhe nuk e di në qoftë se ky
6 zotëria me emrin Marty është objektiv as se ka qenë i anshëm
7 ose i paanshëm këtë unë nuk e di, megjithatë ca njerëz
8 mendojnë kështu. Pra, me fjalë të tjera unë nuk di lidhur me
9 këtë.

10 "Por ajo çfarë di unë me siguri është që në nivelin
11 politik sa i takon sjelljes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
12 unë vetë jam ftuar që të takohem me shumë prej tyre gjatë
13 kohës së përfundimit të luftës dhe të gjithë ata njerëz që sot
14 flasin me besim të madh lidhur me trafikimin e organeve,
15 drogës e krime të tjera, pra, ata thonë që nuk kishte asnjë
16 lloj mënyre që këta persona të çarmatosen. Por e vërteta është
17 që ata u çarmatosën. Ata nënshkruan marrëveshjen, përmbushën
18 kërkesën e Gjeneralit Jackson që vetë ishte në atë kohë shumë
19 cinik dhe i cili me kalimin e kohës është bërë mik i imi. Dhe
20 e kam kontrolluar këtë deklaratë dhe askush nuk ka provuar
21 deri më sot që ajo nuk është e vërtetë. Kështu që më duhet të
22 them që kemi të bëjmë me demilitarizim më të shpejtë të një
23 ushtrie fitimtare rebele në historinë moderne, në historinë
24 luftarake moderne. Nuk është se kjo ka çuar në ndonjë besim në
25 besueshmërinë e disa personave në idetë konspirative të errëta

1 që janë të fshehura thellë dhe që ndonjëherë e ngrenë kokën. A
2 kam unë ndonjë dyshim që ka njerëz që janë të lidhur me
3 partinë e z. Thaçi ose me palë të tjera të cilat në 'janë të
4 lidhura' me atë shoqëri? Ku fjala 'të lidhur' është një prej
5 këtyre fjalëve të jashtëzakonshme me këto struktura, klane
6 familjare, domethënë, kjo është një gjë shumë, një fushë, një
7 lëmi shumë e vështirë për t'u penetruar. A ka krim a ka
8 korrupsion, a ka aktivitet që kryhet nga njerëz të cilët 'janë
9 të lidhur' me kryeministrin? Sigurisht që mund të këtë njerëz
10 të tillë. Po pse duhet që kjo temë gjatë gjithë kohës të
11 ngrihet herë pas here për të kundërshtuar legjitimitetin e
12 zgjedhjeve të lira në një pjesë të botës ku ka kufizime të
13 caktuara lidhur me atë se çfarë mund të arrijmë ne si persona
14 të jashtëm në raport me atë shoqëri. Ju kam kërkuar që të
15 bëjnë angazhime të caktuara për serbët që jetojnë në atë zonë
16 dhe ata i kanë përmbushur këto angazhime. I kemi kërkuar që të
17 bëjnë të caktuara i kanë bërë ato gjëra. Por a mund të
18 ndryshojmë të gjithë mentalitetin e popullatës 80+ për qind
19 ndaj personave që ata i kanë konsideruar si shtypës për kaq
20 shumë kohë? Këtë e dyshoj. Kjo nuk do të thotë që nuk duhet ta
21 provojmë, por do të thotë që duhet të jeni realist, do të
22 thotë që ne nuk duhet të pretendojmë që e dimë me siguri se
23 kush është kriminel e nuk është kriminel derisa të kemi prova
24 të qarta në dorë. Unë mendoj që z. Marty do bënte mirë, do i
25 bënte mirë gjithë botës që t'i jepte provat e veta që mungojnë

1 dhe dua që të mbështesë akuzat e veta të çmendura.

2 "Në fakt unë sugjeroj që të gjithë ata që e kanë lexuar
3 në tërësinë e vet raportin dhe besoj që mësimi që duhet
4 nxjerrë për studentët do ishte që është e rëndësishme që të
5 shkruanin gjëra vetëm kur të keni prova. Pra, përmenden shumë
6 dëshmitarë por nga ana tjetër nuk jepet asnjë provë, por pjesa
7 më e madhe e raportit është një aktakuzë ndaj UÇK-së që
8 përshkruhet si një organizatë tërësisht kriminale që disa prej
9 tyre vetëm thjesht kanë luftuar për të mbrojtur familjet e
10 veta, po nuk mund të thuash për një komb të tillë që janë
11 kriminelë. Është thjesht një supozim, një hamendësim, një
12 akuzë. Megjithatë le të mendojmë që teoria e konspiracionit
13 është e vërtetë për një çast.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo thjesht po prisja që të
15 mbaronte përkthimi.

16 PY. Z. Rubin, në përgjigje të pyetjes së Prokurorit ju thatë
17 që i keni ndjekur akuzat, besoj, që thatë i keni ndjekur këto
18 akuza për gjatë 25 viteve të fundit, a është e vërtetë kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Në këtë video ju thoni që keni ca njohuri lidhur me një
21 raport që është shkruar nga dikush që e ka emrin Dick Marty. A
22 e dini se për çfarë akuzash flet ky persona në këtë raport?

23 PË. Po.

24 PY. A e dini se pse është themeluar kjo Gjykatë, cila ka qenë
25 arsyeja e krijimit të kësaj Gjykate?

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 89

1 PË. Mendoj që kjo Gjykatë është themeluar me kërkesë të
2 liderëve evropianë dhe amerikanë, ndoshta liderët evropianë
3 për qeverinë e Kosovës.

4 PY. Dhe për çfarë teme, për çfarë arsye është krijuar?

5 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj këtë linjë pyetjes sa i
6 takon faktit që është jorelevante dhe nuk është se ishin
7 pyetje këto të cilat unë i ngrita gjatë pyetjes time të
8 dëshmitarit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka të drejtë
10 Prokurori.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka lidhje. Ju lutem më lini të
12 përfundoj se nuk ka vendosur Gjykatësi akoma pavarësisht se
13 Pace tha që vendosi.

14 Kjo ka të bëjë me kritikën e dëshmitarit dhe parashtrimi
15 im është që relevanca e vetme e kësaj pyetjeje ka të bëjë me
16 besueshmërinë e dëshmitarit. Kështu që, dëshmitari duhet t'i
17 jepet mundësia që të japë bazën për të rrëzuar ose për të
18 vërtetuar kritikën e drejtuar në raport të tij.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni të
20 drejtë.

21 Rrëzohet kundërshtimi.

22 Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. A jeni në dijeni të faktit se për çfarë arsye është
25 krijuar kjo Gjykatë?

1 PË. Nuk e kam lexuar --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, si
3 fillim thoni "po" ose "jo" dhe pastaj mund ta shtjelloni më
4 tej.

5 DËSHMITARI: Ju lutem përsëriteni dhe një herë pyetjen.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. A jeni në dijeni të arsyes pse është krijuar kjo Gjykatë,
8 mbi çfarë baze, cilat janë akuzat fillestare për të cilat u
9 kërkua krijimi i kësaj Gjykate?

10 PË. Jo.

11 PY. A dini ju çfarë ka ndodhur me pretendimet e z. Marty në
12 fund?

13 PË. Mendoj që nuk përfunduan asgjëkund, nuk kishte asnjë
14 zhvillim të këtyre akuzave të tij.

15 PY. Ajo çfarë thoni ju në videon që sapo pamë a është në
16 përputhje me faktin që ju keni thënë që keni ndjekur gjatë
17 kohës se ajo çfarë ka ndodhur lidhur me pretendimet e akuzat e
18 ngritura ndaj UÇK-së, domethënë, që prej pas luftës e deri më
19 sot?

20 PË. Nuk mund t'i përgjigjem me po ose jo, më duhet që të them
21 një përgjigje më të zgjeruar. Ndoshta do ishte mirë që ta
22 thoni dhe një herë pyetjen që të kem mundësi që të them
23 përgjigje me po ose jo.

24 PY. Do ua them dhe një herë pyetjen. Është faji im që jua
25 bëra aq të komplikuar. Pra, në video ju thoni që ju keni

Dëshmitari: James Rubin (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 91

1 ndjekur atë çfarë ka ndodhur sa i takon pretendimeve ndaj UÇK-
2 së, ndërkohë që videoja është e 2011?

3 PË. Po. A i keni ndjekur akuzat e ngritura kundër UÇK-së që
4 prej fundit të luftës e deri më sot?

5 PË. Me aq sa kam pasur mundësi, po.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do kërkoja që ky
7 dokument të pranohet në prova. Dokumenti është DHT12046 deri
8 në DHT1246 plus transkriptin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E gjithë
10 videoja?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e ndërpres dot, nuk e copëzoj
12 dot, kështu që e gjithë videoja.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 Atëherë dokumenti DHT12046 deri në DHT12046 dhe
15 transkripti përkatës do pranohen në prova gjyqësore.

16 Keni kundërshtim, z. Pace?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
19 videoja dhe transkript pranohen në prova gjyqësore.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
21 marrë numrin e provës 1D370.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. z. Rubin, faleminderit që mu përgjigjët në pyetjet e mia
24 plotësuese.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës nuk kam pyetje

1 tjera për dëshmitarin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket sikur
3 përfunduar po në fakt s'kemi përfunduar se dhe Gjykatësit kanë
4 pyetje për juve. Dëgjoni me vëmendje Gjykatësit, ju lutem.
5 Gjykatësi Barthe do të jetë i pari që do të fillojë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.

7 Pyetje nga Trupi Gjykses:

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Rubin.

9 PË. Faleminderit. Mirëdita.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sikurse e tha Gjykatësi
11 Smith, ne kemi disa pyetje të tjera në mënyrë të tillë që të
12 kuptojmë më saktë dhe më drejtë dëshminë tuaj. Për këtë ne do
13 kalojmë dhe shikojmë tuaj, dëshminë që i keni dhënë Mbrojtjes
14 në mars të vitit 2025 dhe do shikojmë gjithashtu dhe disa
15 dokumente të tjera për të sqaruar disa aspekte të cilat nuk i
16 kemi tërësisht të qarta.

17 Do filloj me paragrafin 24 të deklaratës suaj. Në këtë
18 paragraf shkruhet si më poshtë dhe këtu citoj:

19 "Në një pikë gjatë konferencës" dhe këtu ju flisni për
20 Konferencën e Rambujesë për ta pasur të qartë, "z. Thaçi ndau
21 me mua shqetësimet e tij që nuk kishte kompetencë të plotë për
22 të nënshkruar në emër të UÇK-së pa miratim. Në këtë moment unë
23 fillova ta kuptoja që ai ishte më tepër fytyra publike e UÇK-
24 së për ta përfaqësuar, prezantuar perëndimit dhe nuk ishte
25 personi në komandë. Sinqerisht, ne nuk e kishim të qartë se

1 nga ku duhet ta merrte miratimin z. Thaçi. Disa mendonin se që
2 duhet ta merrte miratimin nga Adem Demaçi. Ajo çfarë dinim ne
3 ishte fakti që ushtarakët ose segmenti ushtarak ishin ata që
4 merrnin vendimin. Ishte e qartë nga ajo çfarë më tha Thaçi që
5 atij i duhej që të kthehej përsëri në shtëpi dhe duhej që të
6 merrte miratim nga të gjitha këto grupe të ndryshme ose klane
7 të ndryshme.”

8 Pyetja e parë që kam për ju, z. Rubin, është kjo: Nga e
9 dini ju që ishte krahu ushtarak që duhet të merrte vendim? A
10 jua ka thënë z. Thaçi shprehimisht ju këtë gjë, domethënë, që
11 vendimi merrej nga ushtarakët, apo jo?

12 PË. Të nderuar Gjykatës, me aq sa më kujtohet mua, ky ishte
13 prezumim, kështu e kam kuptuar unë. Nuk është se ma ka thënë
14 specifikisht ose troç z. Thaçi ose nga ku duhet ta merrte
15 miratimin, por unë e dija që UÇK-ja kishte dhe të
16 ashtuquajturën degën ushtarake. Dhe unë mendoj që ishte
17 prezumim ose kështu e kam kuptuar unë vetë nga ajo që më është
18 thënë po nuk është se ma ka thënë me gojën e vet z. Thaçi këtë
19 gjë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund t’ju pyes tani për
21 çfarë e kishit fjalën kur thatë grupe të ndryshme, klane të
22 ndryshme, për cilët grupe apo klane e kishit fjalën?

23 PË. Mendoj që nuk e kisha fjalën për ndonjë klan në veçanti.
24 Po përpigësja të komunikoj se struktura e udhëheqësve të
25 Kosovës dhe vendimmarrësve në një shoqëri që ne nuk e kuptonim

1 mirë, nuk e njihnim mirë, kishin nevojë për ideologë politikë,
2 ushtarakë, siç ishte UÇK-ja dhe ata që unë i quaj udhëheqës të
3 klaneve, ne e kuptuam që ishte shoqëri që organizohej rreth
4 familjeve të gjera, personave të vjetër me autoritet, pra, nuk
5 kisha fjalën për një klan në veçanti.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Rubin, në
7 paragrafin në vijim, paragrafi 25 i deklaratës suaj, ju
8 flisni, përmendni z. Thaçi që kërcënohet sepse po lëshon, po
9 bën shumë lëshime. Dhe ju kujtohet që i keni -- se ai ju ka
10 folur për kufizimet që kishte, që kishte në një farë mënyrë
11 nuk mund të bënte gjithçka. Ju kujtohet që i keni thënë këtë
12 Mbrojtjes?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na jeni pak më i
15 saktë, më konkret duke filluar me çfarë lloj kërcënimesh
16 bëheshin ndaj z. Thaçi dhe kush e kërcënonte atë?

17 PË. Dua të jem sa më i qartë që të jetë i mundur. Nuk kam
18 patur asnjëherë prova personale personalisht për ndonjë nga
19 ndonjë burim i veçantë që ai ishte i kërcënuar. Rambujeja
20 ishte një mjedis ku kishte njëlloj tensioni. Njerëzit ishin
21 gjithmonë aty duke thonë gjithmonë gjëra. Disa ishin të
22 vërteta disa nuk ishin. Ai ishte person i ri për mua dhe ishte
23 e qartë për mua që pjesëtarët e tjerë të delegacionit amerikan
24 thonin gjëra rreth UÇK-së apo shqiptarëve të Kosovës,
25 shqiptarë të Kosovës, UÇK-së dhe kjo ishte përvoja ime që isha

1 zhytur, ishte përvojë e re, unë isha zhytur në këtë funksionim
2 të brendshëm.

3 Dhe, pra, do përpiqem të kujtoj që dikush -- dhe pse
4 përpiqem që dikush në ekipin tim tha që ai është kërcënuar apo
5 dikush në ekipin tim tha që ai është i frikësuar dhe pastaj në
6 këto raste bisedoja me të dhe përpiqesha të kuptoja se ishte e
7 vërtetë apo jo. Ai nuk më ka thënë asnjëherë që është
8 kërcënuar por ka qenë një supozim i përgjithshëm që ai ishte
9 tensionuar dhe kjo ishte pse lëvizjet e tij brenda dhe jashtë
10 kështjellës ishin të kujdesshme. Dhe më kujtohet që më ka
11 thënë në një herë sesa e vështirë ishte për atë që të hynte
12 dhe të dilte nga Kosova duke kaluar përmes maleve për
13 mbrojtje.

14 Pra, mendoj, si ta them, ishte një frikë e përgjithshme
15 dhe kërcënimet ishin kryesisht nga forcat serbe të cilat,
16 mendoj, e kishin dënuar me vdekje në një pikë të caktuar. Nuk
17 e di nëse kjo ishte në Rambuje. Por e kuptoj që serbët e
18 kishin kërcënuar, pra, ai kërcënohej nga ushtria serbe nga
19 udhëheqja serbe.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ju dëgjoj, po flisja me
21 Kryegjykatësin gjithashtu, por ju dëgjova në të njëjtën kohë.

22 Faleminderit, z. Rubin. z. Thaçi a ka përdorë termin
23 ndonjëherë "kërcënim"?

24 PË. Po. Njerëzit, personat në delegacionin amerikan e
25 përdorën termin më kujtohet. Po ai ishte njeri me dinjitet dhe

1 nuk mendoj që donte të më thoshte mua personalisht që ishte i
2 kërcënuar apo kishte një kërcënim konkret ndaj tij. Por
3 atmosfera ishte se ai ishte i kërcënuar nga forcat ushtarake
4 serbe dhe kjo bënte atë që të udhëtonte me shumë kujdes.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Dhe a mund të na
6 thoni se çfarë ishin lëshimet që z. Thaçi bëri gjatë raundit
7 të parë të bisedimeve në Rambuje?

8 PË. Marrëveshjet e Ramujesë, për ata që i kanë lexuar, janë
9 shumë të gjera dhe të hollësishme, përmbajnë shumë hollësi
10 përfshirë edhe lejimin që NATO të jetë struktura ushtarake e
11 sigurisë dominuese, zotëruese në Kosovë. Dhe kjo ishte kundër
12 idesë që UÇK-ja të jepte, të krijonte, të ofronte sigurinë për
13 popullin e Kosovës. Pra, kjo ishte në formën bazike të saj
14 ishte një lëshim.

15 Së dyti, duke u pajtuar në parim, besoj, se ne kishim
16 bërë atë që quhet në parim, për marrëveshjen në parim. Këto
17 marrëveshje nuk kishin një garanci për pavarësinë e Kosovës,
18 në vetvete nuk e përmbanin, pra, marrëveshja nuk e përmbante.
19 Ata thjesht thonin apo përmbanin elementë tregues që mund të
20 ishte mundësia e shprehjes së vullnetit të popullit pas tre
21 vjetësh dhe, besoj, pra, kjo është. Pavarësia ishte lëshim dhe
22 kjo ishte gjë e madhe.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pas raundit të parë të
24 bisedimeve në konferencën në Ramuje u pezulluan, pra, u
25 ndërpreu për besoj dy-tre javë dhe pastaj raundi i dytë i

1 bisedimeve filloi në Paris, apo jo?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe pastaj në fund, po i
4 referohem paragrafit 27 të deklaratës suaj tani, delegacioni i
5 Kosovës nënshkroi marrëveshjen më 18 mars 1999?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e mia
8 të tjera kanë të bëjnë me shkëmbimet apo ndërveprimet që keni
9 patur me z. Thaçi gjatë fushatës së bombardimeve ajrore të
10 NATO-s nga marsi në qershor 1999. Dhe siç është shënuar në
11 paragrafin 27 të deklaratës suaj, ju keni thënë se bombardimet
12 e NATO-s filluan më 24 mars 1999. Dhe gjatë bombardimeve
13 fushatës së bombardimeve keni qenë në kontakt të shpeshtë me
14 z. Thaçi. Keni biseduar me të rreth mes 10 dhe 40 herë. Dhe
15 qëllimi i këtyre thirrjeve telefonike ishte shkëmbimi i
16 informacionit për atë që po ndodhte në terren, zhvillimet,
17 pasi nuk kishit ambasadë apo burime tjera informacioni nga
18 terreni që t'i merrnit, pra, informacionet në kohë reale apo
19 informacione të besueshme në kohë reale lidhur me atë që po
20 ndodhte.

21 A është kjo që i keni thënë Mbrojtjes në mars?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rubin, a e dini ku ishte
24 z. Thaçi gjatë këtyre bisedave telefonike ishte brenda apo
25 jashtë Kosovës?

1 PË. Besoj që më ka thënë se, jo çdo herë, por ishte shpesh në
2 Kosovë i fshehur duke u ruajtur që të mos vritej dhe duke
3 ndihmuar me organizatën e tij popullin e Kosovës. Mendoj që më
4 ka thënë që nuk ka qenë gjithmonë aty, por mendoj që pjesën më
5 të madhe të kohës ka qenë aty brenda në Kosovë pra.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto thirrje telefonike janë
7 bërë përmes telefonave satelitor, besoj?

8 PË. Po, ai ka patur një telefon satelitor dhe thërriste në
9 qendrën operative të Departamentit të Shtetit në një orë të
10 caktuar në mëngjes, mendoj dhe pastaj ma kalonin mua në
11 telefon.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju a e thërrisnit atë?

13 PË. Jo. Nuk kisha numrin e tij të telefonit.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi a ishte në gjendje
15 t'ju jepte juve informacionin që ju nevojitej juve drejt për
16 drejtë apo ju thoshte që duhej të merrte informacionin nga
17 persona të tjerë së pari?

18 PË. Dua të them që unë isha -- unë e merrja informacionin,
19 jo, nuk kërkoja informacionin. Pra, bisedat telefonike
20 zakonisht fillonin me unë e pyesja atë nëse ishte mirë, a
21 ishte me shëndet mirë, familja e tij, gjëra personale të
22 tilla. Dhe pastaj përpigësja të merrja nga ai informacionin
23 lidhur me atë që po ndodhte në terren. Në këtë kohë, zakonisht
24 isha e dija që mund të kishte persona të tjera në Qeverinë e
25 Shteteve të Bashkuara që komunikonin me UÇK-në por nuk kisha

1 dijeni për hollësitë e kësaj. Dhe këto ishin kryesisht raporte
2 të lidhur me vuajtjen e civilëve brenda Kosovës, kryesisht.
3 Këtë më tha ai.

4 Dhe dua të shtoj, që të jem sa më i saktë që është e
5 mundur, që disa ndonjëherë edhe gabohej. Ai mund të merrte një
6 raport, i thuhej diçka nga dikush, e kontrollonte dhe dilte që
7 nuk ishte i vërtetë. Por ne donim të merrnim informacionin dhe
8 në mënyrë që ta komunikojta unë pastaj dhe tjerëve. Dhe mendoja
9 që ishte diçka që dukej që kishte pak gjasë -- kur mendoja në
10 raste që mund të mos ishte e vërtetë, atëherë nuk e komunikojta
11 këtë informacion pas analizës së tij. Pra, jam përpjekur që të
12 rikontrolloj, të verifikoj që të raportojta te mediat bisedat
13 tona.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe a ju tha
15 z. Thaçi se nga e merrte informacionin, nga i merrte raportet?
16 PË. Jo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A përmendi ndonjë gjë disi
18 të tillë ZKZ apo Drejtoria për Zbulim dhe Kundërzbulim?
19 PË. Jo. Më lejoni ta riformuloj këtë, i nderuar Gjykatës.
20 Mund të ketë thënë, ta ketë përmendur si referencë organizatës
21 së tyre. Sa i takon gjithë personave që ishin të përfshirë, të
22 gjithë përpiqeshin që të na impresiononin neve me organizatën
23 e tyre, por ne nuk ishim të impresionuar, të them të drejtën,
24 pra, shpesh ai përpigjej të na impresiononte neve, të gjithë
25 udhëheqësit e UÇK-së përpigjejin të bënin këtë gjë, por nuk

1 impresionoheshim lehtë se dhe komentet e Senatorit Biden ishin
2 siç u përmendën komentet e Senatorit Biden më herët. Unë isha
3 ndoshta më i impresionuar por nuk isha i impresionueshëm dhe e
4 di që ndonjëherë ai e bënte të dukej sikur ishte një inditet
5 më formal dhe me aftësi formale, tani ai ishte politikën
6 ushtarake, zbulimit që, siç e dija unë, që ndodhë shpesh në
7 politikë ishte pak e ekzagjeruar me fjalë tjera.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rubin, a e dini nëse UÇK-
9 ja kishte një drejtori zbulimi dhe kundërzbulimi?

10 PË. Nuk e di. Konkretisht, fjala është një prej atyre fjalëve
11 që duhet të largohemi sepse është një lloj, mund të
12 keqkuptohet. E kam fjalën a mblidhnin informacion? A kishin
13 njësi që mblidhnin informacion? A kishin njësi që siguroheshin
14 që njësitë e tyre të mos jepnin informacion, domethënë,
15 kundërzbulimi? Po, kjo po. Por a ishte kjo njësi si njësi e
16 vërtetë siç ne do ta thërrisnim atë? Nuk mendoj që ishte në
17 atë kohë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani?

19 PË. Tani vendi është zhvilluar ka ecur më tej, shpresoj që ta
20 kenë një njësi të tillë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e
22 radhës ka të bëjë me paragrafin 30 të deklaratës suaj.

23 Në këtë paragraf ju përmendni marrëveshjen për
24 demilitarizimin dhe transformimin e UÇK-së dhe ju thoni që
25 sipas këtij paragrafi, negociatat u bënë nga britanikët dhe

1 juve pranuat një telefonatë ku ju informuan se Gjenerali Reith
2 kishte biseduar me gjeneralët dhe udhëheqësit e UÇK-së dhe që
3 siç i përshkruante Reith ata dhe po ju nuk jeni informuar se
4 udhëheqësit e UÇK-së nuk donin të nënshkruanin dhe donin që z.
5 Thaçi të nënshkruaj sepse ai ishte fytyra publike e UÇK-së dhe
6 ndërvepronte me perëndimin në Rambuje dhe fliste përpara
7 ndërkombëtarëve. Ju kujtohet që keni thënë këtë?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbrojtja? A e dini z. Rubin
10 për kë e kishte fjalën Gjenerali Reith kur përmendi gjeneralë
11 dhe udhëheqësit e UÇK-së? A përmendi ndonjë person në veçanti,
12 konkret, ndonjë emër?

13 PË. Jo. Por më vonë, dua të them, që u bë e qartë për mua se
14 ai kishte një marrëdhënie me Agim Çekun dhe e përshkruante atë
15 si komandanti i përgjithshëm i UÇK-së. Kjo është ajo që
16 gjenerali Reith më tha mua.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'i ktheheni kësaj më
18 vonë.

19 PË. E saktë. Dhe në atë kohë nuk e dija këtë gjë dhe nuk
20 kisha dëgjuar emra fillimisht.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në paragrafin
22 32 të deklaratës tuaj ju keni diskutuar, ju përmendni takimet
23 që keni patur me z. Thaçi dhe të tjerë që kanë çuar pastaj në
24 nënshkrimin e marrëveshjes në qershor 1999. Ju thoni që kishit
25 përshtypjen se z. Thaçi ishte veçmas i ndarë nga gjeneralët e

1 UÇK-së. "Nuk ishte që z. Thaçi shkante për të shkuar për t'u
2 marrë me njërin prej këtyre çdo herë që ne i kërkonim diçka
3 apo e pyesnim për diçka. Nuk ishte kjo lloj marrëdhënie". Dhe
4 ju thoni e keni parë, keni parë, pra, struktura pushteti
5 vertikale por kjo nuk ishte sipas pikëpamjes tuaj një prej
6 atyre, pra, struktura vertikale të pushtetit.

7 Dhe ju thoni në fund të paragrafit se:

8 "Çdo herë që kishit nevojë të ndryshonit diçka përgjigja
9 e z. Thaçi ishte, 'Në rregull, po duhet të pyes ata'."

10 Dhe ju duhet t'i jepnit atyre, t'i jepnit z. Thaçi arsyet
11 që t'i binde ata, gjeneralët mendoj, që në pikëpamjen tuaj
12 pra, z. Thaçi nuk kishte absolutisht mundësi që t'u thoshte
13 atyre çfarë të bënin. A ishte kështu?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A i keni thënë këtë gjë
16 Mbrojtjes? Z. Thaçi ju ka thënë juve që pse ishte e vështirë
17 për atë që të bindte gjeneralët?

18 PË. Kjo është pyetje e mirë. Mesa më kujtohet, në fakt, nuk e
19 kam menduar kaq shumë. Më lejoni ta bëj këtë gjë tani. Besoj
20 që ai përpigjej të na sqaronte se ata ndiheshin fitimtarë si
21 gjeneralë të një ushtrie. Edhe pse ne nuk i konsideronim atë
22 të tillë, ai komunikoi këtë gjë sikur të ishin ushtri. Dhe
23 gjeneralët fitimtarë u kërkohej, pra, atyre që t'i dorëzonin
24 armët. Kjo ishte gjë e vështirë.

25 Dhe kjo ishte, kjo shpjegonte në mënyrë të vazhdueshme

1 vështirësitë për mua dhe ai m'i shpjegonte vazhdimisht këto
2 vështirësi mua për popullin që normalisht ishin të armatosur
3 dhe ishin të armatosur në këtë luftë dhe tani u kërkohej atyre
4 që të çarmatosen dhe mendoj që kjo shpjegonte se pse ishte e
5 vështirë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rubin, në qoftë se mund
7 të shtoj kjo nuk është që ata ishin por duhej të
8 çarmatoseshin, ndoshta të gjithë do humbnin pozicionet e tyre,
9 gradat e tyre.

10 PË. Ai nuk e tha këtë, po mendoj që nënkuptohej. Por po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, kjo nuk ishte më
12 surprizë apo habi për ju?

13 PË. E saktë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mendoj të paktën për juve?

15 PË. E saktë. Është vështirë që të braktisësh, të heqësh dorë
16 nga diçka. Dhe më vjen mirë që e thatë sepse unë kam qenë në
17 pjesë të tjera të botës ku çarmatimi ka qenë problem,
18 vështirësi e madhe që ushtarët dhe gjeneralët që kishin
19 pushtet dhe do ta humbisnin këtë pushtet pas demobilizimit dhe
20 ne jemi përpjekur që të gjejmë diçka të mesme, një zgjidhje të
21 mesme që ishte një forcë mbrojtëse, trupa mbrojtëse. Dhe
22 hollësitë negociatave lidhur me këtë ishin që ishte një forcë
23 mbrojtëse? A do të kishte uniforma? Çfarë force do të ishte?
24 Cilat do të ishin detyrat e saj? Cili do të ishte armatimi i
25 saj? Dhe kjo ka qenë rruga e mesme mes ushtarakes, pra,

1 dëshirës së Gjeneralit Jackson që ishte qasja ushtarake për
2 një ambient që jepte të lejueshme, që jepte mundësi të
3 operohej në të cilën UÇK-ja do të demobilizohet.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj që kjo
5 është e qartë tani.

6 Z. Rubin, tani kam edhe disa pyetje lidhur me disa
7 dokumente që ju treguan juve gjatë marrjes në pyetje apo
8 intervistës me Mbrojtjen e z. Thaçi. Do të doja të fillojmë me
9 kabllogramin e datës 15 shkurt 1999. Nuk ka nevojë të shfaqet,
10 por raportet e kabllogramit për Sekretaren e Shtetit, për
11 takimin e Sekretares së Shtetit Albright me delegacionin e
12 Kosovës dhe atë të Serbisë në Rambuje më 14 shkurt 1999. Dhe
13 ju thoni në paragrafin 37 të deklaratës se ishte ndoshta
14 takimi i parë me z. Thaçi dhe Thaçi tha, thoni ju, që ai donte
15 të jetonte bashkë me serbët dhe ai donte demokraci dhe ishte
16 gati të nënshkruante marrëveshjen që natyrisht ishte shumë e
17 rëndësishme.

18 Jam i vetëdijshëm, z. Rubin, që dhe më duket që dje në
19 faqen 57 të transkriptit juve u pyetët të njëjtën gjë nga
20 palët dhe përgjigja juaj ishte -- më duket që ishte z. Misetic
21 që ju pyeti nëse deklaratat e z. Thaçi ishin të sinqerta. Dhe
22 përgjigja juaj ishte:

23 "Në punën tonë, fjalët janë të rëndësishme, por veprimet
24 janë edhe më të rëndësishme. Por", ju thatë "fjalët janë një
25 fillim shumë i mirë".

1 Megjithatë, dua t'ju pyes juve a besuat atë që z. Thaçi
2 ju tha gjatë këtij takimi të parë që UÇK-ja, shqiptarët e
3 Kosovës donin të jetonin bashkë krahas serbeve në Kosovë dhe
4 që z. Thaçi ishte i interesuar dhe donte demokraci dhe ishte
5 gati të nënshkruante marrëveshjen? A e besuat këtë?
6 PË. Besoj që ai donte një marrëveshje. Besoj që donte
7 demokraci edhe pse fliste me një gjuhë komuniste në atë kohë.
8 Ishte përmes përkthimit, pra, është pak e vështirë që të bëhet
9 një vlerësim i saktë.

10 Sa i takon bashkëjetesës, e di që shqiptarët e Kosovës
11 kishin kaluar, jetuar në një regjim shtypës për dekada të
12 tëra, me mijëra ishin vrarë dhe e dija që ai po thoshte atë që
13 ne donim të dëgjonim që ishte gjë e mirë. Tani a e besova
14 këtë? Të jem i singertë i kam besuar gjithnjë e më shumë me
15 kalimin e viteve sepse ai tregoi që fjalët që thoshte i
16 përkthente në veprime lidhur me ato pika për atë që më thoshte
17 mua edhe pse nuk kam dyshuar në të.

18 Pra, u binda gjithnjë e më shumë për sinqeritetin e
19 deklaratave të tij me kalimin e kohës. Për sa i takon pikës së
20 tretë kisha dyshimet e mia.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Rubin, më
22 korrigjoni në qoftë se e kam gabim, por në deklaratën tuaj më
23 herët sot në mëngjes konfirmuat duke iu përgjigjur pyetjes së
24 Prokurorit se ju ishit në dijeni për akuzat, për krime apo
25 shkelje të drejtave të njeriut nga pjesëtarë të UÇK-së kundër

1 serbëve etnik apo pakicave të tjera në 1999-n?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe tani kjo është pyetja
4 ime e radhës. A i keni diskutuar këto akuza me z. Thaçi qoftë
5 në Rambuje apo në Paris më vonë?

6 PË. Për t'ju përgjigjur juve saktësisht, as në Rambuje, as në
7 Paris, por më vonë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të jeni më i saktë
9 kur i keni diskutuar këto në 1999?

10 PË. Po. Mu dha mundësia dhe momenti kur i kam diskutuar këto
11 më gjerë, më gjerësisht dhe ia përmenda këtë dhe Prokurorisë
12 më herët, më dërguan në Kosovë për të trajtuar një trajtim
13 urgjent në Luginën e Preshevës, ky është momenti kur kam
14 udhëtuar vetë si udhëheqës i delegacionit.

15 Herët e tjera kur kisha shkuar në Kosovë me z. Thaçi në
16 udhëtimet e znj. Madeleine Albright unë merrja pjesë në
17 dialogun, ajo i përcillte pikat lidhur me tolerancën,
18 mosshpagimin, moshakmarrjen ndaj kryerësve të dhunës, atyre që
19 kishin shkaktuar dhunë.

20 Kur kam shkuar vetë pastaj që kam qenë përgjegjës në një
21 farë forme, nuk më kujtohet, por ka qenë lider politik më
22 shumë sesi përfaqësues i qeverisë dhe më kujtohet që ka qenë
23 në fund të pranverës apo vjeshtë 1999 dhe ia kam përmendur
24 këtë saktësisht. I kam thënë "Hashim, ne kemi shkuar në betejë
25 për ty. Kemi luftuar për ty. Kemi vënë besueshmërinë tonë në

1 rrezik për këtë gjë. Dhe ne do të dilnim shumë, shumë keq nëse
2 ju i bëni tani serbëve atë ju kanë bë serbët në mënyrë kaq të
3 tmerrshme nëse ua bëni atyre". Dhe i thashë këto gjëra
4 publikisht dhe në ambiente private dhe pranova që ne nuk do të
5 ishim më në gjendje ta ndihmonim, ta mbështesnim kauzën e tij
6 në qoftë se do të ndodhte një gjë e tillë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Cila ishte përgjigja e tij?
8 PË. Ai më siguroi se do të bënte gjithçka që ishte në
9 mundësitë e tija, deklarata publike, përpjekje për t'u takuar,
10 e tjera që të mos ndodhte.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju tha ai se në pikëpamjen
12 e tij këto pretendime ishin të vërteta, pretendimet për
13 shkeljen të drejtave të njeriut apo krime apo qoftë edhe krime
14 të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së apo ju tha që këto ishin
15 pretendime të rrejshme, pra, që nuk ishin të vërteta?

16 PË. Mendoj që varej nga pretendimi apo akuzat. Dhe mendoj që
17 ai e pranoi, po, që kjo ishte luftë dhe që në luftë gjërat
18 ndodhin. Por që pastaj ai gjithashtu theksoi faktin që kishte
19 prej tyre që ishin jashtëzakonisht të ekzagjeruara apo
20 propagandë serbe që shpesh shfaqeshin dhe pastaj nuk ishte e
21 vërtetë që ndodhnin. Por mendoj që pranoi që kishte gjëra që
22 ndodhnin për të cilat ai kishte dijeni apo kishte dëgjuar apo
23 kishte lexuar dhe nuk e kundërshtoi këtë, por e kuptoi që
24 marrëdhënia me mua dhe me Madeleine Albright varej nga veprimi
25 i tij që mund të bënte për të parandaluar këtë gjë, për t'u

1 shprehur kundër kësaj.

2 Pra, kryesisht ne po i kërkonim atij që të fliste
3 publikisht sepse ndjenim me gjithë mend se këto veprime ishin
4 veprime të individëve shqiptarë kosovarë familjet e të cilëve
5 ishin vrarë apo pjesëtarët e familjeve të cilët ishin vrarë
6 dhe që po hakmerreshin. Dhe përpjekjet tona kryesore
7 drejtoheshin drejt kësaj, pra, që ai të bënte deklaratë
8 publike në mënyrë që njerëzit të mos hakmerreshin, të mos
9 kërkonin shpëtim për dhunën që kishin pësuar nga kjo
10 organizatë, përkundër organizatës për të cilën ne nuk kishim
11 prova që për këtë organizatë, pra, UÇK-në që nuk kishte asnjë
12 provë që bënin apo ndërmerrnin veprime dhune të organizuara.
13 Pra, ne po flisnim për deklaratë publike për të parandaluar
14 dhunën shpaguese apo hakmarrëse. Kjo është ajo që po bënim ne.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Rubin. Z.
16 Thaçi a ju tha juve se çfarë bëri apo çfarë do të bënte në të
17 ardhmen për të vërtetuar nëse këto pretendime ishin të vërteta
18 apo jo?

19 PË. Nuk më kujtohet. Kryesisht mendoj që thjesht thashë ne po
20 kërkojmë që ju të bënit deklaratë dhe ai pranoi që të bëjë një
21 gjë të tillë ose të jepte shembuj të deklaratave që kishte
22 dhënë më parë. Ne donim që ai të bënte edhe më shumë
23 deklaratë. Të jepte deklaratë të tjera. Ishte një dokument i
24 Departamentit të Shtetit që Mbrojtja ma shfaqti më herët ku
25 kërkohej për deklaratë më të gjera, më gjithëpërfshirëse, më

1 koherente dhe ky ishte objektivi i diplomacisë. Unë nuk isha
2 hetues, nuk isha prokurori për krime lufte. Unë isha thjesht
3 një -- nuk isha person që merrej me të drejtat e njeriut. Unë
4 nuk duhet të kisha paraqitur rastet specifike apo konkrete.
5 Unë isha diplomat që po kërkoja udhëheqësit të një populli që
6 të bënte ato tre fjalë, pra, që t'i përsërisim dokumentet, t'i
7 thoshte në mënyrë të përsëritur, gjithëpërfshirëse, pra, duke
8 u bërë thirrje popullit që të mos përfshiheshin në akte dhune,
9 shpagimi apo hakmarrjeje. Kjo ishte ajo që kam bërë unë dhe do
10 të thoja e kam bërë këtë dhe ai më thoshte "E kam bërë këtë
11 dhe do t'i" bëj përsëri këto deklaratat. Dhe unë i thoja, "ne
12 me gjithë mend këmbëngulim që duhet të jemi koherent,
13 gjithëpërfshirës dhe të gjerë" në mënyrën që të -- dhe ai më
14 tha "okej".

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do t'ju bëj dhe një pyetje
16 z. Rubin, përpara se të -- dhe ju e keni bërë këtë pyetje z.
17 Rubin, përpara se deklaratat të bëhej publike, të paktën në
18 pikëpamjen time, në bazat faktike mbi të cilat ju bëni
19 deklaratën sepse ato janë, si ju thatë më herët sot në
20 mëngjes, mund të jenë pretendime të rrejshme dhe mund të jenë
21 pretendime që janë të vërteta në fund, por nuk përmendet
22 asgjë, nuk përmendet asgjë që ai bëri me qëllim që të zbulonte
23 nëse kishte bazë faktike për këto që po thuhej?
24 PË. E kuptoj këtë që po më pyesni, z. Gjykatës dhe po
25 përpiqem të ndajë mes punës që ju bëni dhe punës që unë bëj si

1 diplomat.

2 Si diplomat, unë i kërkoja atij që të bënte deklaratat
3 publike për të bërë thirrje që të mos kryhej dhunë hakmarrjeje
4 dhe që të mos i bënin të tjerëve atë që kishin pësuar këta.
5 Pra, si jurist për të drejtat e njeriut apo prokuror apo
6 dikush që thotë kjo çështje, zbuloni atë që ka ndodhur, na
7 thoni diçka këtë. Unë nuk kam pas këtë lloj ndërveprimi me
8 atë. I imi ka qenë në një nivel të lartë: punimi me KFOR-in,
9 puna me Kombet e Bashkuara, deklaratat publike që të shtynin,
10 që t'i bënte thirrje njerëzve të mos kryhej dhunë dhe zona e
11 përgjegjësisë që kisha lidhur me rrezikun e shpërthimit të
12 trazirave në Luginën e Preshevës. Këto kanë qenë pjesët e
13 përgjegjësisë që kam bërë unë dhe kërkesa ndaj tij për të bërë
14 deklaratat të tilla.

15 Unë thjesht po përpiqem të ndaj mes rolit tim siç më
16 kujtohet dhe atij të një hetuesi që kërkon informacione për
17 një problem, një akuzë apo një çështje.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Rubin, e kuptoj këtë që
19 thoni ju, por po ju pyes në aftësinë tuaj, në cilësinë tuaj si
20 diplomat po ju pyes -- nuk po ju pyesja në aftësinë, në
21 cilësinë tuaj si diplomat por në cilësinë tuaj si dëshmitar
22 sot. Desha thjesht të di nëse keni patur këtë lloj bisede me
23 z. Thaçi ku ju i keni thënë atij që me qëllim që ai bëri
24 diçka, për shembull, që të bënte diçka me qëllim që të
25 zbulonte se çfarë po ndodhte në terren dhe ju nuk keni bërë

1 një bisedë të tillë, a është kështu?

2 PË. Nuk besoj ta kem bërë këtë. Mendoj kryesisht që ai më
3 jepte një dhe më thoshte që një rast që ndoshta është i
4 pavërtetë, pastaj më jepte një shembull tjetër që thoshte
5 është vërtetuar që është i pavërtetë dhe pastaj bënte
6 thirrjen, pra, që të mos kishte veprime dhune. Pra, nuk më
7 kujtohet ndonjë gjë specifike konkrete lidhur me këtë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk është problem.
9 Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
11 t'ju japim një orë e gjysëm pushim tani. Kthehemi në orën
12 2.30.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
15 ndërpresim seancën tani. Një sekondë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, pyetëm WPSO nëse
17 kemi dëshmitarin këtu dhe në qoftë se nuk mendonim që mund ta
18 dëgjojmë sot mund ta lirojmë dëshmitarin, që ishte dëshmitari
19 i radhës.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e di sesa do zgjasë. Nuk
21 kam dëshirë t'ju them sesa pyetje do kem.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Do kem edhe unë pyetje. Do t'i bëj
23 edhe unë disa. Thjesht po pyes nëse mund të lirojmë
24 dëshmitarin e radhës. Në rregull atëherë. Nesër.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca

1 ndërprietet deri në orën 2.30

2 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

3 --- Seanca rifillon në orën 14.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
5 sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
8 Barthe do të vazhdojë me pyetjet e veta.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Dhe mirëdita, z. Rubin. Mirë se erdhe sërish. Dhe siç ju
11 thashë para pushimit, unë kam ende pyetje për ju, shpresoj të
12 jetë okej për ju.

13 PË. Patjetër.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të kalojmë në paragrafin 51
15 të deklaratës suaj ku thuhet si në vijim:

16 "Shtetet e Bashkuara nuk ishin të gatshme që të
17 angazhoheshin për pavarësinë menjëherë. Dhe kjo ishte
18 pikërisht ajo që donte Demaçi dhe ekstremistët e tjerë në
19 Rambuje. Por nuk ishte realiste, dhe pikërisht për këtë Thaçi
20 ishte në vështirësi kaq të madhe. Personat thonin që nëse
21 Thaçi nuk ishte për pavarësinë 'e vërtetë', atëherë ai nuk
22 ishte shqiptar i vërtetë, ai ishte tradhtar, pothuajse
23 tradhtar".

24 Pyetja ime tani është kjo, z. Rubin. Kur thoni populli,
25 njerëzit, për kë e keni fjalën ju këtu?

1 PË. Pyetje me vend. Në fakt ishte në vija të përgjithshme
2 kjo, nga sa më kujtohet mua periudha e Rambujesë, dhe si, me
3 sa kuptoj unë, situatën e tij, kjo është një deklaratë që
4 është bërë para disa muajsh, këtë vit, e thjesht kam pasqyruar
5 mënyrën se si e kam kuptuar unë situatën duke e parë në
6 retrospektivë, kuptohet. Ashtu e kam kuptuar unë situatën në
7 atë kohë. Domethënë, për atë ishte vështirë se atij i duhej
8 miratimi dhe ishte e vështirë sepse kishte persona që donin
9 medoemos pavarësi dhe ideja e një shqiptari të vërtetë, unë
10 thjesht pasqyrova diçka që e kam kuptuar kohë më vonë.

11 Nuk kam ndonjë emër konkret. Mendoj se Demaçi ishte
12 thjesht një shembull i këtij grupi.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po pse thoni
14 ju, "pothuajse tradhtar"?

15 PË. Mendoj se është e vështirë që t'i thuash dikujt që ka
16 luftuar dhe ka vendosur jetën në rrezik ta quash tradhtar. Unë
17 jam përpjekur të bëj një dallim mes pikëpamjeve ekstremiste,
18 domethënë, disa persona thjesht donin pavarësinë tani, dhe ky
19 ishte një person që ka rrezikuar jetën dhe lideri i një kauze
20 që nuk ishte pro gjithçkaje që ishin ekstremistët, prandaj e
21 kam thënë "pothuajse".

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Do të shohim
23 paragrafin 58, ku ju është treguar, sipas këtij paragrafi, ju
24 është treguar një deklaratë për shtyp e 6 marsit 1999, ka
25 lidhje me një konferencë për shtyp ku ka qenë Chris Hill i

1 pranishëm. Bëhet fjalë për materialin DHT05165 deri në
2 DHT05169. Sipas kësaj, ata kanë shkuar në Shkup, z. Dole dhe
3 z. Hill, kanë shkuar në Shkup, një ditë më përpara, për të
4 qenë pjesë e delegacionit të Kosovës për t'i bindur ta
5 nënshkruanin marrëveshjen. Z. Dole thotë që z. Thaçi nuk ka
6 qenë i pranishëm kur po e kërkonte.

7 Dhe thuhet se ju kujtohet ky rast sepse nuk po e gjenin
8 se ku ishte z. Thaçi. Dhe prandaj, Sekretarja e Shtetit
9 Albright, ju thirri ju dhe ju pyeti: "Ku është personi juaj",
10 Thaçi, pra. Dhe Sekretarja e Shtetit, sipas këtij paragrafi,
11 kuptohet, në paragrafin 59, Albright nuk donte që të ndodhnin
12 gabime, prandaj të dërguan ty bashkë me Thaçin në Paris, që të
13 siguroheshe që të nënshkruante sepse ata ishin të shqetësuar.

14 Ju kujtohet ta keni thënë këtë, z. Rubin?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni cili
17 ishte problemi, pse ishin të shqetësuar? Kishin merak se mos i
18 kishte ndodhur diçka z. Thaçi ndërkohë, apo se mos ndryshonte
19 mendje gjatë rrugës për në Paris.

20 PË. Unë e di që Chris Hill nuk ishte shumë miqësor ndaj z.
21 Thaçi. E dija që Chris Hill do jepte disa shpjegime negative
22 për sjelljen e tij. Dhe do të bënte komente pezhorative,
23 negative, për z. Thaçi, tek delegacioni amerikan, te
24 gazetarët, dhe mund t'i bënte këto komente edhe për Senatorin
25 Dole. Pra, qëndrimi nuk do të ishte që, obobo, i shkreti z.

1 Thaçi se është fshehur, por ai tha, "pse nuk është këtu ai kur
2 kemi Senatorin Dole këtu? Pse bën ai sikur është kreu i një
3 shteti, a pse bën sikur është ndonjë person i rëndësishëm".
4 Unë isha në dijeni që Chris Hill kishte një influencë të madhe
5 në këtë situatë dhe unë do përpigësja të thoja që, po, ka
6 arsye pse nuk është këtu, mbase po vjen, mbase ka ngelur diku
7 në bjeshkë, mbase është në rrezik. Unë nuk e di pse nuk është
8 këtu.

9 Ideja ishte që të shkoja në Paris me të, sepse ma kërkoi
10 ajo, dhe më tha që ajo vetë nuk mund të vinte çdo herë, dhe më
11 tha që në qoftë se nuk do të jem unë, të paktën do jesh ti ta
12 inkurajosh të bëjë atë që më premtoi mua se do ta bënte. Se ai
13 mua më ka thënë që nëse japim pak kohë shtesë, mes Rambujesë
14 dhe Parisit, ai do të bënte të pamundurën që të merrte
15 pëlqimin dhe të vinte të nënshkruante. Ky ishte një premtim që
16 ma kishte bërë mua personalisht. Dhe ajo mendoi se mënyra më e
17 mirë për t'u siguruar që do të nënshkruante ishte të shkonte
18 me një person të cilit ia kishte premtuar këtë gjë. Dhe unë
19 shkova, ai ishte gati të nënshkruante, patëm biseda shumë
20 frytdhënëse. U sigurova që të sillej sa më mirë që të ishte e
21 mundur, dhe gjithçka funksionoi shumë mirë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova. Në paragrafin 62,
23 në një përditësim për Kosovën 10 mars 1999, është prova
24 materiale 1D271. Është një përditësim ky nga Byroja Evropiane
25 dhe flitet këtu për një fletarrestim lëshuar nga autoritetet

1 serbe për z. Thaçi. Dhe ju thoni që ju kujtohet që vërtet ka
2 pasur një fletarrestim kundër z. Thaçi, lëshuar prej serbëve.
3 Dhe për këtë arsye ju besoni se z. Thaçi duhet të udhëtonte
4 përmes bjeshkëve dhe prandaj nuk mund të ishte më përpara atje
5 kur ishte Senatori Dole. Dhe jua ka thënë këtë z. Thaçi në
6 Paris, apo jo?

7 PË. Kjo më kujtohet dhe mua. Kjo konfirmonte pikërisht
8 shqetësimin tim. Kur ju thatë që z. Hill do të jepte shpjegime
9 negative për mungesën e z. Thaçi, për ta dhënë imazhin e një
10 personi që nuk ishte i përgjegjshëm, që nuk ishte në
11 dispozicion për z. Dole. Por unë pa e ditur i thashë që mund
12 të ketë një shpjegim legjitim për këtë. Dhe kur morëm vesh
13 shpjegimin, i thashë po ky është shpjegim me vend. Pikërisht,
14 ka kuptim.

15 Më kujtohet që ka pasur një arsye pse ishte aq i
16 kujdesshëm z. Thaçi në udhëtimet e veta.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju e keni parë këtë
18 fletarrestim në mars të 1999 ose më vonë?

19 PË. Jo, për këtë thjesht kam dëgjuar, por e kam besuar që ka
20 ekzistuar.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë në
22 paragrafin 71 e në vijim të deklaratës suaj. Sekretarja e
23 Shtetit Albright, në këtë paragraf, përmendet libri i
24 Sekretares së Shtetit Albright, dhe keni diskutuar tashmë disa
25 prej këtyre pjesëve të librit. Është prova materiale DHT01462

1 deri në DHT01464.

2 Ta formuloj ndryshe, më falni. Do ju bëj një pyetje
3 tjetër përpara. Që gjendet në paragrafin 70, më duket. Ka një
4 lidhje me një memorandum për të cilin kemi biseduar tashmë.
5 Është memorandumi përpara thirrjes telefonike me, që pati
6 Presidenti Bill Clinton me z. Thaçi në qershor 1999.

7 Sipas këtij paragrafi, i keni thënë Mbrojtjes se z. Thaçi
8 e ka kryer këtë thirrje telefonike me Presidentin Clinton dhe
9 është bërë në Prishtinë kjo thirrje telefonike, dhe sistemi
10 s'ka qenë shumë i mirë, linja nuk ka qenë shumë e mirë. Z.
11 Thaçi ka thënë gjërat e duhura, dhe ju thoni se Presidentit
12 Clinton i bëri shumë përshtypje z. Thaçi. Z. Thaçi tha se do
13 të respektonte pakicat, ndonëse ishin keqtrajtuar populli i
14 tij për vite e vite të tëra.

15 Unë dua t'ju pyes për këtë kur thoni "tha gjërat e
16 duhura". Ju thoni që foli për demokracinë, do të respektonin
17 të drejtat e pakicave, për këtë e keni fjalën?

18 PË. Kanë kaluar më shumë se 20 vjet tani, dhe kam dëgjuar nga
19 Sandy Berger që ka qenë Këshilltari për Sigurinë për
20 Presidentin Clinton se nuk fola unë drejtpërdrejt me
21 Presidentin Clinton. Ai më tha që atij i bëri shumë
22 përshtypje, se po fliste me udhëheqësin e UÇK-së në një kohë
23 luftërash. Personat kishin pësuar, kishin parë vrasje të
24 tmerrshme, depërtime, tmerre. Dhe me gjithë këtë, ai tha pa u
25 nxituar, i tha Presidentit Clinton që mesazhi që donte të

1 tregonte botës, sepse kur i thua diçka Presidentit të Shteteve
2 të Bashkuara, kjo është shumë e rëndësishme.

3 Dhe më kujtohet që Presidenti Clinton i tha Sandy Berger
4 që i kishte bërë shumë përshtypje kjo gjë, domethënë kjo
5 pavarësisht dhunës që kishin pësuar. Nuk do të
6 kundërpërgjigjeshin, nuk do të merrnin hak për dhunën që
7 kishte pësuar populli i Kosovës, dhe nuk do të merrnin hak
8 gjatë kohës që trupat serbe po largoheshin dhe ta merrte
9 përsipër situatën NATO. Dhe sigurisht, që mund të kishte akte
10 dhune në këto situata, dhe Presidentit Clinton i bëri shumë
11 përshtypje sjellja e z. Thaçi dhe ia tha z. Berger që ma tha
12 mua më pas.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi para apo pas kësaj
14 telefonate, iu tha ai ju që, në fakt, në të vërtetë kishte
15 probleme me respektimin e të drejtave të pakicave në qershor
16 të 1999 në Kosovë, ose më përpara?

17 PË. Jo, nuk ka thënë ai i pari, ne e kemi thënë të parët. Ai
18 e pranonte që këto janë kohë të vështira për popullin e
19 Kosovës. As nuk e ka mohuar që mund të kishte akte të tilla
20 dhune. Dhe ai është ofruar dhe ka thënë që unë do të përpiqem
21 ta zbeh sa më shumë këtë përmes deklaratave publike, dhe këtë
22 ia tha Presidentit Clinton dhe ma ka thënë përsëritur dhe mua
23 më pas këtë që i ka thënë Presidentit Clinton mbase po atë
24 ditë, ose mbase pak më vonë. Unë jam përpjekur që ai t'i
25 qëndronte asaj që i premtoi Presidentit Clinton.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por, ju ishit i pari që e
2 keni ngritur këtë temë, apo jo?

3 PË. Zakonisht kështu ndodhte. Nuk më kujtohet konkretisht,
4 por zakonisht kështu ndodhte.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi e konfirmoi apo ju
6 tha që në fakt ka probleme me pakicat, sa i takon respektimit
7 të tyre.

8 PË. Nuk ka thënë që nuk ka probleme, dhe që nuk do të ketë
9 probleme asnjëherë. Edhe ai përpiqet dhe ta shpjegonte pse
10 ishte ky problem, pse ekzistonte.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Rubin.
12 Duhet të ndryshoj pak temë dhe dua t'ju bëj një ose dy më
13 shumë pyetje lidhur me këtë që është zbardhur në Shënimin
14 Përgatitor numër 1, më konkretisht. Në paragrafin 4 të këtij
15 shënimi përgatitor.

16 Dhe do i lutesha Sekretares së seancës të nxjerrë provën
17 me numër 1D266. Përndryshe ka numrin DHT5125, DHT05125, nëse
18 nuk e kam gabim. Dhe thjesht për procesverbal shënimi
19 përgatitor ka numrin 1D263. Faleminderit.

20 E shihni, z. Rubin? Sipas paragrafit 4 të Shënimit
21 Përgatitor 1, ju konfirmoni në fakt se e keni parë këtë
22 situatë -- ju thoni që nuk keni qenë në dijeni për lëvizjet e
23 z. Thaçi çdo ditë, kështu që ju nuk e dinit në qoftë se z.
24 Thaçi shkonte në Lubjanë, siç thuhet këtu, në qoftë se nuk e
25 kam gabim -- në paragrafin 4 po lexoj. Por ju thoni sipas

1 këtij shënimi, fakti që z. Thaçi duhej të vizitonte Adem
2 Demaçin në Lubjanë më 19 shkurt 1999, përputhej me
3 botëkuptimin tuaj se z. Demaçi në fakt ishte një nga personat
4 me të cilin duhej të konsultohet z. Thaçi gjatë negociatave të
5 Rambujesë, sepse Demaçi ishte më në favor të pavarësisë së
6 Kosovës dhe ishte një ideolog, dhe kjo ishte një çështje që
7 nuk mund të zgjidhej në Rambuje.

8 Pyetja ime është kjo: A ju kujtohet ta keni thënë?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes, a e dini
11 nëse z. Thaçit i është kërkuar të konsultohet me z. Demaçi,
12 apo ishte më shumë një lëvizje strategjike apo politike për të
13 marrë këshilla politike prej z. Demaçi? Siç thuhet këtu, z.
14 Demaçi ishte, quhej këshilltar politik, konsiderohej si
15 këshilltari politik i UÇK-së. E shihni këtu në paragraf?

16 PË. [Nuk ka përkthim].

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë unë po e përsëris
18 pyetjen se ishte pak e përbërë. Atëherë, a mendoni se z. Thaçi
19 i ishte kërkuar të konsultohet me z. Demaçi apo kishte arsye
20 të tjera?

21 PË. Dua të jem shumë i kujdesshëm, se ju përmendët dhe këtë
22 titull këtu. Ky është një shënim përgatitor përmbledhës që
23 është marrë nga një oficer i situatës në departamentin e
24 shtetit që shkruan çdo gjë sa më shpejt të jetë mundur që ta
25 lexojnë të gjithë dhe që nuk është një ekspert. Do ju

1 inkurajoja të mos i merrni seriozisht këto titujt, se me shumë
2 gjasë është shkruar shpejt e shpejt. Kur është thënë
3 këshilltar politik i UÇK-së personi që e ka shkruar këtë mund
4 të ketë qenë ose jo ekspert i Kosovës, madje mund të mos e
5 ketë ditur fare ku ka qenë Kosova në hartë. Se kur
6 mbështetesh në dokumente si ky që shohim këtu, raporte të
7 situatës, ka pasur shumë gabime gjatë gjithë kohës në raporte
8 të tilla, sidomos titujt. Këtë po ua them se ka dalë dhe gjatë
9 diskutimeve tona.

10 Së dyti. Hashim Thaçi asnjëherë nuk më ka thënë fjalë për
11 fjalë se çfarë duhet të bënte. Apo saktësisht se me cilin
12 duhej të konsultohesh, gjatë periudhës kur më thoshte se duhet
13 të konsultohem. Ai thjesht në atë kohë sapo ishim njohur, sapo
14 e kisha takuar personin. E kisha njohur në Rambuje dhe po e
15 njihja më shumë. Anglisht nuk fliste. Pra, dhe ai po më njihte
16 mua. Sigurisht që nuk ishte shumë i hapur me mua, as unë nuk
17 isha shumë i hapur me atë. Ne thjesht po njihnim njëri-
18 tjetrin.

19 Por më kujtohet shumë që ai nuk më tregonte mua se çfarë
20 duhet të bënte, dhe pse i bënte. Por thjesht, ishte e qartë se
21 ai kishte epror diku, nga të cilët duhet të merrte miratimin.
22 Ai ishte shumë i vagullt në mënyrën se si shprehej, thoshte do
23 konsultohem me komunitetin, me udhëheqësit, me popullin. Ishte
24 shumë i vagullt, i mjegullt në gjuhën që përdorte dhe cilat,
25 ndër të tjera përkthehej.

1 Kështu që, unë nënkuptova që ishte shumë i rëndësishëm
2 Demaçi sepse e dija çfarë qëndrimi kishte Demaçi sepse Demaçi
3 kishte folur ndërkohë me Madeleine Albright dhe ne e dinim që
4 ishte një nga personat që nuk ishte në favor të Rambujesë, në
5 mënyrë që kategorike, jo. Pra, për faktin që duhej të
6 konsultohesh me të, sipas meje ai përpigëj që t'i përfshinte të
7 gjithë në proces. Por unë nuk e di pse e bënte këtë, që ishte
8 dhe pyetja juaj. A ishte e nevojshme, a i kërkohej prej
9 dikujt, unë këtë nuk e di.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Një pyetje
11 lidhur me komentin që sapo bëtë. Z. Thaçi, e thërriste z.
12 Demaçi lider, udhëheqës? E di ka pas një problem përkthimi
13 aty, por a ju kujtohet ta këtë thirrur lider?
14 PË. Nuk më kujtohet, dyshoj. Por fliste për të në një mënyrë
15 që tregonte respekt të jashtëzakonshëm.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E kuptova.

17 Z. Rubin, në transkriptin e sotëm, në faqen 68 [Sipas
18 përkthimit] gjatë kohës që ju bëri pyetje z. Misetic, ju e
19 thirrët Adem Demaçin, nëse e kam të drejtë, një "drejtues
20 ideologjik" edhe një "themelues", por nuk thatë se themelues i
21 çfarë. E kishit fjalën një prej themeluesve të UÇK-së?

22 PË. E tërheq fjalën, nëse mundem. E kam përdorur fjalën e
23 gabuar. Përpigëm të jem sa më i kujdesshëm, por kanë kaluar dy
24 ditë tani dhe nuk jam gjithmonë i suksesshëm në mënyrën se si
25 i formuloj fjalitë e mia, apo i qartë. Unë desha të thoja

1 këtë, kur lëvizjet kanë drejtues ideologjikë, sigurisht që
2 mendojnë që mund të jenë edhe themeluesit e lëvizjes.

3 Unë nuk e njihja konkretisht këtë person, çfarë titulli
4 kishte, as kam folur ndonjëherë, as e kam takuar ndonjëherë.
5 Thjesht e kam perceptuar si një prej themeluesve të hershëm,
6 prandaj kam idenë që e përdora. Por më shumë ideologjik,
7 prandaj thashë dhe "themelues", mbase duhet të kisha thënë
8 thjesht një prej përkrahësve ideologjikë. Mbase "themelues"
9 ishte një fjalë që më erdhi për momentin, por jo zgjedhja e
10 duhur e fjalëve.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Një pyetje
12 tjetër për rolin e Demaçit gjatë bisedimeve për paqen në
13 Rambuje. Dhe në Paris në 1999. Nëse Demaçi, z. Demaçi, ishte
14 vërtet drejtuesi ideologjik apo përkrahësi ideologjik i
15 UÇK-së, e ju thatë që ishte dhe një epror, ishte epror ndaj z.
16 Thaçi, pse nuk folët ju si përfaqësues i shtetit amerikan dhe
17 Sekretarja Albright, pse nuk folët drejtpërdrejt me z. Demaçi
18 por folët me z. Thaçi, që ishte një vartës i tij dhe nuk
19 kishte kompetencat dhe autoritetin për të nënshkruar
20 marrëveshjen?

21 PË. Mendoj që ka pasur një arsye të fortë e cila ishte se ne
22 jemi takuar në Rambuje me delegacionin zyrtar të shqiptarëve
23 të Kosovës. Ata do të ishin personat që do të nënshkruanin
24 marrëveshjen. Z. Thaçi ishte përzgjedhur, zgjedhur prej grupit
25 në Rambuje si personi që do t'i drejtonte, apo pika e

1 kontaktit, ai do të ishte personi që do të nënshkruante.

2 Dhe Madeleine Albright vendosi ta thërriste z. Demaçi në
3 fund të bisedimeve duke menduar që do ta ndihmonte kauzën. Për
4 të njëjtën arsye që sapo thatë ju. Por z. Hill që ishte një
5 prej personave që duhet të na këshillonte lidhur me temën,
6 ishte puna e tij, ai nuk e konsideronte fare z. Thaçi. Ishte
7 shumë i pasjellshëm: Mos e merrni atë person, pse e çoni kohën
8 dëm me të. Nuk donte që Sekretarja të bisedonte fare me këtë
9 person, dhe ua ka thënë shumë personave në fakt këtë, dhe ka
10 bërë një gabim, ka bërë shumë gabim që e thirri në telefon
11 Adem Demaçin. Kështu që, ju tha ai atyre që ka bërë gabim që e
12 mori Adem Demaçin.

13 Ishim në një situatë të vështirë sepse ne donim që të
14 delegacioni në Rambuje thjesht të nënshkruante marrëveshjen.
15 Për z. Thaçi fliste shumë keq një prej negociuesve i cili pati
16 më pas një telefonatë ku Madeleine Albright, e përshkroi si
17 një telefonatë të etur për gjak. Dhe ajo nuk deshi më të
18 bisedonte me të. Prandaj, ajo mendoi që ishte më mirë që unë
19 të bisedoja me z. Thaçi. Z. Thaçi të konsultohet me kë duhej
20 të konsultohet, dhe të vinte dhe të nënshkruante.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Rubin.

22 Tani do ju pyes pak për artikullin e *Financial Times*, të
23 tetorit 2000, ose shtatorit, shtatorit ose tetorit 2000, që
24 është pranuar tani si provë. Artikulli "Si e fituam luftën",
25 është në fakt pranuar vetëm pjesërisht me numrin e provës

1 1D279. Do të doja të filloja me faqen 9 të PDF-së. Nuk është
2 nevoja ta shfaqim në ekran. Pra, dhe njëherë është artikulli
3 juaj i *Financial Times*, ku keni thënë:

4 "... Evropianët i kundërshtuan sulmet ajrore ndaj Serbisë
5 sepse ndonjëherë UÇK-ja ishte përgjegjëse për mosrespektimin e
6 marrëveshjes së paqes së tetorit ..."

7 Një informacion i ngjashëm gjendet dhe në librin tuaj në
8 faqen 7 të PDF-së, e cila përndryshe ka numrin SPOE00229714.
9 Duhet të presim një çast për transkriptin, prandaj po flas
10 ngadalë.

11 Pyetja ime është kjo: A është vërtet kështu? A ju
12 kujtohet që fillimisht evropianët të kenë qenë kundër sulmeve
13 ajrore ndaj Serbisë sepse sipas tyre UÇK-ja nuk kishte
14 respektuar marrëveshjen e tetorit 1999 për paqe?

15 PË. Po, kështu më kujtohet. Do të them diçka më shumë.
16 Marrëveshja e tetorit ishte shumë e vagullt, kishte nevojë për
17 sqarime, që ishte shumë e vështirë ndonjëherë. Ishte situatë e
18 ngjashme si në ditët e para të Bosnjës, në Bosnjë ku palët
19 fajësonin njëra-tjetrën. Prandaj ne deshëm një marrëveshje për
20 paqe të plotë. Nuk deshëm më zgjidhje të përkohshme, të
21 ndërmjetme, që ishin objekt keqinterpretimesh të cilat kishin
22 nevojë për verifikime e për sqarime. Edhe kjo solli një
23 situatë ku të dyja palët fajësonin njëra-tjetrën, ama një prej
24 palëve ishte e pushtetshme, pala tjetër jo dhe aq. Prandaj, me
25 marrëveshjen e Rambujesë, ne eliminuam të gjitha këto

1 paqartësi.

2 Disa persona mendonin që nuk ishte lëvizja e duhur. Por
3 Sekretarja Albright mendonte që ishte lëvizje e duhur dhe
4 Presidenti Clinton mendonte të njëjtën gjë. Ne ua mbushëm
5 mendjen evropianëve që kjo ishte lëvizja më e duhur dhe ju
6 thamë që sigurisht ne do të ndërmarrim një lëvizje dramatike,
7 por njëkohësisht ne do të jemi dhe diplomatë. U thamë të dyja
8 palëve kjo është marrëveshje dhe në rastin e forcave serbe ju
9 thamë në qoftë se nuk e pranoni marrëveshjen, ju do të
10 sulmoheni nga ajri. Ndërsa palës shqiptare u thamë, "pajtohuni
11 me këtë marrëveshje ose nuk do të keni më përkrahjen tonë".

12 Ky është, kjo është shumë dramatike, është një dokument
13 me qindra faqe, i thua, në daç merreni, në daç pranojeni, në
14 daç mos e pranoni, por ama pasojat do të jenë shumë të mëdha.
15 Ne këtë e bëmë për të shmangur të gjitha paqartësitë që kishte
16 marrëveshja e tetorit, sepse në këtë marrëveshje -- vërtet kjo
17 marrëveshje nuk u respektua as prej serbëve, por kishte raste
18 që nuk u respektua as prej UÇK-së.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 13 të artikullit të
20 *Financial Times*, në PDF, thuhet se z. Thaçi e mori Jim
21 O'Brien, e thirri Jim O'Brien, "imazhi kryesor në delegacionin
22 shqiptar në Rambuje", dhe "drejtuesi politik i Rambujesë". Dhe
23 një informacion i ngjashëm mund të gjendet dhe në faqen 11 të
24 librit tuaj, "Si e fituam luftën". SPOE0229718, dhe këtu
25 thuhet:

1 "Kur Albright mbërriti disa ditë më pas, Jim O'Brien i
2 cili për një kohë të gjatë ishte ndihmësi i Albright, dhe një
3 prej negociuesve kyç, i tha që personi kryesor i delegacionit
4 shqiptar për nga pikëpamja e politikanëve, gazetarëve, dhe
5 intelektualëve, ishte Hashim Thaçi, drejtuesi i degës politike
6 të UÇK-së."

7 Z. Rubin, pyetja ime është kjo: A ju kujtohet ta keni
8 shkruar këtë, në artikullin në libër?

9 PË. Po, por më duhet ta shtjelloj pak më tepër këtu. Unë atë
10 libër nuk e kam shkruar vetë unë, thjesht kam shkruar
11 artikullin, dikush e mori atë artikull dhe e bëri një libër,
12 por askush nuk më ka paguar asnjë honorar, asgjë, më është
13 thënë që është libri im, por në fakt nuk është se e kam
14 shkruar unë librin. Unë për vete kam shkruar vetëm artikullin
15 e *Financial Times*, dhe dikush pastaj e ka marrë atë artikull
16 dhe e ka kthyer në libër.

17 Nuk po them që ka gjëra gabim aty, por thjesht dua të
18 them që nuk është libri im, nuk jam unë autori i librit. Dhe
19 po mundohem të jem sa më i qartë, sa më i saktë të jetë e
20 mundur.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është informacion i mirë,
22 Faleminderit. A mund t'ju kërkoj të konfirmoni në qoftë se
23 informacioni që përmban libri dhe gjithashtu dhe informacioni
24 që përmban artikulli që znj. Albright ju drejtua z. Thaçi si
25 figurës kryesore të delegacionit shqiptar, a është ky

1 informacion i saktë?

2 PË. Po. Me sa më kujtohet mua, ky është personi i parë që
3 jemi takuar, me të cilin jemi takuar ne kur kemi mbërritur
4 aty. Madeleine Albright u takua me Chris Hill, sepse Chris
5 Hill na informoi lidhur me zhvillimet, pra me ato çfarë po
6 ndodhin në terren. Ndërkohë që diçka që ishte e re për ne
7 ishte fakti që na u prezantua një person të cilin nuk e kishim
8 dëgjuar, nuk e njihnim, nuk e dinim kush ishte. Dhe ajo e
9 përshkroi në këtë mënyrë këtë person, dhe siç e keni në
10 artikull dhe atë e kam pasqyruar dhe aty dhe jua them dhe sot.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 40 të artikullit që
12 mban numrin 1D277, thuhet që përfaqësuesit e tjerë në Rambuje
13 domethënë përfaqësuesit e Kosovës në Rambuje, nuk merrnin
14 vendim pa z. Thaçi. Një informacion i ngjashëm mund të gjendet
15 dhe në faqen 12 të dokumentit SPOE00229719, të librit "Si e
16 fituam luftën".

17 Shkurtimisht, a mund të na thoni, Dëshmitar, që në qoftë
18 se e keni shkruar këtë informacion në artikullin tuaj dhe në
19 qoftë se ky informacion është i saktë?

20 PË. Po, e kam shkruar dhe është i saktë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ashtu në faqen 15 të
22 artikullit tuaj, ju e përshkruani z. Thaçi si negociatorin
23 kryesor, ose roli i tij ishte qendror, kryesor, sa i takon
24 negociatave. Dhe thoni që ishte person kyç për ju dhe për
25 Madeleine Albright, dhe këtu citoj, thoni ju në fund që:

1 "Në fund fare varej nga Thaçi dhe Thaçi nuk lëshonte pe.
2 Anëtarët e tjerë të UÇK-së na kishin thënë privatisht që ata
3 ishin të përgatitur që të nënshkruanin, por kishin nevojë për
4 miratimin e tij."

5 Ky është fundi i citimit. A ju kujtohet që e keni shkruar
6 këtë në artikullin tuaj, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është informacioni në atë
9 artikull ende sot e kësaj dite i saktë?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 13 -- jo, në fakt
12 është faqja 13 e librit, "Si e fituam ne luftën". Me fjalë të
13 tjera është dokumenti SPOE00229720, thuhet si më poshtë:

14 "Erdhi radha e Thaçit, ai nuk lëshonte pe, dhe anëtarët e
15 tjerë të delegacionit thanë që ishin gati që ta nënshkruanin,
16 por ata vareshin nga Thaçi. Ne e morëm Thaçin që të takohet me
17 Albright në sallën ku hahej dreka, dhe më pas e dërguam në
18 zyrën e improvizuar të z. Thaçi -- të znj. Albright."

19 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar, që z. Thaçi është dërguar
20 që të takohet në zyrën e sajuar ose të improvizuar të znj.
21 Albright, ose në vendin ku ajo hante drekën?

22 PË. Ky është prapë një shembull se si ndryshohen gjërat kur
23 shkruhen, megjithatë mua nuk më kujtohet që të ketë pasur një
24 zyrë ose një vend ku hante drekën znj. Albright, megjithatë më
25 kujtohet që dikush e solli z. Thaçi aty ku ishte znj.

1 Albright.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të vazhdojmë me një
3 pyetje tjetër që ka të bëjë me atë çfarë shkruhet në faqen 15
4 të librit "Si e fituam luftën", që ka numrin SPOE00229722. Në
5 të thuhet:

6 "Siç dukej, Thaçi nuk e kishte dhënë miratimin e vet
7 përfundimtar, dhe pjesa tjetër e delegacionit hezitonte që të
8 jepnin miratimin e tyre aprovimin e Thaçit."

9 A ju kujtohet të ketë ndodhur kjo gjë, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, z. Thaçi nuk e ka
12 dhënë miratimin e vet të fundit, apo aprovimin e vet të
13 fundit, ndërkohë që pjesa tjetër e delegacionit nuk pranonin
14 që të jepnin pëlqimin e tyre pa marrë okej nga z. Thaçi. Është
15 kështu?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ashtu në faqen 15 të
18 librit "Si e fituam luftën", thuhet si më poshtë:

19 "Ai", dhe këtu me "ai", e keni fjalën, flitet për Jim
20 O'Brien, "ai informoi se z. Thaçi kishte pranuar që të lejonte
21 Surroin që të nënshkruante marrëveshjen e përkohshme në emër
22 të delegacionit shqiptar".

23 Pyetja është si më përpara: A ju kujtohet që informacioni
24 i përfshirë në këtë pjesë të librit është i saktë, domethënë a
25 ju kujtohet që z. O'Brien ju ka thënë ju që z. Thaçi kishte

1 pranuar që z. Surroi të nënshkruante marrëveshjen e
2 përkohshme?
3 PË. Dua të them diçka që në libër keqpërfaqësohet ajo që
4 është nënshkruar. Nuk është nënshkruar marrëveshje, por
5 thjesht u dha pëlqimi për nënshkrimin e marrëveshjen në parim.
6 Gjithsesi, kjo duhet të shtyhej deri në 2-3 javë derisa të
7 ndodhte nënshkrimi real. Më kujtohet që znj. Albright më ka
8 thënë që Thaçi pas kësaj bisede e kishte pranuar se z. Surroi
9 të nënshkruante marrëveshje. Bile, jo vetëm kaq, por më
10 kujtohet që i dhashë edhe stilolapsin tim z. Surroi që të
11 nënshkruante.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt ju
13 këtë e quani marrëveshje e ndërmjetme.

14 PË. Në këtë libër, domethënë, në këtë pjesë flitet për
15 përpjekjet për të nënshkruar dhe mund t'ia vini dhe emrin
16 marrëveshje e përkohshme ose e ndërmjetme, por nuk ishte
17 marrëveshja fundore.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se pse z. Thaçi i
19 kërkoi z. Surroi që të nënshkruante këtë dokument, domethënë
20 marrëveshjen e ndërmjetme ose të përkohshme, pse?

21 PË. Nuk e di. Dyshoj që kjo mbase ishte në përputhje me
22 kompromisin në të cilin ne kishim rënë dakord, se ne u pajtuam
23 që ai të nënshkruante marrëveshjen e plotë pasi të
24 konsultohet. Megjithatë, për shkak të presionit në të cilin
25 gjendej ai, dhe për shkak të frikës së krijuar nga presioni i

1 tillë për një të ri, sepse Thaçi ishte një person i ri, ishte
2 shumë i ri në atë kohë. E kishte të gjithë botën mbi kokë.
3 Madeleine Albright i thoshte që: Ti do mbash përgjegjësi për
4 vdekjen e të gjithë njerëzve të tu. Pra, pa diskutim me sa më
5 kujtohet mua në të gjithë eksperiencën time në qeveri, ishte
6 një moment shumë, shumë, i ngarkuar emocional.

7 Ai dëshironte që të siguronte objektivin e paqes përmes
8 marrëveshjes, por ai e dinte që duhej që të bënte diçka për
9 t'iu përgjigjur nevojave të saj, megjithatë nuk donte që të
10 kishte emrin e vet në fund të dokumentit derisa të ishte
11 konsultuar me atë që kishte mbi kokë, me ata që ishin sipër
12 hierarkisë së tij.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por z. Surroi nuk i zgjidhte
14 këto probleme?

15 PË. Z. Surroi ishte gazetar. Pra, nuk e kishte këtë problem,
16 nuk është se kishte një parti politike, ishte goxha më i thyer
17 në moshë se sa z. Thaçi kështu që ishte një zgjedhje e
18 përshtatshme.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 19 të librit, "si e
20 fituam luftën", SPOE00229726, thuhet si më poshtë:

21 "Kur konferenca për paqen rifilloi pas tri javësh,
22 Albright më dërgoi në Paris me udhëzime të qarta, "Shko atje
23 dhe sigurohu që shoku jot Hashim Thaçi kësaj here ta
24 nënshkruajë marrëveshjen". Kësaj here unë mbërrita në Paris i
25 bindur që Thaçi do ta nënshkruante. Dhe kur e ftova për drekë

1 në rezidencën e ambasadorit amerikan në Paris, Thaçi u përpoq
2 që të qetësonte sa më shumë të ishte e mundur rezultatet
3 katastrofike të takimit me Albright".

4 Dhe fjalia e fundit aty thotë që:

5 "Ai menjëherë më tregoi mua që kishte kompetencën ose
6 autoritetin që të nënshkruante në emër të UÇK-së."

7 Pyetja që ju kam bërë ju, Dëshmitar, është kjo: A ju ka
8 thënë me gojën e vet z. Thaçi që kishte autoritetin ose ishte
9 i dhënë leja nga UÇK-ja që të nënshkruante në emër të saj?
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetjet e mia të fundit kanë
12 të bëjnë përsëri me librin "Si e fituam luftën". Më
13 konkretisht dua t'i referohem faqes 19 të këtij libri, për
14 procesverbal. Këtu thuhet:

15 "Në këtë interval, ose në këtë periudhë tre-javore,
16 kishte një ndarje të udhëheqësisë së UÇK-së, përderisa një
17 grup i vogël ekstremistëve insistonin ose këmbëngulnin për
18 pavarësi. Ndërkohë që ata që e kundërshtonin atë u ishte
19 mohuar vendimmarrja në të ardhmen."

20 Z. Rubin, kur ju mori në pyetje Mbrojtja e z. Thaçi, juve
21 thatë, nëse nuk gabohet, që "këta, kishte një grup
22 ekstremistësh, pra këta ekstremistë e kishin, ishin shumë
23 insistues", pra insistonin për pozicionin e tyre. Dhe këtu i
24 referohem faqes 39 të transkriptit në kohë reale të ditës së
25 djeshme.

1 Përsëri, tani dua t'ju pyes, këta personat që ishin në
2 kundërshtim të marrëveshjes, a u mohuan nga vendimmarrja në të
3 ardhmen?

4 PË. Nuk ka qenë kaq shumë specifik, nuk më ka thënë kaq me
5 shumë hollësi sa i takon strukturës organizative të UÇK-së.
6 Edhe një herë dua të them që ky është një vlerësim i imi, një
7 gjykim që unë kam bërë mbi bazën e njohurive që kam pasur. Nuk
8 besoj që z. Thaçi ka qenë ndonjëherë kaq shumë i shkoqur apo
9 kaq specifik lidhur me organizimin e UÇK-së. Por, nuk mendoj
10 që ka qenë fjalia ekzakte, por ka qenë një vlerësim ose gjykim
11 i imi ose të paktën unë kështu e kam kuptuar. Dhe ky ka ardhur
12 ndoshta, ky informacion ka ardhur nga z. Thaçi, por mbase dhe
13 ka ardhur nga burime të tjera. Megjithatë nuk mund t'ju them
14 ekzaktësisht se cili ka qenë burimi i informacionit.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Marrëveshja në fund fare u
16 nënshkrua nga delegacioni shqiptar i Kosovës më 18 mars 1999,
17 nëse nuk gabohem, dhe përderisa z. Demaçi si udhëheqësi
18 ideologjik ishte kundër marrëveshjes sepse ishte pro
19 pavarësisë, dhe për këtë arsye ju e quani atë ekstremist, ky
20 ishte një ndër personat që sikurse ju e thatë, pra, u
21 anashkalua ose nuk u lejohej që të merrte vendime në të
22 ardhmen?

23 PË. Keni parasysh një gjë që formulimi ndonjëherë mund të
24 jetë delikat, dhe unë për vete doja që, ose dëshiroja që ai
25 formulim të ishte i vërtetë, ose të paktën ashtu e besoja

1 situatën.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera, a
3 jeni në dijeni juve në qoftë se ai ka luajtur ndonjë rol pas
4 Rambujesë, ose pas marrëveshjes së Parisit?
5 PË. Faleminderit që ma bëtë pyetjen kështu, se kështu më
6 ndihmoni për t'iu përgjigjur pyetjes. Mendoj që në muajt
7 pasardhës kur kam shpenzuar më tepër kohë në Kosovë, në
8 bjeshkë, për shembull, ose në udhëtimet e mëpasshme, i gjithë
9 informacioni që unë kam marrë sepse ne të gjithë u kthyem
10 përsëri në Rambuje, pra i gjithë informacioni u diskutua,
11 mendoj që dikush më ka thënë, dikush të cilit ia kam dëgjuar
12 fjalën, ose dikush me kompetencë, ose ndoshta më ka thënë
13 diçka Thaçi ose dikush nga ambasada, pra më është thënë ose
14 unë të paktën kam besuar që Adem Demaçi nuk ishte më një
15 lojtar aktiv pas nënshkrimit të marrëveshjes në Rambuje.
16 Domethënë, me anë të tjera është anashkaluar.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
19 Mettraux, keni pyetje?

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës
21 Smith.

22 Mirëdita z. Rubin. Do të vazhdoj t'ju bëj pyetje në të
23 njëjtën linjë, në të njëjtën temë që sapo ju bëri pyetje
24 kolegu im. Ju bënë pyetje lidhur me z. Demaçi, me rolin dhe
25 qëndrimin, pozicionin e tij. Do isha i interesuar që të na

1 shpjegoni pak bazën e kuptimit të rolit që kishte ai.

2 Gjëja e parë që ju besoj e thatë dje, po do t'jua pyes
3 prapë këtë pyetje, a jeni takuar ndonjëherë me z. Demaçi vetë
4 ju, Dëshmitar?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni pasur kontakte
7 personale me të ju vetë, Dëshmitar?

8 PË. Jo, por kur Madeleine Albright ka folur me dikë, mua më
9 dukej sikur po flisja unë me këtë person. Sepse kam qenë shumë
10 i afërt me znj. Albright. Pra, kam qenë shumë afër fizikisht
11 edhe ideologjikisht me të, kështu që znj. Albright më ka
12 përshkruar bisedat që ka pasur me të.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni të ndonjë
14 vendimi të marrë nga z. Demaçi në lidhje me UÇK-në?

15 PË. Jo.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja pasuese është kjo:
17 A jeni në dijeni të ndonjë urdhri që mund të ketë lëshuar z.
18 Demaçi në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, pra që ta ketë
19 nxjerrë për çdokënd? A jeni në dijeni të kësaj?

20 PË. Jo.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni se kush e
22 ka zgjedhur z. Demaçi si përfaqësuesin politik të UÇK-së?

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se cilat detyra
25 ka pasur ai, çfarë detyrash i janë ngarkuar atij në cilësinë e

1 tij si përfaqësues politik i UÇK-së?

2 PË. Jo.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas jush, ky
4 informacion, domethënë është pyetje hipotetike, por ky
5 informacion, a mendoni ju që do të ishte relevant për
6 përcaktimin e pozicionit real të tij brenda UÇK-së? Domethënë,
7 kush e ka emëruar atë dhe kush e ka ngarkuar atë me detyra?

8 PË. Sipas mendimit tim, ai ka pasur rol, ka pasur një rol të
9 madh madje. Edhe prandaj unë do të doja ta quaja këtë si rol
10 ideologjik, jo rol mekanik, jo rol ekzekutiv. Përshtypja që më
11 është krijuar mua nga të gjitha takimet që kam pasur në
12 Kosovë, me kosovarë, me udhëheqës të Kosovës, ka qenë që ky
13 ishte një burrë ideologjikisht i rëndësishëm për shumë vite,
14 kështu që pikëpamjet e tij për pavarësinë, për rrjedhojë,
15 ishin shumë të rëndësishme për njerëzit me të cilët unë kisha
16 komunikime. Por jo në mënyrë mekanike, jo në natyrën që më
17 pyetët ju. Nuk e di, shpresoj t'i kem dhënë përgjigje pyetjes
18 tuaj.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I dhatë përgjigje,
20 pavarësisht që nuk jua formulova mirë pyetjen.

21 Në një strukturë ushtarake siç ishte UÇK-ja, a do ishte
22 me rëndësi të dihej se kush caktonte kë në çfarë pozicioni, në
23 çfarë pozite për të ditur se ku qëndronte hierarkia, kush
24 ishte më lart në hierarki?

25 PË. Po. Në qoftë se do pajtoheshim ne që kishte strukturë

1 ushtarake UÇK-ja, po, por unë këtë e kundërshtoj, nuk mendoj
2 që ka pasur ndonjë strukturë ushtarake UÇK-ja.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Roli dhe pozicioni i z.
4 Demaçi në Rambuje, negociata, ju të gjitha këto tema i cekët.
5 Megjithatë, dua që të na e shtjelloni dhe njëherë.

6 A është e drejtë të sugjerohet që Demaçi ishte kundër çdo
7 marrëveshjeje në Rambuje që nuk do përfundonte në pavarësi? A
8 pajtoheshit ju me këtë?

9 PË. Ishte, u bë shumë e qartë në momentin kur znj. Madeleine
10 Albright foli me të, dhe sigurisht që m'u bë mua dhe iu bë të
11 gjithë të tjerëve e qartë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni të faktit
13 që z. Demaçi në atë kohë mendonte që nënshkrimi i
14 marrëveshjeve të përkohshme ose të ndërmjetme do të ishte një
15 gabim nga ana e UÇK-së?

16 PË. Kjo përshtypje m'u krijua, do të thoja po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë procesit të
18 negociatave, ka pasur tregues se z. Thaçi ka shkuar ose është
19 përpjekur që të shkojë në Slloveni për t'u takuar me z. Demaçi
20 për ta bindur atë për të ndryshuar mendje, ose për të
21 ndryshuar pozicion lidhur me këtë aspekt? A ju kujtohet kjo?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është e drejtë të thuhet
24 që z. Thaçi nuk ia doli që t'i mbushte mendjen z. Demaçi, apo
25 jo?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Megjithatë, z. Thaçi
3 sikurse e dimë të gjithë, pati mundësi që të nënshkruante në
4 fund marrëveshjen në emër të UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me sugjerimin
7 që sa i takon UÇK-së, pikëpamja e z. Thaçi ose qëndrimi i z.
8 Thaçi pati epërsi mbi atë të z. Demaçi? A pajtoheni me mua
9 lidhur me këtë?

10 PË. Po, por dua të bëj një shtjellim, dua të bëj një sqarim
11 këtu. Hashim Thaçi kishte diçka që Adem Demaçi nuk e kishte,
12 që ishte premtimi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga
13 ushtria ushtarake, nga perëndimi, nga bota, nga NATO-ja, pra
14 këtë premtim e kishte vetëm Hashim Thaçi në duar. Që në qoftë
15 se unë nënshkruaj dhe serbët nuk nënshkruajnë, atëherë Shtetet
16 e Bashkuara të Amerikës do të fillojnë fushatën ajrore, do të
17 fillojnë bombardimet kundër Serbisë. Askush nuk e kishte këtë
18 premtim në duart e veta përveç Hashim Thaçit. Bota e dinte
19 këtë gjë, ishte e bërë e qartë përmes artikujve publikë. Ne e
20 kishim bërë këtë angazhim të qartë, ia kishim thënë vetë
21 drejtpërdrejt. Unë vetë ia kam thënë me gojën time, po ashtu
22 Madeleine Albright, po ashtu edhe Wes Clarke.

23 Kështu që ta kesh këtë lloj informacioni në një situatë
24 të tillë opake e të paqartë, e bënte z. Thaçi me pikëpamjet e
25 veta shumë të forta. Pikëpamjet e tij pra bëheshin shumë të

1 forta, pavarësisht faktit që UÇK-ja kishte strukturë ushtarake
2 apo jo. Askush tjetër nuk e kishte atë premtim në dorë përveç
3 tij, dhe kjo i jepte atij fuqi, sipas meje, të paktën.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na keni thënë në mënyrë të
5 përsëritur që ty të kanë thënë që ka pasur tensione brenda
6 UÇK-së, hezitime, në disa shtabe për të nënshkruar marrëveshje
7 dhe kjo shpjegon edhe periudhën midis marrëveshjes së
8 përkohshme dhe marrëveshjes përfundimtare, ku z. Thaçi ju ka
9 thënë ju që do mundohet që të vinte personat përkatës. A e kam
10 kuptuar siç duhet, Dëshmitar?

11 PË. Po, shumë saktë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E keni përsëritur disa
13 herë, por dua ta them edhe një herë tani, që z. Thaçi ju ka
14 dhënë garanci që kur të bëheshin këto konsultime, pra kur të
15 konsultohet me liderët e UÇK-së, atëherë ai do të kishte
16 mundësi që të nënshkruante.

17 PË. Mendoj që janë bërë përpjekje në mirëbesim. Megjithatë,
18 garanci mbase është edhe fjalë me vend.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ashtu ai u angazhua që
20 të tejkalonte pengesat që mund të kishin ekzistuar në atë kohë
21 në mënyrë të tillë që të kishte mundësi që të nënshkruante
22 marrëveshjen, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju tregoj një tjetër
25 dokument që lidhet me këtë periudhë kohore, dhe do të mundohem

1 që ta kem më të qartë se çfarë ka ndodhur kronologjikisht
2 përmes pyetjeve që do t'ju bëj. Do i kërkoja Sekretarisë që të
3 paraqesë në ekran dokumentin DHT05178 deri në DHT05179.

4 Z. Rubin, ju lutem hidhini një sy dokumentit. Do ju jap
5 dy-tre minuta lidhur me këtë, dhe pastaj do ju pyes lidhur me
6 pjesë specifike të tij. Së pari lexoni faqen që keni përpara,
7 më pas do kalojmë te faqja e dytë. Në qoftë se ju duhet që ta
8 kalojmë më poshtë tekstin, na e thoni këtë gjë.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ndërkohë që lexon
10 dëshmitari, dëshiroj të them që ky dokument ka marrë numrin e
11 provës 1D358.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju lutem, kalojeni më poshtë gjatë
13 faqes. Ta shikoj fundin e faqes. Të kalojmë më poshtë. Në
14 rregull, të kalojmë tek faqja tjetër.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju bëj disa pyetje
16 lidhur me këtë faqe, pasi do kalojmë te faqja e dytë.

17 Ju lutem shihni faqen, kolonën në të majtë të dokumentit,
18 nën pikën 1. Drejt pjesës së dytë të paragrafit ku ka një
19 fjali që fillon me emrat "Buja dhe Krasniqi..." e shikoni këtë
20 pjesën, apo jo?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga dokumentet e tjera ne
23 e dimë që bëhet fjalë këtu për Ramë Bujën dhe Jakup Krasniqin,
24 që besoj që ju e njihnit në atë kohë, apo jo?

25 PË. Krasniqin po, ndërkohë që personin tjetër, emrin tjetër

1 nuk më vjen ndër mendje tani.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet që:

3 "Buja dhe Krasniqi kanë konfirmuar që ekzistonte një
4 konflikt i rëndë brenda UÇK-së lidhur me Rambujenë, dhe se
5 antagonistit ose oponentit i tyre kryesor ishte përfaqësuesi
6 politik i UÇK-së, Adem Demaçi. Buja dhe Krasniqi shprehen
7 besimin e tyre të plotë që kundërshtia e Demaçit do të
8 tejkalohet".

9 E shikoni këtë?

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo pasqyron edhe
12 garancitë që anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kishin
13 komunikuar me juve, me përfaqësuesit e Shtetet e Bashkuara të
14 Amerikës që ata do të diskutonin dhe do ta tejkalonin këtë
15 vështirësi me Demaçin, apo jo?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tek faqja e dytë.
18 Ju lutem, lexojeni, z. Rubin. Së pari lexoni, pastaj do ju
19 them se ku duhet të përqendroheni.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund të kalojmë drejt fundit të
21 faqes. Në rregull tani, e lexova.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shkojmë në krye të
23 faqes, te pika 5. Aty jepet një përmbledhje e shkurtër që ka
24 të bëjë me faktin që:

25 "Oficerët e Shtabit të Përgjithshëm ishin të dyshimtë.

1 Vetëm Çeliku, që është Fatmir Limaj, ishte i pranishëm dhe
2 mirëpriti kthimin e delegacionit. (Ramë Buja këshilloi që
3 Shtabi i Përgjithshëm ishte në një takim diku tjetër me
4 përfaqësuesin politik të UÇK-së, Adem Demaçi)."

5 Pastaj u tha që:

6 "Buja kishte komentuar që Shtabi i Përgjithshëm do të
7 takohej atë pasdite me Adem Demaçin. Buja tha që ai, Krasniqi
8 dhe Sulja", që është Azem Sylja, "do të merrnin pjesë po ashtu.
9 I pyetur lidhur me Demaçin, si Krasniqi ashtu dhe Buja thanë
10 prerë se ata, dhe këtu citoj, 'do kujdeseshin për të', dhe do
11 kujdeseshin për kundërshtinë e tij ndaj paketës së Rambujesë
12 dhe qeverisë së përkohshme të propozuar nga Rugova, Qosja dhe
13 Thaçi në shkurt, më 24 shkurt, dhe kjo vështirësi do të
14 tejkalohet".

15 Më tej shkruhet që qeveria e përkohshme synon që të
16 administronte Kosovën pas marrëveshjes së pritshme në Rambuje
17 deri sa të mbaheshin zgjedhjet."

18 A e shikoni këtë, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këto garanci të dhënë nga
21 z. Krasniqi dhe Buja, a ju janë komunikuar juve në atë kohë?
22 Ju janë transmetuar juve në atë kohë?

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur z. Krasniqi dhe Buja
25 kanë përdorur shprehjen e qartë sipas këtij memorandumi që ata

1 do kujdeseshin për të, a e dini ju se ça kanë bërë ata "për
2 t'u kujdesur" për të?

3 PË. Ndërkohë që po bënit pyetjen, shikoj që autori i kësaj
4 kabllograme është Christopher Hill, më duhet të them që ky
5 është një kabllogram tipike që shkruante Christopher Hill, që
6 ishte ambasadori i Maqedonisë, ish-Jugosllavisë, Republikës së
7 Maqedonisë. Pra, përshkrimi që bënte z. Chris për UÇK-në ishte
8 sikur ata të ishin rrugaçë, dhe përdorte fjalë të tilla për
9 t'i përshkruar në këtë lloj forme UÇK-në.

10 Unë kur kam udhëtuar me persona të tjerë, me z. Hill, me
11 personalitete të tjera të larta, kanë dëgjuar formulime të
12 tilla dhe për shembull kam dëgjuar komente që reflektonin siç
13 duhet zhvillimet e UÇK-së, por ndërkohë që Hill, Christopher
14 Hill, përdorte formulimet nga më të papranueshmet e mundshme.

15 Pra, ky është i formulim i zakonshëm, është normal për
16 Hill. Pra, në qoftë se ti lexon këtu që duket sikur ata do ta
17 vrasin atë, domethënë është një gjë që është shumë, shumë, e
18 fortë domethënë në qoftë se do ta lexoni në kabllogram tjetër
19 këtë formulim, të shkruar nga dikush tjetër, ky do ishte një
20 alarm i madh.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju ndaloj këtu, nuk
22 dua që të flasim në qoftë se z. Hill ka bërë formulimin e
23 duhur apo jo. Por dua t'ju pyes në qoftë se e dini apo jo që
24 Shtabi i Përgjithshëm, çfarë ka bërë Shtabi i Përgjithshëm për
25 të siguruar që garancitë e dhëna ndaj jush u respektuan? E kam

1 fjalën domethënë çfarë kanë bërë me z. Demaçi në mënyrë të
2 tillë që të nënshkruajnë marrëveshjen?
3 PË. Nuk e di, unë nuk kam parë asgjë në Kosovë që i përqaste
4 ose i përngjante Shtabit të Përgjithshëm. Nuk ka pas ndonjë
5 shtab për gjeneralët, në kontekstin e Kosovës. Nuk ka pas as
6 gjeneralë. Unë s'kam parë asnjëherë gjeneral. Unë s'kam parë
7 ndonjëherë Shtab të Përgjithshëm ose shtab të gjeneralëve.

8 Domethënë, edhe fakti që është shkruar siç është shkruar,
9 përshtypja që të krijohej për UÇK-në është tërësisht e
10 ndryshme nga përshtypja që kam unë për UÇK-në. Të krijohet
11 përshtypja sikur Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, pra, takohet
12 me përfaqësues politikë në mënyrë të ngjashme siç do
13 takoheshim ne në Amerikë ose në vende të tjera. Domethënë
14 vetëm duke lexuar këtë më krijohet një përshtypje komplet e
15 ndryshme dhe komplet e ndryshme nga ajo çfarë kam unë nga UÇK-
16 ja dhe me aq sa di unë për UÇK-në.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për atë kërkoj që të
18 shfaqet në ekran dokumenti me ERN U017-5901 deri në U017-6091.

19 Që t'ju jap pak kontekst lidhur me këtë që po shohim
20 këtu. Kjo është një libër që përbëhet nga një përmbledhje
21 intervistash, të dhëna nga Ramush Haradinaj, pastaj e kanë
22 bërë libër. Kuptoni?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë tani
25 në faqen 120 të librit, që është 116 e versionit PDF, me ERN

1 U017-6016.

2 Do filloj në krye të faqes. Shikoni aty në qoftë se e
3 lexoni, apo i hidhni një shikim, që paragrafi i parë, z.
4 Haradinaj, thotë që ai nuk është informuar asnjëherë në mënyrë
5 formale për emërimin e Adem Demaçit si përfaqësuesi i
6 përgjithshëm politik i UÇK-së, por që e ka marrur vesh këtë, e
7 ka mësuar këtë në media. E shikoni këtë?

8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, në qoftë se shkojmë,
10 kalojmë pak më poshtë në faqe.

11 Aty z. Haradinaj pyetet nëse është takuar me z. Demaçi në
12 kontekstin e Rambujesë, përgjigjja e tij është, ta lexoj edhe
13 për transkriptin, është si në vijim:

14 "U takova me Adem Demaçin, jam takuar me atë vetëm një
15 herë, dhe kjo ka qenë gjatë konferencës në Rambuje. Jemi
16 takuar në malet e Berishës, në shtabin e Shtabit të
17 Përgjithshëm, në zyrat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.
18 Kemi qenë në një takim pune, mbledhje pune. Nuk pata mundësinë
19 që ta përshëndes. E pashë atë që doli nga mbledhja i
20 nervozuar".

21 E shikoni këtë?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër në
24 vijim.

25 Pastaj pyetet:

1 "A e dinit pse Demaçi ishte kaq i nervozuar?"

2 Dhe z. Haradinaj përgjigjet, siç është shënuar këtu:

3 "Nuk e konsiderova largimin e z. Demaçi nga pozita e tij

4 si gjë të mirë, e mendova që ishte jo e logjikshme që Adem

5 Demaçi si personalitet në emër të UÇK-së të fliste kundër, të

6 bërtiste dhe të kërcënonte personalitete kombëtare dhe

7 ndërkombëtare, dhe pastaj të jepte dorëheqjen sikurse s'kishte

8 ndodhur asgjë. Unë nuk kisha asgjë kundër emërimit të tij, në

9 të cilin s'kam marrë pjesë fare, dhe as nuk kam menduar që do

10 të bëhej, do të binte në këtë gjendje të mjerueshme një ditë.

11 Por, nuk më pëlqeu fakti se një ditë ky person që

12 identifikonte veten me neve, nuk ishte më me neve. Nuk e

13 kuptova pse këto gjëra ndodhën. Komandantët e zonave më

14 kërkuan që të takohesha me të. Desha të takohesha, doja të

15 takohesha me z. Adem Demaçi dhe ta pyes se çfarë mendonte për

16 atë që po ndodhte. Kjo do të thoshte, pra, që do të kërkoja,

17 do ta pyesja për emërimin e tij dhe pse u hoq. Komandanti i

18 Llapit, Rustem Mustafa, Remi, kishte lidhje të ngushta me

19 Demaçin. Bisedova me të lidhur me aktivitetet dhe pozicionin,

20 pozitën e Demaçit, e pyeta Remin që ta ftonte mixhë Ademin që

21 të vinte në një mbledhje me komandantët e zonave edhe t'i

22 diskutonim qëndrimin e tij lidhur me Rambujenë dhe problemet e

23 tjera aktuale. Kur arrita mbledhje, Demaçi po largohej".

24 Pak më poshtë.

25 "E pyeta komandant Remin pse Demaçi u largua në këtë

1 mënyrë.

2 "‘Ai shkëmbeu, bëni fjalë, pati fjalë me Jakup Krasniqin,
3 u bë shumë nervoz dhe u largu’, më tha ai. Demaçi kishte bërë
4 fjalë me disa të tjerë aty. Nuk e di saktësisht me kë. E di që
5 Hashim Thaçi nuk ishte kthyer akoma. Më vonë Remi më tha se
6 Demaçi ishte kritikuar për praktikën e tij të punës, dhe për
7 disa propozime që ai kishte bërë. Mendoj arsyeja pse kishte
8 konsultuar Mahmut Bakallin, apo pse kishte propozuar atë në
9 një grup që donte të krijonte. Ai ishte kritikuar gjithashtu
10 për moskrijimin e një mekanizmi që kishte premtuar të krijonte
11 siç ishte Kuvendi Kombëtar. Demaçi u nervozua dhe u largua nga
12 mbledhja në mënyrë demonstrative”.

13 Tani, a ishit në dijeni të këtyre ngjarjeve që z.

14 Haradinaj përshkruan këtu?

15 PË. Në atë kohë, jo. Kam filluar të kem dyshimet e mia për
16 përshkrimet që jepte z. Haradinaj për ngjarjet kur e kam
17 takuar atë më vonë në Prishtinë, si dikush që i ekzagjeronte
18 pak gjërat, dhe e kam gjykuar si person që nuk ishte i saktë
19 apo bashkëbisedues i besueshëm.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndalemë te kjo pjesë që
21 sapo diskutuam. A e keni ndonjë arsye për të kundërshtuar
22 ndonjë gjë që përmend ai këtu?

23 PË. Po, kur përmend Shtabin e Përgjithshëm pra, nuk është i
24 njëjti vendi ku kam qenë unë. Dhe unë nuk do ta quaja atë
25 Shtab të Përgjithshëm, mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm në

1 një çadër me dy karrige, ta përshkruash atë si zyrë të Shtabit
2 të Përgjithshëm më duket si absurde.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndonjë gjë tjetër në
4 tregimin e tij me të cilën nuk pajtoheni?
5 PË. Edhe kjo që kam probleme me të, gjërat që përshkruan aty,
6 nuk kanë shumë kuptim për mua. I gjithë argumenti që kur
7 thotë: më pëlqente, nuk i pëlqente. Është tregim i gjatë, pra,
8 që në fakt nuk thotë ndonjë gjë konkrete. Këtë është ajo që me
9 të cilën nuk pajtohem. Më jepnin ndonjë informacion në lidhje
10 me arsyen se pse u largua apo jo, dhe jo se i pëlqente apo s'i
11 pëlqente. Këto kanë qenë më shumë diçka thashetheme në një
12 formë jo të saktë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe dimë që pas disa
14 ditësh më vonë, dy ditë më vonë, z. Demaçi dha dorëheqjen, siç
15 u pajtuat edhe ju dje, saktë?

16 PË. Nuk e di pjesëmarrjen e saktë, apo praninë e z. Demaçi.
17 Vetëm kuptova që ai ishte figurë ideologjike. U përpoqa të
18 them këtë disa herë, që nuk kisha dijeni për rolin e tij
19 specifik brenda UÇK-së. Unë kam qenë thjesht në dijeni të se
20 z. Thaçi kishte nevojë të konsultohet me të, dhe e trajtonte
21 atë si person të rëndësishëm në krye të udhëheqjes, pra. Dhe
22 kjo është ajo që përshkrua në Gjykatë, Prokurorit, dhe
23 pyetjeve të Mbrojtjes. Nuk e kam kuptuar kurrë rolin e tij të
24 saktë. Kjo është arsyeja për të cilën diskutuam edhe fjalën
25 themelues me kolegun tim kur më bëri pyetjen. Pra ishte figurë

1 e rëndësishme, por nuk e di lëvizjen dhe rolin e tij të saktë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime ishte pak më
3 ndryshe. Pak pas takimit, sipas Haradinajt, siç e përshkruan
4 ai, Demaçi u largua nga UÇK-ja. Është e saktë?
5 PË. Nuk e di.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjëja e fundit që desha
7 t'ju tregoj është, dhe do të kërkoj që të shfaqet në ekran për
8 të trajtuar këtë temë, është dokumenti SPOE00131824 deri në
9 SPOE00131857.

10 Dhe që t'ju japim pak kontekst, z. Rubin, ky është libër
11 memuar, pra, i shkruar në të njëjtin mënyrë si libri që pamë
12 më parë. Ky është libër i shkruar nga Rexhep Selimi. Dhe më
13 duket që e thatë që e dini që kush është Rexhep Selimi?

14 PË. Vetëm me fjalë apo kam dëgjuar si emër, nuk besoj ta kem
15 takuar, apo të kem ndërvepruar me të. Thjesht di emrin.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen
17 280 të librit, me numrin ERN SPOE00131856. Faleminderit, kjo
18 është faqja.

19 Tani do t'ju kërkoja të shkonit pikën e parë, të zezë, të
20 paragrafit, z. Rubin. Ku thotë:

21 "Divorci përfundimtar i UÇK-së me Demaçin ..."

22 E shihni këtë?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua lexoj, për
25 nevojat e transkriptit:

1 "Divorci përfundimtar i UÇK-së me Demaçin ndodhi në malet
2 e Berishës, apo jo? Delegacioni u kthye nga Rambuje të enjten,
3 ndërsa Demaçi u takua me Shtabin e Përgjithshëm të shtunën. Si
4 u zhvillu kjo mbledhje?"

5 Dhe përgjigjja e shënuar këtu e z. Selimi është si më
6 poshtë:

7 "- Demaçi u largua nga mbledhja e Shtabit të
8 Përgjithshëm. Ai këmbënguli që marrëveshja të mos nënshkruhej
9 fare, dhe u përpoq të përdorte influencën, ndikimin e tij mbi
10 komandantët e zonave, por komandantët e zonave e injoruan atë,
11 nuk ia vunë veshin. Pra, dhe heshtja e tij që prej kësaj kohe,
12 tregon zhgënjimin e tij, dështimin e tij. Heshtja e tij,
13 largimi nga angazhimi i tij në proceset e ndryshme, ka qenë i
14 pajustificuar dhe ka lënë një boshllëk në jetën e tij që
15 përndryshe ishte shumë e frytshme dhe simboli i rezistencës
16 kombëtare."

17 Pra, duke -- po supozojmë që këto që janë shënuar këtu,
18 që thuhet t'i ketë thënë z. Selimi dhe që janë të sakta, a
19 pajtoheni që z. Demaçi dështoi të sigurate mbështetjen e
20 komandantëve të zonave lidhur me kundërshtimet që kishte ai
21 për nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe me sa duket, e vetmja
24 figurë në këtë fazë të paktën, që kundërshtonte Rambujenë,
25 ishte Demaçi, apo jo?

1 PË. Nuk e di. E di vetëm këtë që po lexon këtu. Nuk e di a ka
2 patur të tjera.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe siç e pamë pak më
4 parë, Shtabi i Përgjithshëm ishte në gjendje që të linte
5 mënjane kundërshtimet e z. Demaçi dhe të nënshkruante?

6 PË. Edhe kam problem me emrin Shtabi i Përgjithshëm, edhe
7 njëherë, por ky person në veçanti që ka shkruar këtë, nuk
8 duket shumë i besueshëm. Ai dyshonte që:

9 "... NATO-ja do të ndërhynte, ai thotë që ishte
10 konceptuale që NATO-ja mund të ndërhynte. Nuk u besoja atyre,
11 nuk e besoja atyre".

12 Më duket kjo shumë interesante, sepse ne jemi përpjekur,
13 unë jam përpjekur të lexoj dhe të kuptoj kush ishte ky person
14 dhe këto dy paragrafë janë thjesht të gabuara.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dini që ky person në
16 veçanti, ky person për të cilin po flasim, siç e quajti edhe
17 ju, ishte vetë pjesëtar, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm në
18 atë kohë. A mendoni që ai duhet të dinte, a ishte në gjendje
19 të dinte nëse Shtabi i Përgjithshëm mund të ketë ekzistuar apo
20 jo në atë kohë?

21 PË. Mendoj që ai nuk ka qenë i informuar për situatën,
22 gjendjen në botë, situatën që ishte në botë, për të cilën z.
23 Thaçi ishte informuar në Rambuje, se NATO-ja do të ndërhynte
24 përmes fushatës ajrore dhe ai tregon që nuk e ka kuptuar se si
25 funksiononte NATO-ja dhe Perëndimi që ishin të përgatitur, dhe

1 dy paragrafë më poshtë ai dyshon që kjo do të ndodhte. Ai e
2 pranon që nuk do ta bënte këtë kaq shpejt. Po flas nga
3 pikëpamja profesionale, pra është konceptuale, sepse NATO-ja
4 mund t'i jepte Serbisë një shans tjetër. Pra, ai po dyshon që
5 kjo do të ndodhte.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mendoni që e dini më
7 mirë se ai?

8 PË. Nuk mendoj që e di më mirë, nuk mendoj që personat nga
9 jashtë e kanë kuptuar këtë vend më mirë, shumë mirë fare. Por
10 mendoj që unë kam parë memuare të shkruar, njerëz që i kanë
11 shkruar ato për veten e tyre. Nuk i shkruajnë ato nga një
12 pikëpamje objektive. Unë kisha, nuk ia kisha idenë kush ishin
13 këta njerëz. Kisha qëllimin tim, që ishte qëllimi i Madeleine
14 Albright. Dhe unë po kërkoja që, po e shikoja këtë si një
15 person nga jashtë, kush bënte çfarë, kush ishte i përfshirë
16 dhe këto janë personat që vendosnin veten e tyre në njërën
17 organizatë, duke shkruar libra pastaj që janë, i bëjnë ata të
18 rëndësishëm, kush është i rëndësishëm, kush ka përgjegjësi,
19 kush nuk ka. E kam parë këtë që të ndodhë edhe në qeverinë e
20 Shtetet e Bashkuara, e kam parë që ndodh në shumë organizata
21 dhe kam tendencë që të kem dyshime në këto.

22 Por në vendimmarrjen e UÇK-së unë isha një vëzhgues nga
23 jashtë dhe s'kisha asnjë interes të veçantë, asnjë palë, as
24 njëri tjetër. Dhe tani po lexoj versione të ndryshme të
25 njerëzve që kanë pikëpamje të ndryshme për mënyrën se si e

1 përshkruajnë realitetin, pra po përpigem t'ju ofroj si provë,
2 si dikush që ishte nga jashtë, që nuk kishte pra, nuk mernte
3 anën e njërës palë apo tjetrës, sa i takon UÇK-së

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nëse është e
5 nevojshme do t'ju kthehem deklarates tuaj, z. Rubin, por me
6 sa e kuptoj unë, z. Thaçi ishte i vetmi person që ishte në
7 gjendje të nënshkruante marrëveshjen e Rambujesë, pasi ishte
8 dhënë miratimi nga Shtabi i Përgjithshëm dhe siç, apo siç
9 përshkruhej si Shtabi i Përgjithshëm për këtë qëllim. Me fjalë
10 të tjera, mbasi kishte marrë pëlqimin e Shtabit të
11 Përgjithshëm, ai ishte pastaj në gjendje të nënshkruante
12 marrëveshjen.

13 PË. Me sa e kam kuptu unë, kjo është e pasaktë, i nderuar,
14 sepse ne nuk e kemi kuptuar kurrë se ai asnjëherë, që ai
15 raportonte ndonjë shtabi të përgjithshëm, ai nuk e ka
16 përshkruar asnjëherë veten sikur i raportonte Shtabit të
17 Përgjithshëm, apo nuk i kemi vëzhguar komandantët e zonave në
18 vendet ku fshiheshin ata, nuk kam vëzhguar ekzistencën, nuk e
19 kam parë ekzistencën e Shtabit të Përgjithshëm. Ajo që dija
20 nga z. Thaçi ishte që ai duhej të konsultohet me udhëheqjen e
21 komunitetit, me udhëheqësit politikë, me udhëheqës ushtarakë,
22 jo me Shtabin e Përgjithshëm. Dhe mendoj që fjala Shtabi i
23 Përgjithshëm është keq -- të çon në lajthitje nga përvoja ime
24 në terren me UÇK-në.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shfaqim në ekran

1 dokumentin DHT05010, ju lutem.

2 Do marrim pesë minuta pushim.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
5 dhjetë minuta pushim. Pushim deri në orën 16.00. Seanca
6 ndërpritet.

7 --- Pauza fillon në orën 15.49

8 --- Seanca rifillon në orën 15.59

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
10 silleni dëshmitarin.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
13 vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux, Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: Faleminderit.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, z.
16 Rubin, që nuk ua dhashë pushimin kur duhet t'ua jepja.

17 I lutem Sekretarisë në ekran materialin DHT05010, i cili
18 tashmë ka marrë numrin e provës materiale, si provë e
19 Mbrojtjes, me numrin 1D3100 [Sipas përkthimit].

20 Pra, po ju tregoj vetëm faqen e parë, z. Rubin, që të
21 kuptoni kontekstin.

22 I lutem Sekretarisë të shkojë në faqen e 9-të më duket,
23 në PDF, me ERN DHT05018.

24 Siç mund ta shihni është një përmbledhje e raporteve të
25 ndryshme për periudhën në fjalë.

1 Shkojmë pak më poshtë, ju lutem.

2 Fokusohuni në paragrafin që fillon me fjalët "Sekretari i
3 Shtetit të SHBA-së, James Rubin ..."

4 PË. S'kam qenë Sekretar i Shtetit, në fakt.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ja, ky artikull ju
6 ngriti në detyrë. E shihni paragrafin?

7 PË. E shoh, e shoh.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thuhet kështu:

9 "Sekretari i Shtetit James Rubin tha dje: '[Ambasadori i
10 SHBA-së, Christopher Hill] i ka raportuar Sekretares si në
11 vijim: se UÇK-ja, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare
12 të Kosovës i ka kërkuar atij t'i thotë Sekretares Albright se
13 e kanë miratuar marrëveshjen siç është negociuar në Rambuje
14 dhe se kanë autorizuar nënshkrimin e saj."

15 E shihni këtë?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet ta keni bërë
18 një deklaratë, mbase jo në cilësinë e Sekretarit të Shtetit?

19 PË. Më kujtohet që kemi marrë sinjalizime përpara Parisit, do
20 ta nënshkruanin, kështu që po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një deklaratë këtu nga
22 vetë z. Thaçi. S'po ua tregoj videon, vetëm nëse doni do t'ua
23 tregoj, po është një pjesë e një interviste që ka dhënë z.
24 Thaçi.

25 Është me numër 0697758 dhe do fillojmë -- 07-TR-ET, do

1 shikojmë faqen e parë fillimisht ku sipas kësaj z. Thaçi
2 thotë:

3 "Qëndrimi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së do të jetë
4 qëndrimi i pëlqimeve apo opinioneve në Kosovë."

5 A përputhet kjo me deklaratën që -- apo me atë që ju ka
6 thënë konkretisht ju z. Thaçi drejtpërdrejt, z. Rubin.

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin
9 nga ekrani.

10 Shkurtimisht ju diskutuat me z. Misetic dhe një temë për
11 të cilën dua të flasim sërish sot në mënyrë që të sigurohem që
12 e kam kuptuar siç duhet, sepse është diçka që e keni thënë dhe
13 në seancën përgatitore të 8 shtatorit 2025. Do kërkoj të
14 vendoset në ekran shënimi përgatitor, ju lutem. Është me numër
15 DHT12025.

16 Për procesverbal, diskutimi i djeshëm ka qenë në faqen 44
17 të vijim të transkriptit.

18 Ky është transkripti i takimit tuaj me Mbrojtjen, z.
19 Rubin.

20 Shikojmë në faqen 2. Fokusohu në paragrafin 5. Lexojeni
21 shpejt e shpejt, ju lutem.

22 PË. E pashë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj siç duhet unë që
24 më 19 qershor 1999, që është dy ditë përpara nënshkrimit të
25 marrëveshjes së demilitarizimit, ju e dinit se z. Thaçi do të

1 nënshkruante, do ta nënshkruante?

2 PË. Po, nëse do të nënshkruhej, po. Po ne kështu e kuptuam që
3 ai do ishte personi që do ta nënshkruante nëse do të
4 nënshkruhej kjo marrëveshje.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka një pjesë tjetër në
6 deklaratën tuaj që dua ta diskutojmë edhe ka marrë numrin e
7 provës 1D262. Do ta lexoj unë. Është paragrafi 34 i deklaratës
8 suaj të nënshkruar. Ku thuhet, sipas kësaj:

9 "Nuk" -- ju është bërë pyetje, z. Rubin, për nënshkrimin
10 e z. Thaçi në marrëveshjen e demilitarizimit apo përshkrimin e
11 pozicionit të tij. Dhe sipas saj ju keni thënë kështu:

12 "Nuk e di pse tek pjesa e nënshkrimit ishte vendosur
13 poshtë Thaçit, 'Kryekomandant i UÇK-së'. Besoj se po
14 përpiqeshin të tregonin që ishin të besueshëm nga pikëpamja
15 demokratike. Një prej tyre ishte dhe kontrolli civil i
16 ushtrisë."

17 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, dhe a i qëndroni kësaj?

18 PË. Kam thënë kështu me sa kujtoj unë. Tani që më kujtohet,
19 ose duke u përpjekur ta mendoj këtë, unë mund t'ju them
20 fillimisht që unë nuk e di fare se ka qenë kjo tek nënshkrimi,
21 ky titull te nënshkrimi. Tani unë nuk e di pse ka ndodhur, po
22 duke e menduar në retrospektivë, kjo ishte -- dokumenti ishte
23 përgatitur për t'u nënshkruar prej një personi tjetër. Se ka
24 qenë një dokument që përpara se të vija dhe unë dhe Hashim
25 Thaçi atje, që ishte përgatitur për dikë tjetër.

1 Kur po afrohej procesi i përfundimit britanikët dhe NATO,
2 thanë që "Jo, jo, duhet ta firmosi z. Thaçi këtë". Dhe ne
3 lexuam dhe rregulluam disa nga pjesët e dokumentit.

4 Unë ma merr mendja -- ma merr mendja që këtë do ta
5 nënshkruante Agim Çeku, se më pyetët -- më pyetët nëse më
6 kujtohet a e kam thënë. Dhe më pyetët a i qëndroj ende.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetjen e kam më të
8 thjeshtë se kaq. Nuk dua të hamendësoni fare, z. Rubin, në
9 këtë moment. Unë thjesht po ju pyes nëse deklarata që ju
10 lexova ishte bërë prej jush, nëse i qëndroni.

11 PË. Prandaj dhe unë po përgjigjem se nuk mund të them që i
12 qëndroj. Nuk dua t'i qëndroj fjalë për fjalë asaj që kam
13 thënë, se tani duke e menduar sërish unë mendoj që ose kanë
14 dashur të tregojnë që ata kanë -- janë të besueshëm dhe e kanë
15 në kontroll dhe aspektin ushtarak, edhe sigurisht që z. Thaçi
16 ishte civil, me veshje civile sa herë e kam takuar unë.

17 Po kur e mendoj tamam-tamam dhe kur më thoni ju a i
18 qëndroj, duke e menduar tamam këtë gjë, dhe nëse do
19 thellohesha më tej, unë do ju thoja, nuk e di, por mua ma merr
20 mendja se ky dokument nuk ishte përgatitur për z. Thaçi, por
21 ishte përgatitur për z. Çeku, por në momentin e fundit kur u
22 mor vesh që do të nënshkruante z. Thaçi, nuk ndryshuan
23 titullin e personit aty. Mund të jetë gabim ortografik në
24 dokument.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. I qëndrojmë

1 hamendësimit tuaj të parë, siç thatë ju, për kontrollin nga
2 ana e civilëve. A nuk do të -- a pajtoheni me mua që nëse doni
3 të verifikoni ju nëse pjesa ushtarake e UÇK-së ishte në
4 kontrollin e civilëve, ju do të duhet të hulumtoni më shumë
5 për të parë si funksiononte, çfarë takimesh kishin, çfarë
6 procesverbal kishin. Pra, nëse ju do kishit dashur ta
7 verifikoni këtë element, a nuk do të bënit hulumtime të
8 mëtejshme? Pajtoheni me mua?

9 PË. Jo, nuk pajtohem, zotëri. Këtu bëhet fjalë për një grup
10 që as ka qeverisur ndonjëherë, që nuk është as shtet, që nuk
11 është as ushtri, që nuk ka as strukturë ushtarake të cilët po
12 përpiqen t'i bëjnë thirrje perëndimit dhe përpiqen të tregojnë
13 që kanë vlera perëndimore dhe kanë thënë shumë gjëra që donin
14 që t'i dëgjonin drejtuesit perëndimorë. Thanë që ne duam të
15 jemi tolerantë, ne nuk do marrim hak, ne kemi vlera
16 demokratike, kështu e kam kuptuar unë mënyrën sesi janë
17 shprehur ata. Nëse i kanë zbatuar apo jo këto vlera, kjo u duk
18 më pas në kohë.

19 Po nuk mendoj se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, që sipas
20 meje nuk ekzistonte fare, e as struktura e UÇK-së, unë nuk e
21 kam kuptuar sesa kaotike ishte në fakt. Unë nuk doja të
22 verifikoja asgjë sepse unë e kuptoja dëshirën e tyre për të
23 komunikuar me ne. Nuk ishte domosdoshmërisht e vërtetë ajo që
24 thoni. Ishte thjesht një aspiratë. Nuk bëra asnjë verifikim,
25 sepse unë mendoja se ishte e përshtatshme në atë kohë. Unë po

1 ju shpjegoj pse ekzistonte kjo anomali.

2 Sipas meje asokohe ka qenë thjesht një anomali.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas jush, ose më saktë,
4 a e dini kush e emëroi Agim Çekun si shef të Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së?

6 PË. Jo.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju se kujt i
8 raportonte Agim Çeku asokohe?

9 PË. Unë di që Gjenerali Reith, kontakti im, në mënyrë të
10 vazhdueshme i drejtohej atij si komandant i UÇK-së, dhe ai
11 trajtohej si komandant. Dhe një herë, meqë unë asnjëherë nuk e
12 kam konsideruar UÇK-në si strukturë të mirëfilltë, ishin një
13 organizatë e re, në fakt s'kishin strukturë, por personi që i
14 njihte më mirë dhe që kishte punuar më gjatë me ta, më tha
15 thua që komandant është Çeku. Ai është komandanti, ai i
16 drejtohej atij si komandant.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se kujt i
18 raportonte z. Çeku asokohe.

19 PË. Zotëri, besoj se ua thashë që nuk e di këtë gjë. Po ju
20 shpjegoja çfarë dija ndërkohë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju nuk dini, për
22 shembull, që ai t'i raportonte të ashtuquajturës Qeveri të
23 Përkohshme apo ndonjë ministri të asaj qeverie?

24 PË. Qeveria e Përkohshme ishte thjesht një aspiratë, jo një
25 realitet. Nuk ka ekzistuar Qeveria e Përkohshme. Thanë që

1 donin ta krijonin një të tillë, dhe në atë kohë ata kishin
2 sulme të vazhdueshme, ishin të shpërndarë në gjithë
3 territorin. Nuk kishte një vend fizik ku të ishte qeveria,
4 ishin të gjithë në pjesë të ndryshme të territorit. Nuk mund
5 t'i thuash që ishin qeveri e përkohshme, kështu që unë nuk
6 mendoj që Gjeneral Çeku, jo z. Çeku, po Gjeneral Çeku nuk
7 mendoj që i raportonte Qeverisë së Përkohshme që ishte në të
8 vërtetë aspiratë dhe jo realitet.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
10 me ERN, 123 -- 10, më falni, 3211-05-TR-ET. Edhe do të shohim
11 një video, në fakt, që e ka Zyra Administrative -- e ka
12 Sekretaria. Është videoja me numër 4228. Në qoftë se nuk
13 mundeni të shfaqni videon, ju lutem të shfaqni të shfaqni
14 transkriptin.

15 Ju lutem, ta shohim videon tek minuta 01:31, për të
16 kuptuar kontekstin.

17 Por ju, z. Rubin, duhet të fokusoheni tek pjesa, minuta
18 01:31, ju lutem.

19 Kemi dhe transkriptin në fakt, ju lutem të shkojmë më
20 poshtë në mënyrë që ta kemi të qartë.

21 [Luhet videoincizimi]

22 AGIM ÇEKU: "Djegje të disa shtëpive dhe atyre pa shtëpi
23 që kanë mbetur në fshatra, tanimë kjo është dukuri e pritur
24 dhe e njohur nga [E pakuptueshme]. Qeveria e Përkohshme e
25 Kosovës e ka shpallur" --

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Patëm ndërhyrje, patëm
2 ndërhyrje.

3 DËSHMITARI: Unë mund ta lexoj në qoftë se është nevoja.

4 [Luhet videoincizimi]

5 INTERVISTUESI: "Në të kundërtën si duhet të veprojë UÇK-
6 ja?

7 AGIM ÇEKU: "Çdo vendim i tillë i Qeverisë së Përkohshme
8 të Kosovës është urdhër për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,
9 prandaj ne si Shtab i Përgjithshëm i kemi urdhëruar dhe
10 udhëzuar të gjitha forcat tona që të vetëpërmbahen nga
11 veprimet ofensive [E pakuptueshme] dhe që të mos i sulmojnë
12 forcat serbe gjatë tërheqjes, kështu është edhe duke u ndodhur
13 dhe do të ndodhë në të ardhmen, duke [E pakuptueshme] duke e
14 ruajtur të drejtën për vetëmbrojtje dhe mbrojtje të popullatës
15 civile në rast sulmi apo provokimi."

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, mjafton.

17 E dëgjuat z. Çeku kur foli për Shtabin e Përgjithshëm?
18 PË. Po.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dëgjuat kur tha se çdo
20 vendim i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës do të konsiderohej
21 urdhër për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. A e dëgjuat këtë?
22 PË. E dëgjova këtë, por për mua kjo ishte thjesht propagandë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ndërkohë që ai po
24 flet me anëtarë të lartë me grada të UÇK-së, sipas jush, z.
25 Çeku, thjesht po bën propagandë?

1 PË. Jo, ai po flet publikisht, kjo është një intervistë. Kjo
2 është një intervistë. Unë e vlerësoj këtë si një deklaratë
3 publike. Dhe kam shpesh përfaqësues të UÇK-së nga komunikata
4 të ndryshme që veprojnë -- që silleshin sikur të kishte ndonjë
5 qeveri të përkohshme dhe unë ua shpjegova palëve. Nuk ka pasur
6 qeveri të përkohshme, ne nuk takoheshim me qeveri të
7 përkohshme. Nuk mund të kishte qeveri të përkohshme kur nuk
8 kishte shtet që nuk kishte kontroll në territorin e vet. Nuk
9 mund të kishte qeveri në këtë kontekst.

10 Aspironin të kishin një qeveri të përkohshme, po ai po
11 përshkruan atë që do të dëgjojë bota, që "Ne jemi një shtet
12 ushtarak dhe ne i raportojmë në qeverie civile", sepse
13 pikërisht kështu komunikohen vlerat demokratike, prandaj dhe
14 spekulova unë më përpara që ai ishte "kryekomandanti". Ata i
15 tregonin botës që "ne kemi vlera demokratike, ne jemi
16 komandantë", pra, z. Çeku, Gjeneral Çeku - më falni - i
17 raporton një autoriteti civil. Pikërisht këtë donte një grup
18 si UÇK-ja t'i tregonte publikut që publiku të besonte që
19 kështu funksionojnë gjërat, por, nga ajo që kam parë unë me
20 sytë e mi, nuk ka pasur qeveri të përkohshme, as nuk do ta
21 njihnim një qeveri të tillë. Nuk ka ekzistuar pra. Thjesht
22 kishin disa njerëz që luftonin për jetën e tyre në mes të një
23 lufte, në zona lufte.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po bëj një përmbledhje dhe
25 mund t'i përgjigjeni me po ose me jo. Sipas jush, nuk ka pasur

1 Shtab të Përgjithshëm, as Qeveri të Përkohshme të Kosovës që
2 të flitej me të dhe anëtarët e tyre, anëtarët e kësaj qeverie
3 pretendonin sikur ishin anëtarë të një qeverie që nuk
4 ekzistonte.

5 PË. Jo, nuk e thashë kështu tamam. Më vjen keq në qoftë se
6 kam dhënë këtë përshtypje. Nuk kam synuar të jap këtë
7 përshtypje. Unë thjesht, u thashë, i nderuar Gjykatës, që në
8 një situatë lufte ku e kam parë vetë, kur je atje në terren,
9 ku merr pjesë në negociata kaq të rëndësishme me një grup
10 personash që po përpiqen të fitojnë lirinë e tyre dhe
11 sigurisht që përpiqen të përcjellin një imazh, të tregojnë që
12 janë një organizatë ushtarake në mënyrë që të marrin armë prej
13 jush, nëse nuk do të ishin një organizim i duhur, apo nëse nuk
14 do të kishim organizimin ushtarak nuk do të merrnin dot armë
15 prej perëndimit.

16 Prandaj këtë po përpiqesha të thoja unë. Ata bënin,
17 shtireshin sikur ishin më të organizuar se ç'ishin në realitet
18 dhe përpiqeshin t'i komunikonin aktorëve perëndimore dhe të
19 tjerëve se në fakt ata po operonin në bazë të parive
20 demokratike dhe se kishin kontroll si civilë. Unë nuk u
21 përpoqa në asnjë mënyrë të ul rolin e tyre apo të zbeh rolin e
22 tyre. Unë thjesht thashë, ata aspironin, ata ishin një grup që
23 luftonin për lirinë e tyre, që nuk kishin pasur asnjëherë
24 qeveri, që gjithmonë kanë qenë të shtypur, që nuk kanë pasur
25 asnjëherë mundësinë të qeverisin.

1 Pra, kur përshkruanin, pra, ata thjesht bënë një
2 përshkrim dhe ekzagjeronin gjëra të caktuara në mënyrë që t'i
3 besonim. Dhe unë do kisha bërë të njëjtën gjë në situatën e
4 tyre. Por, unë si i jashtëm duhet të bëja dallimin e asaj që
5 shihja me sytë e mi dhe asaj që donin ata që të besoja unë, në
6 mënyrë që ata të merrnin atë që donin. Armë, konkretisht. Nuk
7 ishte e mundur, ne nuk mund t'ua jepnin këtë për arsyet që i
8 përmenda më herët sepse nuk kishin strukturë të organizuar,
9 nuk kishin komandën dhe kontrollin. Kishin aspirata, thonin që
10 kontrollojmë, kemi kontroll të situatës, ishin thjesht
11 aspirata.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim për temën e
13 fundit edhe do t'ju bëj disa pyetje që mund t'u përgjigjeni
14 shkurt. Kjo ka të bëjë në lidhje me -- kjo ka të bëjë me
15 thirrjet telefonike që keni organizuar për z. Thaçi ose
16 thirrjen telefonike mes z. Thaçi dhe Presidentit Clinton.

17 A e kam kuptuar unë drejt që kjo thirrje telefonike, kjo
18 telefonatë që organizuat ju ishte në një formë shpërblimi, një
19 lloj shpërblimi, ose mund të gjeni një fjalë më të mirë, që ju
20 ja dhatë z. Thaçi në këmbim të fjalës së tij që mbajti për të
21 nënshkruar marrëveshjen e demilitarizimit?

22 PË. Po dhe jo. Unë e di që mund ta organizoja këtë thirrje
23 telefonike. Unë e kisha organizuar paraprakisht, në fakt,
24 thirrjen telefonike. E pyeta nëse do të ishte i disponueshëm
25 Presidenti dhe duhej të vendosja në atë moment a ta autorizoja

1 apo jo këtë thirrje telefonike. Kur e pashë që ishte momenti i
2 përshtatshëm për ta bërë këtë, do ishte një incentivë, stimul
3 i rëndësishëm, atëherë mua mu duk edhe momenti më i
4 përshtatshëm të përdorja kartën e fundit që kisha në duart e
5 mia, thirrja telefonike me Presidentin e Shteteve të
6 Bashkuara.

7 E vërteta është që mund ta kisha bërë sidoqoftë. Mund ta
8 kisha bërë pas nënshkrimit, jo para nënshkrimit. A mbase e bëra
9 pas nënshkrimit. Mund ta kisha bërë dhe pa pasur ndryshime. E
10 kisha këtë opsion -- ama e kisha këtë opsion.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë telefonatë Presidenti
12 Clinton e pati vetëm me z. Thaçi në këtë rast, apo jo?
13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo me z. Çeku.
15 PË. E pati me personin që nënshkroi marrëveshjen, po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet në çfarë
17 cilësie po fliste Presidenti Clinton me z. Thaçi? A ju
18 kujtohet se cilësie?

19 PË. Si udhëheqës.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Presidenti Clinton në fund
21 të telefonatës thotë që e adhuronte -- e adhuronte udhëheqjen
22 z. Thaçi. Ju kujtohet?

23 PË. Po. Kjo ishte diçka që normalisht e thoshte Presidenti
24 Clinton.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Udhëheqësi kujt, sipas

1 jush?

2 PË. "Udhëheqje" është një term që përdoret për një person që
3 merr një vendim të vështirë. Nuk kishte asgjë, nuk kishte
4 asnjë kuptim nga pikëpamja juridike. Është një term siç edhe
5 rasti i Gerry Adams që përdori Madeleine Albright, që ishte
6 komandant i IRA-së, ama lider, ishte udhëheqës nga pikëpamja e
7 vendimmarrjes, se ai vendosi të krijonte një organizatë
8 legjitime dhe të bënte paqe me fqinjët e vet. Në të njëjtin
9 kontekst ne menduam që Hashim Thaçi si civil, i veshur civil,
10 ndonëse ishte pjesë e UÇK-së ne mendonim se ishte lider,
11 udhëheqës të cilit iu kërkua të nënshkruante marrëveshjen, dhe
12 Presidenti Clinton e përgëzoi për udhëheqjen e tij, sepse ai e
13 ka mbajtur fjalën siç duhet ta mbajë një udhëheqës.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse i duhet palëve, për
15 pavarësisht dokumenti është me numër 021080.

16 Tani le të shohim provën materiale 1D148.

17 Këtë dokument e keni parë disa herë, z. Rubin.

18 Shkojmë më poshtë për t'i dhënë më shumë kontekst z.
19 Rubin.

20 PË. Më kujtohet shumë mirë, po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shkojmë te materiale
22 DHT01536. Më duket se ky është numri. Në disa vende shfaqet,
23 por unë do të fokusohem tek pika 4. Fokusohem tek pika 4.
24 Thuhet kështu:

25 "Sekretarja", i referohet Sekretares Madeleine Albright,

1 "u takua me përfaqësues të UÇK-së, Krasniqi, në rezidencën e
2 Ambasadorit Vershbow në 12 prill me kërkesë të drejtuesit të
3 UÇK-së dhe Kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovë,
4 Hashim Thaçi."

5 Pra sipas jush, administrata e SHBA-së asokohe -- nëse
6 mund t'i përgjigjeni, kuptohet. Pra, sipas tyre z. Thaçi ishte
7 drejtuesi i UÇK-së dhe Kryeministri i Qeverisë së Përkohshme
8 të Kosovës? Kështu e konsideronte administrata e SHBA-së?
9 PË. Unë në fakt dua të theksoj që në kabllogram, "qeveria e
10 përkohshme" është në thonjëza.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po që është drejtues i
12 UÇK-së?

13 PË. Po dhe unë e kam konsideruar drejtues atë. "Drejtues",
14 një nga "drejtuesit e UÇK-së".

15 Ju nuk po përmendni thonjëzat. Këtu bën një dallim të
16 madh. Personi që ka raportuar, as ka punuar në Kosovë. Ka
17 dëgjuar që ata shprehen sikur janë drejtues, ka dëgjuar dhe
18 Krasniqin që ka thënë, Hashim Thaçi është Kryeministri i
19 Qeverisë së Përkohshme. Edhe e shkruan menjëherë këtë, ama dhe
20 vetë ai ka pasur dyshime, dhe qeverinë e përkohshme e ka futur
21 në thonjëza, sepse ne nuk e kishim njohur këtë qeveri. Nuk
22 dinim të kishte një qeveri. Pra, fjalët e personit, e
23 transkriptuesit këto, jo fjalët e vetë personave, folësve.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Rubin,
25 për durimin tuaj. Kaq pyetje kisha unë për ju. Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të duhet
2 të ktheheni nesër, z. Rubin.

3 Në vjen keq, donit të thoni diçka?

4 DËSHMITARI: Unë do të doja të mbaroja sot nëse është e
5 mundur. Do të ishte më e lehtë për mua për sa kohë keni nevojë
6 mua.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është dhe
8 Gjykatësi Gaynor që ka pyetje, avokatët kanë pyetje të tjera,
9 kështu që do të kemi nevojë për më shumë kohë.

10 DËSHMITARI: Unë do të rrija. Unë do të qëndroja,
11 megjithatë, unë e kuptoj që s'mund ta bëni. Por unë mund të
12 qëndroj nëse është nevoja.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 DËSHMITARI: Atëherë unë duhet të gjej një dhomë hoteli, i
15 takon.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do të
17 duhet të qëndroni dhe të ktheheni këtu nesër.

18 DËSHMITARI: më vjen shumë keq, në fakt, që po ma thoni
19 këtë gjë.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
22 mund të largoheni nga salla e gjyqit. Do të shihemi nesër në
23 orën 9.00. do të përpiqemi të jemi sa më efikase nesër
24 paradite.

25 Ka gjë tjetër për ost nga palët?

1 Nuk u çua njeri në këmbë. Në rregull.

2 Atëherë, shihemi nesër në orën 9.00.

3 --- Seanca mbyllet në orën 16.28

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25